



Raporti i dytë
për situatën
(në lidhje me)

ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES SË ROMËVE DHE SINTIVE NË FUSHËN E VEPRIMIT TË OSBE-SË



Shkup, shtator 2024

Materialet në këtë edicion janë vetëm për referenca. Megjithëse OSBE-ja investoi vëmendje maksimale në përpilimin e tij, ajo nuk merr asnjë përgjegjësi lidhur me saktësinë dhe aspektin integral të të gjitha informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të prezantuara ose sa i përket ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij edicioni, pikëpamjet, opinionet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e prezantuara në të njëjtin nuk e pasqyrojnë domosdo politikën ose qëndrimin zyrtar të OSBE-së. Për këto arsye, nuk mund të ngrihen kurrfarë pretendimesh kundër OSBE-së në lidhje me pasojat e mundshme nga autenticiteti i informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë edicion.

Shteti zyrtarisht e ndryshoi emrin e tij në vitin 2019 në përputhje me Marrëveshjen e Prespës. Shumica e akteve juridike janë krijuar para ndryshimit të emrit të shtetit dhe akoma janë në fuqi ndërkaq në titujt e akteve e përmbajnë emrin e mëparshëm të shtetit. Përdorimi i emrit të mëparshëm të shtetit në këtë dokument është për shkak të saktësisë juridike.

PËRMBAJTJA

I. METODOLOGJIA	9
Progresi pas miratimit të Planit të veprimit të OSBE-së	10
Miratimi i strategjive	10
Krijimi i institucioneve	11
Buxheti shtetëror	12
Miratimi i legjislacionit kombëtar	12
DERI KU ËSHTË Republika e Maqedonisë së Veriut TANI?	15
Kapitulli III i Planit të veprimit – Lufta kundër racizmit dhe diskriminimit	15
II. Policia	27
III. Mediat masive	33
Kapitulli IV i Planit të veprimit - Çështjet socio-ekonomike	35
Kapitulli V i Planit të veprimit - Përmirësimi i qasjes në arsim	49
Kapitulli VI i Planit të veprimit - Rritja e pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike	66
Kapitulli VII i Planit të veprimit - Romët dhe sintit në situata krize dhe pas-krizës	74
IV. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	79
KONKLUSIONE	79
REKOMANDIME	82

MIRËNJOHJE

Në emër të ekspertit kombëtar Zharko Haxhi-Zafirov, dëshirojmë të shprehim mirënjohjet tona personave në vijim për bashkëpunimin, mbështetjen, këshillat dhe komentet e tyre të bëra gjatë hartimit të këtij raporti për situatën në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me zbatimin e Planit të veprimit për përmirësimin e gjendjes së romëve dhe sintive në fushën e veprimit të OSBE-së:

Institucione kombëtare	
KUVENDI i Republikës së Maqedonisë së Veriut	Sonja Mirakovska
MINISTËR PA PORTOFOL, I NGARKUAR PËR INTEGRIMIN dhe ZBATIMIN E STRATEGJISË SË PËRFSHIRJES SË ROMËVE 2022 - 2030	Ministër Shaban Salju
MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE DEMOGRAFISË dhe RINISË	Mabera Kamberi Elvis Memeti
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS	Arbela Iljaz Merita Mustafi Suzana Shabanovska
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE LIDHJEVE	Suzana Kamçevska
MINISTRIA E DREJTËSISË	Nikolla Prokopenko
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	Igor Arsovski Danica Dimitrovska Kiro Graçanski Imirzat Selim Vangja Zikova
MINISTRIA E SHËNDETËSISË	Sanja Sazdovska
MINISTRIA E KULTURËS	Makedonka Koceva
AVOKATI I POPULLIT	Marjan Ponjaviç
KOMISIONI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI	Igor Jadrovski
AKADEMIA PËR GJYQTARË DHE PROKURORË PUBLIKË	Natasha Gaber Damjanovska Sanja Pandilov
KOMUNA SHUTO ORIZARË	Kurto Dudush Fatima Osmanovska Ibrahim Ibrahimi

Organizatrat ndërkombëtare

MISIONI I OSBE-së në SHKUP

Ramadan Berat
Aleksandar Jovanovski
Matju Xhons
Afrim Bajrami
Zhaneta Poposka

KOMISIONERI I LARTË I KB PËR REFUGJATË

Vildan Drpljanin

ZYRA PROGRAMORE E KËSHILLIT
TË EVROPËS NË SHKUP

Mersiha Usein

DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN
NË MAQEDONINË E VERIUT

Nafi Saraçini

Organizatrat e qytetarëve

SHOQATA MAQEDONASE E JURISTËVE TË RINJ

Aleksandra Efremova
Teodora Qoseva

KOMITETI MAQEDONAS I HELSINKIT

Uranija Pirovska

QENDRA E HULUMTIMEVE DHE ANALIZAVE JURIDIKE

Oliver Mitov
Zharko Aleksov

Ekspertë të tjerë

Nesime Salioska, aktiviste e OJQ-ve dhe eksperte për çështjet e romëve

Aksel Akhmedovski, ish-ministër pa portofol përgjegjës për çështjet e romëve

Latife Shikovska, ish-deputete në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

SHKURTESAT

APRMV	Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut
AGJPP	AKADEMIA PËR GJYQTARË DHE PROKURORË PUBLIKË
MK	Ministria e Kulturës
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
QRMV	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
PV	Plani i veprimit i OSBE-së për përmirësimin e gjendjes së romëve dhe sintive në fushën e veprimit të OSBE-së
BZHA	Byroja për Zhvillimin e Arsimit
OQ-	Organizatata e qytetarëve
BE	Bashkimi Evropian
FSHHM	Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni
DI	Dokumentet e identifikimit
PZHBV	Person i zhvendosur brenda vendit
KLP	Këshilli Lokal i Parandalimit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
IMM	Instituti Maqedonas për Media
MKD	Denari maqedonas
MPSDR	Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MT	Ministria e Transportit
IKD	Instituti Kombëtar për Demokraci
QKR	Qendra Kombëtare e Romëve
ODIHR	Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat E Njeriut
MKO	Marrëveshja Kornizë e Ohrit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
DZHP	Departamenti i Zhvillimit të Policisë
REK	Rekomandim
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
FAR	Fondi Arsimor i Romëve
QIR	Qendra Informative e Romëve
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNHCR	Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Grave
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport i dytë mbi situatën në lidhje me zbatimin e Planit të veprimit për përmirësimin e gjendjes së romëve dhe sintive në fushën e veprimit të OSBE-së u hartua 21 vjet pas miratimit të Planit të veprimit. Raporti i parë mbi situatën në lidhje me zbatimin e Planit të veprimit, i cili dha një pasqyrë të situatës së përgjithshme të komunitetit rom në Republikën e Maqedonisë (në atë kohë) për periudhën e viteve 2003 - 2010, u hartua në vitin 2010 nga ekspertja ndërkombëtare e Misionit të OSBE-së në Shkup, Gjorgja DeMarki.

Fushëveprimi i këtij raporti të dytë mbi situatat ndoqi fushat e përfshira nga raporti i parë me qëllim të përcaktimit të shkallës së zhvillimit të segmenteve të ndryshme të gjendjes së romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Vlerësimi i shkallës së zbatimit të Planit të veprimit të OSBE-së i përfshin fushat që fillojnë me diskriminimin, legjislacionin dhe zbatimin e ligjeve, gjendjen socio-ekonomike në komunitetin rom, përfshirë segmentet e banimit, punësimit dhe shëndetësisë, dhe çështjet në lidhje me arsimin. Përveç kuadrit ligjor dhe pozitës socio-ekonomike të romëve, ky raport analizon edhe situatat në sistemin politik dhe zhvillimin e jetës politike brenda komunitetit rom. Në fund, e shqyrton gjendjen e romëve të zhvendosur, shumica e

të cilëve janë refugjatë nga kriza në Kosovë¹ dy dekada më parë.

Nga analiza e zbatimit të rekomandimeve të Planit të veprimit të OSBE-së, shihet se ka një shkallë të ndryshme zbatimi. Gjegjësisht, nëse bëhet një pasqyrë e zbatimit, pavarësisht se kanë kaluar më shumë se 20 vjet, mund të nënvizohet se ka pasur përparim të madh në zbatimin e rekomandimeve në lidhje me legjislacionin e miratuar. Megjithatë, sa i përket krijimit të mekanizmave për përmirësimin e situatës, përparimi është mesatar, ndërsa kushtet për ushtrimin e të drejtave, të cilat nuk janë vetëm pjesë e rekomandimeve por edhe të drejta dhe liri të garantuara me kushtetutë sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, tregojnë diversitet për shkak të jokonsistencës në zbatimin e politikave kombëtare për përfshirjen e romëve në proceset shoqërore në vend.

Përmes analizës së situatës së përgjithshme të politikave në lidhje me romët, mund të nxirren konkluzionet si vijon.

¹ Të gjitha referencat për Kosovën, pavarësisht se a bëhet fjalë për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Ekziston një politikë afirmative e parashikuar ligjërisht për të rritur numrin e romëve të punësuar në institucione të caktuara. Krahas kornizës ligjore afirmative, shkalla e përfaqësimit në përputhje me pjesëmarrjen e komunitetit rom në popullatën e përgjithshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është arritur. Në fushën e përcaktimit të gjendjes civile, një hap serioz është bërë me miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për evidencën amë, Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Paraqitjen e vendbanimit dhe vendqëndrimit, Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përveç këtij grupi ligjesh, Republika e Maqedonisë së Veriut në vitin 2020 miratoi edhe Ligjin për personat e paevidentuar në Librin amë të të lindurve, i cili krijoi një zgjidhje të pjesshme për regjistrimin e personave që nuk janë të regjistruar në librin amë. Ky ligj nuk është zgjidhje sistematike, por një zgjidhje e përkohshme me të cilën personat e paregjistruar regjistrohen me qëllim të ushtrimit të një numri të kufizuar të të drejtave nga korpusi i të drejtave sociale dhe ekonomike të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në fushën e të drejtës për barazi, përkatësisht në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi dhe segregacioni, është arritur një sukses i madh përmes institucioneve të krijuara, por mbetet segmenti i krijimit të politikave efektive për të kapërcyer stereotipat dhe paragjykimet, veçanërisht në fushën e arsimit dhe shërbimeve shëndetësore.

Së dyti, ka pasur zhvillim mesatar në fushën e kushteve socio-ekonomike, meqë varfëria në komunitetin rom është e pranishme dhe përfaqësimi i familjeve sociale në rrezik është ende një nga sfidat kryesore të politikave socio-ekonomike në Republikën e Maqedonisë së

Veriut. Në kuadër të masave të punësimit, është rritur numri i përfituesve të tyre në komunitetin rom, gjë që tregon se ka një interes të shtuar për pjesëmarrje në tregun e punës. Kjo për shkak të masave afatgjata në fushën e arsimit dhe trajnimit shtesë përmes të cilave qytetarët fitojnë aftësi pune që janë gjithnjë e më të kërkuara në tregun e punës.

Së treti, ekziston jokinisistencë në mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve dhe të dhënave zyrtare si pjesë e monitorimit dhe evalvimit të politikave të zbatuara në fushën e përmirësimit të gjendjes së romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjë që e pamundëson krijimin e politikave dhe masave strategjike konsistente për promovimin dhe përmirësimin e mëtejshëm. Kjo është e dukshme nga fakti se në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka raportim konsistent me indikatorë të përcaktuar për rezultatet e Dekadës së Romëve 2004 - 2014, dhe as nga Strategjia e zbatuar e Romëve 2014 - 2020.

Analiza e bërë në kuadër të këtij raporti synon të bëjë këqyrje në politikat dhe masat e ndërmarra në fushën e zbatimit të Planit të veprimit të OSBE-së për të përcaktuar shkallën e përmbushjes së rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes së popullsisë rome në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Përfundimet dhe rekomandimet e këtij raporti duhet t' u shërbejnë institucioneve kompetente dhe faktorëve politikë, si dhe protagonistëve të tjerë relevantë dhe palëve të interesuara për krijimin e politikave dhe masave të mëtejshme për përfshirje dhe integrim që do të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes së komunitetit rom në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

I METODOLOGJIA

Ky raport u përgatit në periudhën kohore qershor-shtator të vitit 2024. Duke u nisur nga fakti se ky raport është një përditësim i “Raportit për situatën e zbatimit të Planit të veprimit për përmirësimin e gjendjes së romëve dhe sintive në fushën e veprimit të OSBE-së”, Giorgja DeMarki, Shkup, botuar në dhjetor 2010, ishim të detyruar ta ndjekim metodologjinë fillestare të vitit 2010. Prandaj, në kuadër të procesit të përgatitjes së raportit, fillimisht u zbatua hulumtimi dhe grumbullimi i të dhënave të shpallura publikisht nga institucione të ndryshme, organizata ndërkombëtare, programe dhe projekte të zbatuara nga organizata kombëtare ose ndërkombëtare, organizata të shoqërisë civile dhe ekspertë që analizojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi gjendjen brenda komunitetit rom në segmente të ndryshme, statusin, gëzimin e të drejtave dhe lirive, shëndetin, pozitën sociale, arsimin, përfshirjen në jetën publike, përfaqësimin në institucionet publike, mediat masive, etj.

Hapi i radhës sa i përket grumbullimit të informacioneve bazike ishte mbajtja e takimeve, përkatësisht intervistave me përfaqësuesit e faktorëve kryesorë në procesin e përmirësimit të gjendjes së romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Intervistat u zhvilluan me grupe të ndryshme të faktorëve, fillimisht me përfaqësues të pushtetit ekzekutiv duke filluar me ministrin pa

portofol përgjegjës për integrimin dhe zbatimin e Strategjisë për përfshirjen e romëve 2022 - 2030 në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut i emëruar në qershor të vitit 2024, me udhëheqës të sektorëve të ndryshëm në ministritë, me zyrtarë të përfshirë në mënyrë aktive në Organin Kombëtar Koordinues për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë për Përfshirjen e Romëve 2022 - 2030, me organizata të shoqërisë civile dhe ekspertë të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në monitorimin e zhvillimit të komunitetit rom. Këto intervista ofruan të dhëna të vlefshme, pasi pjesëmarrësit ndanë pikëpamjet e tyre dhe perspektivat analitike për çështjet e romëve nga viti 2011 deri në vitin 2024, duke i përfshirë përvojat nga Dekada e romëve 2005-2015 dhe Strategjia e romëve 2014-2020.

Pas intervistave, u përdor një metodë krahasuese për kontrollin e të dhënave dhe informacioneve që u mbledhën dhe analizuan, duke i krahasuar burimet e informacioneve dhe të dhënave të njëjta. Në këtë seksion u përdorën “raportet në hije” të përgatitura në kuadër të programeve dhe projekteve nga shoqatat e qytetarëve dhe ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë. Ky kontroll ishte i një rëndësie të veçantë për arsyen se nuk ka konsistencë në shpalljen publike të raporteve dhe të dhënave në lidhje me zbatimin e Dekadës së

romëve 2005 - 2015, Strategjisë së romëve 2014 - 2022, Planit të veprimit dhe zbatimit fillestar të Strategjisë aktuale për përfshirjen e romëve 2022 - 2030. Së këtejmi, një rëndësie të veçantë për këtë raport kishin analizat dhe raportet e organizatave të qytetarëve që janë të përfshira në mënyrë aktive në monitorimin e gjendjes së komunitetit rom, segmentet që ishin brenda shtrirjes së vetë raportit, siç janë, për shembull, Romalítico, HERA, Iniciativa e Shoqatës për të Drejtat e Grave nga Shuto Orizare, Qendra Kombëtare e Romëve Kumanovë, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, Komiteti Maqedonas i Helsinkit, Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave (ESE) dhe të tjerë.

Duke u nisur nga gjithëpërfshirja e këtij raporti dhe detajet që përmban rrjedhimisht në raportin e vitit 2010, është marrë një angazhim serioz për të dhënë një pasqyrë sa më reale të zhvillimit të gjendjes së romëve në periudhën kohore nga viti 2011 deri në vitin 2024, që është një periudhë shumë e gjatë kohore. Ky proces është pjesërisht i kufizuar për shkak të mungesës së të dhënave të shpallura publikisht për proceset, aktivitetet dhe angazhimet që janë zbatuar gjatë periudhës 15 vjeçare.

Megjithatë, edhe ky dokument i merr parasysh përshtypjet dhe punën e të gjitha palëve të interesuara dhe përmban një pasqyrë, bazuar në informacione dhe procesin e konsultimi, të situatës dhe progresit në disa dimensione që i prekin romët në Republikën e Maqedonisë së Veriut në dy dekadat e mëparshme.

Progresi pas miratimit të Planit të veprimit të OSBE-së

Republika e Maqedonisë së Veriut, pavarësisht progresit të kufizuar në periudhën nga miratimi i Planit të veprimit të vitit 2003, në periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2024 tregoi angazhime

serioze politike për të përmirësuar pozitën e romëve. Këto angazhime në këtë periudhë relativisht të gjatë janë të dukshme për sa i përket prioritetit që qeveritë tregojnë në programet e tyre, si dhe përmes dokumenteve të veçanta strategjike në sektorë të ndryshëm, siç është politika sociale, shëndetësia, arsimi, punësimi, drejtësia dhe të tjera. Përmes këtyre hapave dhe procedurave, Republika e Maqedonisë së Veriut tregon qartë se pozita e romëve në territorin e saj është vazhdimisht në agjendën politike. Kjo është e dukshme nga pjesëmarrja aktive e Republikës së Maqedonisë së Veriut si në Procesin e Berlinit ashtu edhe si një nga nënshkruesit e Deklaratës për integrimin e romëve të nënshkruar në Poznań në korrik të vitit 2019.

Megjithatë, përveç këtyre përcaktimeve politike, rezultatet nuk janë proporcionale, as nuk janë plotësisht të kënaqshme në të gjitha segmentet e jetës së komunitetit rom në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Arsyeja për këtë është se vetë shteti nuk parashikon kushte të përshtatshme për përmbushjen e këtyre angazhimeve, siç shihet nga kapacitetet e krijuara institucionale, si dhe nga burimet financiare të parashikuara për përmirësimin e situatës dhe përfshirjen e romëve në të gjitha segmentet shoqërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si gjatë Dekadës së Romëve ashtu edhe gjatë zbatimit të dy strategjive vijuese.

Miratimi i strategjive

Republika e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me angazhimet politike në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, në nivel kombëtar i ka sanksionuar në dokumentet strategjike kombëtare. Për më tepër, siç thuhet në raportin e vitit 2010, Qeveria në atë periudhë, në përputhje me rekomandimin 4 të PV, e kishte zhvilluar "Strategjinë për Romët në Republikën e Maqedonisë - dhjetor, 2004", e cila ishte mënyra se si do të zbatohet Plani i veprimit 2003, por njëkohësisht të krijohen kushte për zbatimin e Dekadës së romëve për periudhën 2005 - 2015. Në mënyrë që të stimulohet një angazhim

akoma më i madh për përmirësimin e gjendjes së romëve, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë (në atë kohë) më datë 1.4.2011 miratoi Deklaratën për avancimin e pozitës dhe të drejtave të romëve². Me këtë dokument, në të vërtetë, Kuvendi si pushtet ligjvënës e nxiti Qeverinë dhe organet shtetërore si pushtet ekzekutiv dhe faktorët e tjerë relevantë si sektorin qytetar, organet e vetëqeverisjes lokale, subjektet ekonomike, institucionet shkencore dhe kulturore dhe mediat të marrin masa dhe politika të përforuara dhe efektive për promovimin e të drejtave dhe pozitës shoqërore dhe ekonomike të romëve dhe komunitetit rom në vend.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në atë kohë), duke u kujdesur për konsistencën e politikave për përfshirjen e romëve, në vitin 2014 miratoi “Strategjinë për Romët në Republikën e Maqedonisë 2014 - 2020”.

Pas zbatimit të “Strategjisë për romët në Republikën e Maqedonisë 2014 - 2020”, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke marrë parasysh rezultatet e saj dhe udhëzimet që rezultuan nga zbatimi i saj, dhe e udhëhequr nga Deklarata e miratuar e Poznañit në vitin 2019, Programi për punën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut 2020 – 2024 dhe Korniza strategjike 10-vjeçare e BE-së për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve (2021 - 2030) e miratuar nga Komisioni Evropian në tetor 2020, në vitin 2022 miratoi Strategjinë aktuale për përfshirjen e romëve 2022 – 2030³.

² Deklarata për avancimin e pozitës dhe të drejtave të romëve e miratuar në seancën e mbajtur më datë 1.4.2011, botuar në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 42/11.

³ <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/Strategjia%20za%20inkluzija%20na%20Romite%202022-2030%2003-02-2022%20finalna%20verzija.pdf>

Krijimi i institucioneve

Në periudhën kohore nga viti 2010 deri në vitin 2024, në funksion të zbatimit të dokumenteve strategjike - Strategjia 2014 - 2020 dhe Strategjia 2022 - 2030, janë institucionet që u krijuan gjatë Dekadës së romëve 2005 - 2015. Pika kryesore për zbatimin e dokumenteve të strategjisë në periudhën 2011 - 2024 ishte Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, por me organizimin e ri të administratës shtetërore⁴ kjo kompetencë tani do të jetë në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, në përbërjen e së cilës mbetet Seksioni për Zbatimin e Strategjisë si pjesë e Sektorit për Koordinimin dhe Ndhimën Teknike për Ministrinë⁵.

Në kuadër të zbatimit të dokumenteve strategjike, si organ që duhet të monitorojë dhe drejtojë zbatimin e strategjive dhe politikave për përfshirjen dhe integrimin social të romëve është Autoriteti Koordinues Kombëtar (AKK), i cili përfshin përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe shoqatave të shoqërisë civile. Ky autoritet është përgjegjës për koordinimin efektiv ndërsektorial në procesin e zbatimit të strategjive për romët, si dhe një autoritet që do të mbledhë të gjitha të dhënat në një bazë të dhënash për përfshirjen sociale të romëve. Përveç institucioneve kombëtare dhe shoqatave të qytetarëve, në këtë autoritet janë planifikuar të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare (OSBE, USAID, BE dhe të tjerë).

Në vitin 2018, në kuadër të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (në atë kohë), u formua “Grupi Parlamentar Ndërpartiak për të Drejtat e Romëve

⁴ Në përputhje me nenin 28 pikën 4 të Ligjit për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Organeve të Administratës Shtetërore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 121/24).

⁵ <https://www.mtsp.gov.mk/sektori.nsp.x>

në Republikën e Maqedonisë”, i cili do të përfshijë deputetë nga legjislatura aktuale parlamentare nga parti të ndryshme politike⁶. Në përbërjen parlamentare 2020 - 2024, në shkurt të vitit 2021 u rithemelua Grupi Parlamentar Ndërpartiak për Mbështetjen e Romëve me qëllim mbështetjen e zbatimit të Strategjisë për Përfshirjen e Romëve 2022 - 2030 përmes koordinimit me përfaqësuesit e pushtetit ligjvënës dhe avancimit të legjislacionit drejtpërdrejt ka të bëjë me komunitetin rom⁷.

Mevotimime Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në korrik 2024, u rivendos pozita e ministrit pa portofol përgjegjës për çështjet e romëve, e cila u krijua në vitin 2008. Në fillim të vitit 2021, në vend të ministrit pa portofol për çështjet që kanë të bëjnë me gjendjen e romëve, u caktua një këshilltar në Kabinetin e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për çështjet që kanë të bëjnë me romët. Përkatësisht, në vitin 2021, me Procesverbalin e miratuar në seancën e 44-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, u caktua një këshilltar për përfshirjen e romëve nga Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut si pikë kombëtare e kontaktit për romët në Republikën e Maqedonisë së Veriut për zbatimin e aktiviteteve të Iniciativës Ndërkombëtare për Integrimin e Romëve 2020⁸. Duke rivendosur pozicionin e ministrit pa portofol përgjegjës për çështjet e romëve, krijohet mundësi për ndikim më të madh politik në krijimin dhe zbatimin e politikave për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen romët në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Buxheti shtetëror

Republika e Maqedonisë së Veriut, në zbatimin e politikave të saj për përmirësimin e gjendjes së romëve, përkundër faktit se ka treguar angazhime serioze politike dhe ka miratuar dokumente kryesore strategjike, nuk ka arritur të sigurojë burime të mjaftueshme financiare dhe materiale për të zbatuar këto politika dhe për të arritur rezultatet e përcaktuara siç janë hartuar dhe miratuar nga institucionet qeveritare. Me fjalë të tjera, në periudhën kohore 2011 - 2024, në asnjë vit nuk u shpenzua buxheti i paraparë që ishte i projektuar për përmirësimin e gjendjes së romëve, veçanërisht në periudhën e Dekadës së romëve. Në vitin 2024, buxheti shtetëror për romët arriti në rreth 60,000,000 denarë, i cili me rishikimin e buxhetit u zvogëlua në pjesën e shërbimeve shëndetësore dhe sociale për 10-20%. Është për t’u përhëndetur rritja e buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë nga 4,100,000 denarë në 6,000,000 denarë, të cilat me rishikimin u zvogëluan në 5,000,000 denarë. Në pjesën e infrastrukturës në kompetencë të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve (në atë kohë), poashtu kishte rritje të buxhetit për projektet e infrastrukturës, ku nga 15,000,000 denarë është rritur në 20,000,000 denarë⁹ në vitin 2024, të cilat duhet të përdoren për projekte infrastrukturore në komunat ku ka lagje dhe vendbanime rome.

⁶ https://www.sobranie.mk/sredbi-2018-ns_article-osnovanje-na-interpartiska-parlamentarna-grupa-za-pravata-na-romite-vo-republika-makedonija.nspk

⁷ <https://www.sobranie.mk/detali-na-klub.nspk?groupId=27110861-4a40-42f2-8011-9cb2be5dd730>

⁸ Procesverbali i seancës së 44-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut data 9 shkurt 2021.

⁹ <https://mtc.gov.mk/media/files/2024/Budzet%20na%20MTV%202024.pdf>

Miratimi i legjislacionit kombëtar

Legjislacioni kombëtar në Republikën e Maqedonisë së Veriut që ka ndikim të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e çështjeve në lidhje me gjendjen e romëve është në një nivel të lakmueshëm, si në aspektin e rregullimit legjislativ ashtu edhe në aspektin e efekteve të arritura nga ligjet konkrete. Së këtejmi, në vitin 2011, u miratua Ligji për veprimin me objekte të ndërtuara në mënyrë të paligjshme¹⁰, i cili u lejonte qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (në atë kohë) të kryenin “legalizim”, përkatësisht të përcaktonin statusin juridik të objekteve që nuk e kishin statusin e ndërtimeve legale. Efekti i ligjit nuk mund të përcaktohet në drejtim të përmirësimit të pozitës së romëve, pasi nuk mbahen statistika për aplikimet e paraqitura dhe objektet e legalizuara në bazë të përkatësisë etnike. Megjithatë, sipas të dhënave nga hartëzimi social, rreth 30% e romëve akoma nuk i kanë legalizuar objektet e banimit të tyre për shkak të mungesës së planit urbanistik në komunë për ato lagje/vendbanime ose për shkak të pamundësisë për të mbuluar shpenzimet financiare.¹¹

Duke u nisur nga angazhimi themelor për parandalimin dhe mposhtjen e diskriminimit dhe segregacionit, në vitin 2010, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë (në atë kohë) miratoi Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi¹², i cili ishte në fuqi deri në vitin 2015. Me këtë Ligj u inkorporua një mekanizëm i veçantë për mbrojtje nga diskriminimi, Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili ishte mekanizmi i parë i veçantë i

krijuar për mbrojtje nga diskriminimi. Pas miratimit të ligjit të vitit 2010, u miratuan tre ligje radhazi, në vitin 2015, 2019¹³ dhe i fundit në vitin 2020¹⁴, i cili është ende në fuqi. Me Ligjin e vitit 2020 u inkorporuan të gjitha përkufizimet themelore, duke e përfshirë edhe segregacionin, që nuk ishte parashikuar me Ligjin e parë për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi i vitit 2010, me të cilin u zgjeruan kompetencat e Komisionit.

Ligji për ndihmë juridike falas u miratua në vitin 2009 dhe ishte i vlefshëm deri në vitin 2019. Ky Ligj, edhe pse u miratua për dhënien e ndihmës juridike falas për personat që nuk janë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre, nuk i dha rezultatet e pritshme, prandaj në vitin 2019 u miratua një ligj i ri për ndihmën juridike falas, i cili i rriti mundësitë për ofrimin e ndihmës juridike falas, duke siguruar grante për shoqatat e qytetarëve dhe klinikat ligjore që ofrojnë ndihmë juridike falas, duke lehtësuar kushtet për përcaktimin e statusit pronësor në ofrimin e ndihmës juridike sekondare, lirimin nga taksat gjyqësore dhe administrative etj.

¹⁰ Ligji për veprimin me objekte të ndërtuara në mënyrë të paligjshme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 23/11).

¹¹ <https://romalitico.org/wp-content/uploads/2024/02/shadow-report-implementation-of-the-roma-strategy-20212022-mk.pdf>

¹² Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, “Gazeta Zyrtare e RM”, nr.50/2010

¹³ Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 101/2019).

¹⁴ Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 258/2020).

Nga numri i përgjithshëm i personave (2909) që morën ndihmë juridike primare në vitin 2023 në zyrat rajonale, 280 persona janë të përkatësisë etnike romë¹⁵. Si ofrues të ndihmës juridike paraprake janë dy shoqata të qytetarëve romë - Qendra Kombëtare e Romëve dhe KHAM Delçevë.

Me rëndësi të veçantë për zgjidhjen e banimit të romëve dhe statusit të tyre qytetar janë Ligji për banim i vitit 2009¹⁶, Ligji për Evidencën amë¹⁷ dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shtetësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut¹⁸, të cilat krijuan një mundësi që romët si komuniteti më i madh me persona pa dokumente dhe pa shtetësi ta rregullojnë statusin e tyre në mënyrë që të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

¹⁵ <https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD%20%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%202023%20%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%B0%D0%B0%D0%B0%D0%B0.pdf>

¹⁶ Ligji për banim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 99/09, 57/10, 36/11, 54/11, 13/12, 55/13, 163/13, 42/14, 199/14, 146/15, 31/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 302/20 dhe 150/22).

¹⁷ Ligji për evidencën amë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 8/95, 38/02, 66/07, 67/09, 13/13, 43/14, 148/15, 27/16, 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 14/20, 129/23).

¹⁸ "Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shtetësi të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.174/2021).

DERI KU ËSHTË Republika e Maqedonisë së Veriut TANI?

Kapitulli III i Planit të veprimit – Lufta kundër racizmit dhe diskriminimit

I. Legjislacioni dhe zbatimi i ligjeve

7) Shtetet anëtare të OSBE-së duhet të marrin në konsideratë ratifikimin e marrëveshjeve relevante ndërkombëtare sa më shpejt të jetë e mundur, dhe nëse në ndërkohë nuk e kanë bërë këtë, ta kenë parasysh Konventën ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor.

Republika e Maqedonisë së Veriut i ka nënshkruar dhe ka aderuar në shumicën e dokumenteve ndërkombëtare që i garantojnë liritë themelore dhe të drejtat e njeriut.

Republika e Maqedonisë së Veriut si shtet nënshkrues i Konventës ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor në vitin 2015 e paraqiti Raportin në Komitetin për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor¹⁹ në të cilin dha një pasqyrë të hapave të ndërmarra në kuadër të Dekadës së romëve 2005 - 2015.

Raporti jep një pasqyrë për segregacionin e fëmijëve romë në procesin arsimor, nevojën për zgjidhjen e çështjes së banimit të romëve, martesat e të miturve, problemet që lidhen me fëmijët e rrugës, fëmijët e varur nga drogat dhe në veçanti problemin e fëmijëve që nuk janë të regjistruar në evidencën amë. Së këtejmi, Komiteti adresoi rekomandime të qarta për të kapërcyer këto probleme duke siguruar kushte adekuate për përmirësimin e gjendjes së romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut²⁰.

8) Të miratohet dhe zbatohet legjislacioni efektiv kundër diskriminimit për të luftuar diskriminimin racor dhe etnik në të gjitha fushat, ndër të tjera, qasja në banim, shtetësia dhe e drejta e qëndrimit, arsimi, punësimi, shërbimet shëndetësore dhe sociale. Të përfshijnë përfaqësues të romëve dhe sintive në proceset e krijimit, zbatimit dhe evalvimit.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në tetor 2020 miratoi Ligjin aktual për parandalimin

¹⁹ https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CERD%2F%2FMRK%2FCO%2F8-10&Lang=en

²⁰ https://www.ohchr.org/en/search?f%5B0%5D=country_taxonomy_term_name%3ANorth%20Macedonia&page=1

dhe mbrojtjen nga diskriminimi²¹. Ky ligj plotësisht është harmonizuar me dokumentet përkatëse të Bashkimit Evropian për sigurimin e trajtimit të barabartë, përkatësisht me Direktivën nr. 2000/78/EC të Këshillit, datë 27 nëntor 2000, "Për krijimin e kuadrit të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion", Direktiva Nr. 2004/113/KE e Këshillit datë 13 dhjetorit 2004 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në qasjen dhe sigurimin e mallrave dhe shërbimeve dhe Direktiva Nr. 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 5 korrikut 2006 për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në fushën e punësimit dhe profesioneve.

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi përbëhet nga shtatë anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili gjithashtu siguron buxhetin për punën e Komisionit. Pas miratimit të Ligjit, Komisioni mori një rol aktiv si paraprijës në luftën kundër diskriminimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Anëtarët e përbërjes aktuale janë profesionistë të shquar nga sektori qytetar, por edhe nga institucionet shtetërore. Një nga anëtarët si në përbërjen e mëparshme ashtu edhe në atë aktuale është i përkatësisë rome.

Komisioni, përveç punës me parashpresa, në përputhje me ligjin, ka kompetencë të iniciojë procedura gjyqësore dhe të paraqitet si ndërhyrës në procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, si dhe të paraqesë kërkesë që gjykata t'i mundësojë të veprojë si mike e gjykatës (*amicus curiae*) me kërkesë të palës ose me iniciativën e saj.

²¹ Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 258/2020).

Në periudhën kohore nga viti 2021 deri në mesin e vitit 2024, Komisioni ka përcaktuar diskriminim ndaj romëve në 23 lëndë në lidhje me segregacionin, profilizimin racor dhe diskriminimin në pjesën e përdorimit të të mirave dhe shërbimeve publike²².

Në pjesën e evidentimit të personave të paevidentuar, u miratua Ligji për Personat e Paevidentuar në Librin amë në fund të janarit 2020. Komisioni Evropian në Raport Progresin për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 nënvizoi se nga 700 persona të paevidentuar, janë paraqitur 318 kërkesa për evidentim në librin e veçantë amë të të lindurve, nga të cilët 292 persona janë evidentuar²³.

Zgjidhja e përhershme e çështjes së personave të paevidentuar në librin amë të të lindurve ubë me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për evidencën amë²⁴, i cili u iniciua dhe monitorua nga Komisioni për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Midis Bashkësive dhe Grupi Parlamentar Ndër-partiak për të Drejtat e Romëve në përbërjen parlamentare 2020 - 2024. Këto organe parlamentare treguan një angazhim serioz për zbatimin e zgjidhjes së përhershme për personat që nuk janë evidentuar në librin amë të të lindurve, si dhe për foshnjat e lindura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, fillimisht duke organizuar një seancë mbikëqyrëse, dhe më pas duke ndjekur drejtpërdrejt procesin e regjistrimit të personave në librin amë të të lindurve. Në përputhje me raportin e fundit të Drejtorisë për Administrimin e Evidencës Amë, 342 foshnja janë në procedurë të përcaktimit të emrit personal, nga të cilët për 62 është dhënë përgjigje, ndërsa për 280 ende nuk ka përgjigje nga qendrat për punë sociale²⁵.

²² <https://kszd.mk/odluki-i-mislenja/>

²³ <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657>

²⁴ Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Evidencën Amë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 0679 129/2023 datë 21.6.2023).

²⁵ Bisedë me Sonja Mirakovska, deputete në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, zhvilluar më datë 2.10.2024.

Në përputhje me informacionin nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë (në atë kohë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale), “në lidhje me aktivitetet e ndërmarra nga Drejtoria e Administrimit të Librave Amë për periudhën nga marsi 2023 deri në tremujorin e parë të vitit 2024, në kuadër të zbatimit të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për evidencën amë (‘Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut’ nr. 129/23), u bënë gjithsej 460 regjistrime shtesë në librat amë të lindurve për personat nga kjo kategori vulnerable nga 526 persona të identifikuar të paregjistruar. Nga 66 personat e tjerë, 7 persona vdiqën, për 2 persona procedura është në rrjedhë e sipër, ndërsa 26 persona janë të pa interesuar ose nuk mund të kontaktohen. Nga 460 personat që kanë marrë certifikatën e lindjes, 296 kanë pasur numër unik amë të identifikimit, dhe 164 nuk kanë pasur numër unik amë të identifikimit, ndërsa vetëm 10 persona kanë marrë dokumente personale”²⁶.

9) Legjislacioni kundër diskriminimit duhet të sigurojë:

a. Ndalim të diskriminimit racor të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi 2020 në Kapitullin II i përcakton qartë format dhe llojet e diskriminimit si diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, thirrja, nxitja dhe instruksioni për diskriminim, ngacmim, viktimizim, segregacion, si dhe forma më të rënda të diskriminimit.

b. Vendosja e masave efektive, proporcionale dhe bindëse për veprat ose praktikat diskriminuese.

Ligji i vitit 2020, si dhe ligjet e mëparshme, parashikon sanksione kundërvajtëse me qëllim të

parandalimit të përgjithshëm si për personat fizikë ashtu edhe për personat juridikë duke filluar prej 50 deri në 10 000 euro në kundërvlerë në denarë në varësi të shkëljes së ligjit nga kryerësi. Komisioni, në përputhje me Ligjin, ka kompetencë të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurave për kundërvajtje në gjykatën kompetente për kundërvajtje, para së cilës zhvillohen procedurat për kundërvajtje dhe shqiptohet sanksion për kundërvajtje në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Procedura për sjellje diskriminuese dhe ndërmarrjen e akteve diskriminuese parashikohet edhe në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese, ku në nenin 110 paragrafi 1 alineja 3 thuhet “Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut: mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit në lidhje me lirinë e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, asocimit dhe veprimit politik dhe ndalimin e diskriminimit ndaj qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, kombëtare, sociale dhe politike.” Përveç kornizës kushtetuese dhe penale, mbrojtja dhe sanksionimi i sjelljeve diskriminuese dhe kryerja e veprimeve diskriminuese parashikohet nga Kodi penal në pjesën e nenit 137 - Shkelja e barazisë së qytetarëve, neni 319-Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës mbi baza kombëtare, racore, fetare dhe të tjera baza diskriminuese, neni 394-d - Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik nëpërmjet një sistemi kompjuterik dhe neni 417 - Diskriminimi racor dhe çdo lloj tjetër diskriminimi.^{27,28}

²⁷ Akti i Gjykatës - Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut

²⁸ Kodi Penal (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 37/96, 80/99, 4/02, 43/03, 19/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 41/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15, 97/17 dhe 248/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 36/23 dhe 188/23).

²⁶ Bisedë me Latife Shikovska, aktiviste e OJQ-ve dhe ish-deputete në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e zhvilluar më datë 27.9.2024.

c. Vendosja e dënimeve më të rrepta për vepra penale me motive racore të kryera nga persona privatë dhe nga persona publike

Kodi penal në pjesën e veprave penale të motivuara nga diskriminimi dhe trajtimi i pabarabartë në vitin 2014 u ndryshua në dy aspekte. Aspekti i parë ishte përjashtimi i nenit 173 - Fyerja përmes sistemit kompjuterik ndaj anëtarëve mbi bazë racore, fetare, etnike, si dhe mbi bazë të ngjyrës së lëkurës, për shkak të dekriminalizimit të **veprave penale kundër nderit dhe reputacionit, ndërsa aspekti i dytë ka të bëjë me inkorporimin e veprës penale gjuha e urrejtjes duke e përfshirë nenin 319** – Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës mbi bazë kombëtare, racore, fetare dhe mbi bazë tjetër diskriminuese me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/2014) dhe për të njëjtin parashikohet dënim me burgim nga një deri në pesë vjet, dhe nëse vepra penale kryhet me shpërdorimin e pozitës zyrtare ose autorizimit apo shkakton tension ose dhunë, dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet. Politika e ndëshkimit për këtë vepër penale është e lartë duke i marrë parasysh dënimet e specifikuar ligjore.

ç. Qasje e barabartë në masat efektive (procedurat juridike, administrative për pajtim ose ndërmjetësim)

Qasja e qytetarëve në mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi është plotësisht i shkarkuar nga pengesat administrative, duke marrë parasysh mënyrën në të cilën parashtrihen parashtrës të Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit. Përveç këtyre dy institucioneve, qytetarët që janë objekt diskriminimi mund t’u drejtohen edhe të gjitha organeve të tjera që kanë kompetencë për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Këtu përfshihet edhe Komisioni i Përhershëm Anketues për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Megjithatë, mbesin shpenzimet e fshehura të personave që duan të denoncojnë diskriminim (shpenzimet e transportit, fotokopjimi i provave, etj.), por ato janë zvogëluar në mënyrë drastike sepse me Ligjin e ri për ndihmën juridike falas ajo organizohet në një mënyrë që të jetë më afër qytetarëve përmes shoqatave të qytetarëve të autorizuar për të ofruar ndihmë juridike primare. Kjo duket qartë nga fakti se, në përputhje me raportet e Ministrisë së Drejtësisë, ka një rritje drastike të numrit të personave të përkatësisë romë që janë drejtuar për ndihmë juridike primare. Për më tepër, në vitin 2020, 53 romë morën ndihmë juridike primare, në vitin 2020, 112 romë morën ndihmë juridike primare, ndërsa në vitin 2022, 257 romë morën ndihmë juridike primare²⁹.

Informacionet mbi mekanizmat për parandalimin e diskriminimit sigurojnë më shumë faktorë. Në vitin 2018, u zbatua një fushatë në gjashtë komuna nga rrjeti i organizatave që marrin sub-grante të projektit “Parandalimi i diskriminimit ndaj fëmijëve romë” të financuar nga Bashkimi Evropian. Në vitin 2021, Rrjeti pati një fushatë “Diskriminimi përfundon me mua” duke inkurajuar qytetarët ta denoncojnë diskriminimin³⁰.

10) Duhet të sigurohet që legjislacioni kombëtar ndalon çdo lloj veprimtarie diskriminuese dhe se të gjitha rastet e diskriminimit të pretenduar janë hetuar në mënyrë të detajuar dhe objektive

Ndalimi i diskriminimit parashikohet në nenin 9 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut si e drejta e parë kushtetuese civile e garantuar në Kapitullin II - Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit. Në nenin 9 specifikohet: “Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejta pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra e lëkurës, origjina kombëtare

²⁹ <https://www.pravda.gov.mk/resursi/10>

³⁰ https://mzd.mk/mk/vesti/ka_nisur_fushata-diskriminim/

dhe sociale, bindjet politike dhe fetare; pozitës pronësore dhe shoqërore. Qytetarët para Kushtetutës dhe ligjeve janë të barabartë.” Kjo dispozitë shtjellohet më tej në Kreun 2 të Ligjit për parandalimin dhe ndërprerjen e diskriminimit, ku janë përkufizuar format dhe llojet e diskriminimit.

Shteti ka krijuar katër mekanizma efektivë, i pari është procedura e parashikuar në nenin 110 të Kushtetutës që zhvillohet para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mekanizmi i dytë që tregon një shkallë të lartë efektiviteti është Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, mekanizmi i tretë mbrojtës është veprimi i Avokatit të Popullit dhe i fundit është vendosur mbrojtja gjyqësore në procedurat penale dhe civile.

11) Të krijojnë, aty ku përgjigjet, institucione të specializuara në mënyrë që të sigurohet zbatimi i legjislacionit të tillë, si dhe mekanizma vendas për monitorimin dhe raportimin e rregullt dhe transparent të progresit të arritur sa i përket zbatimit. Të inkurajohet pjesëmarrja e përfaqësuesve romë dhe sinti në organe të tilla, puna e të cilëve duhet të vihet në dispozicion të publikut

Me qëllim të vënies në dukje të nevojës për promovimin e barazisë dhe drejtësisë, brenda Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, në të gjitha përbërjet e mëparshme nga viti 2020, njëri nga anëtarët është me përkatësi rome. Deri më tani, dy herë, anëtar i kombësisë rome ka qenë kryetar i Komisionit.

Kjo praktikë u përcaktua më parë brenda zyrës së Avokatit të Popullit, ku një nga zëvendësit e tij ishte një grua rome, e cila ishte një shembull i mirë i inkurajimit të grave rome për tu përfshirë në mënyrë aktive në proceset shoqërore dhe për të krijuar në mënyrë aktive politika për të përmirësuar statusin e gruas rome në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, një grua rome ende nuk është zgjedhur në pozicionin e gjyqtarës,

as në pozicionin e prokurores publike, dhe as si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

12) Të zhvillohen, ku është e nevojshme, strategji gjithëpërfshirëse kombëtare ose plane veprimi për të përmirësuar situatën e romëve dhe sintive, të cilat përfshijnë masa specifike për të luftuar diskriminimin në të gjitha sferat e jetës

Në kuadër të “Strategjisë për Romët në Republikën e Maqedonisë 2014 - 2020” u përcaktuan prioritetet në lidhje me fushat si vijojnë: punësimi, arsimi, banimi, shëndetësia dhe kultura, por nuk u parashikuan mekanizma ose masa të veçanta për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe segregacioni i romëve.

Në Strategjinë për përfshirjen e romëve 2022 - 2030, parandalimi i diskriminimit ndaj romëve u inkadrua në vetë vizionin e Strategjisë, në qëllimet dhe parimet e saj kryesore.

Objektivi specifik për parandalimin dhe ndërprerjen e diskriminimit ndaj romëve është parashikuar në Objektivin strategjik 5: - Zhvillimi, kultivimi dhe promovimi i kulturës, gjuhës dhe traditës rome, ku parashikohet objektivi specifik 4: - Promovimi dhe njohja më e mirë e të tjerëve me kulturën rome dhe zvogëlimi i stereotipave dhe diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, perceptimeve negative dhe narrativeve anti rome në shoqëri, me qëllim që të kontribuohet në drejtim të shtypjes së teksteve shkollore që e përfaqësojnë më mirë kulturën rome dhe romët në përmbajtjet arsimore, produktet kulturore me përfaqësim më kompleks të komunitetit/identitetit dhe kulturës rome dhe pranimin dhe njohjen më të mirë të punëtorëve dhe artistëve kulturorë romë³¹.

³¹ <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/Strategija%20za%20inkluzija%20na%20Romite%202022-2030%2003-02-2022%20finalna%20verzija.pdf>

Strategjia parashikon Objektivin strategjik 8: Eliminimi i formave të manifestimit të anticiganizmit dhe zvogëlimi i diskriminimit ndaj romëve në drejtim të zvogëlimit të diskriminimit ndaj romëve të pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe si tregues i suksesit parashikohet që deri në vitin 2030 të ketë një rënie në përqindjen e romëve që janë përballur me ndonjë lloj diskriminimi. Në kuadër të këtij objekti strategjik parashikohen këto objektiva specifike: Identifikimi i konceptit të anticiganizmit në politikat publike dhe legjislacionin vendor; Përmirësimi i kuadrit institucional dhe politik; Mbështetja e viktimave nga diskriminimi dhe qasja në drejtësi; Çmontimi dhe parandalimi i diskriminimit institucional të përfjetuar nga romët³².

13) Të vlerësohen rregullisht, veçanërisht në nivel lokal, rezultatet e këtyre strategjive dhe të përfshihet komuniteti rom dhe sinti në procesin e evalvimit

Në kuadër të Strategjisë së romëve 2014 - 2020 dhe Strategjisë së romëve 2022 - 2030, u miratuan planet lokale për përmirësimin e gjendjes së romëve në nivel komunal përkatësisht lokal.

Në kuadër të Strategjisë për romët 2014 - 2020, në periudhën 2017 - 2020, u miratuan planet lokale të veprimit në disa komuna, në lidhje me punësimin, arsimin, shëndetësinë dhe gruan rome. Këto plane lokale të veprimit për periudhën 2017 - 2020 u miratuan në Berovë, Komunën e Delçevës, Komunën e Shtipit dhe Komunën e Tetovës, ndërsa për periudhën 2018 - 2020 u miratuan planet lokale të veprimit në Komunën e Shuto Orizarit, Komunën e Manastirit dhe Komunën e Kumanovës.

Pas miratimit të Strategjisë për përfshirjen e romëve 2022 - 2030, komunat iu qasën përgatitjes dhe miratimit të planeve lokale të veprimit për romët. 14 komuna me mbështetjen e shoqatës së

qytetarëve ROMALITIKO hartuan plane lokale të veprimit për romët për periudhën 2023 - 2026³³.

Përmes zbatimit të planeve lokale të veprimit, do të jetë e mundur të vlerësohen në nivel lokal efektet dhe rezultatet e Strategjisë, përmes shkallës së masave dhe aktiviteteve të zbatuara dhe duke vlerësuar dobinë e tyre.

14) Përmes inkurajimit të dialogut ose konsultimit të mirëfilltë apo përmes mjeteve të tjera këshilluese, të bëhen përpjekje në mënyrë që të përmirësohen marrëdhëniet midis romëve dhe sintive dhe qytetarëve të tjerë, me qëllim të promovimit të tolerancës dhe tejkalimit të paragjyqimeve dhe stereotipave negativë nga të dyja palët

Nga viti 2024, në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk janë zhvilluar mekanizma të veçantë përmes të cilëve shteti duhet të sigurojë kushte për komunikim midis romëve dhe qytetarëve të tjerë.

Megjithatë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut si një nga përcaktimet strategjike promovoi konceptin Një shoqërie brenda të cilit në vitin 2019 miratoi Strategjinë kombëtare për zhvillimin e një shoqërie dhe interkulturalizmit 2020 - 2022³⁴. Qëllimi kryesor i Strategjisë ishte promovimi i kushteve të barazisë, drejtësisë, gjithëpërfshirjes dhe përfshirjes në rrjedhat shoqërore të identiteteve të ndryshme, gjinore, kulturore, etnike, si dhe grupeve vulnerabile dhe të marginalizuara të qytetarëve. Pas zbatimit të kësaj Strategjie, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Strategjinë kombëtare për zhvillimin e interkulturalizmit dhe kohezionit shoqëror 2024 - 2026. Strategjia parashikon zbatimin e

³² Ibid.

³³ <https://romalitico.org/23/04/2024/publikacii/usvoeni-lokalni-akcioni-planovi-za-romi/>

³⁴ https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategii/strategija_ednoopshtestvo_29.10.2019.pdf

politikave publike në disa fusha të përafërta dhe të ndërlidhura midis tyre ndërkaq ajo është e ndarë në pesë (5) fusha prioritare: institucionet, politikat ndërkulturore, kohezioni shoqëror, arsimi dhe media. Hartimi i strategjive u bë përmes një procesi të gjerë participativ në të cilin morën pjesë mbi 140 shoqata të shoqërisë civile.

Në kuadër të këtyre strategjive, përfshihet edhe situata e romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe parashikohen masa posaçërisht në fushën e ofrimit të kushteve për mësimin e gjuhës rome nëpër shkolla, por këto dokumente strategjike nuk kishin një fokus më të madh mbi popullatën rome në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

15) Në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave, t'i dokumentojë të gjitha llojet dhe rastet përkatëse të diskriminimit për të vlerësuar më mirë situatën dhe për t'iu përgjigjur nevojave të romëve dhe sintive

Në fushën e identifikimit dhe denoncimit të diskriminimit ndaj romëve, u zhvilluan një sërë fushatash nga sektori qytetar, të mbështetura nga Delegacioni i BE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përkatësisht, në vitin 2018, u zbatua një fushatë në gjashtë komuna nga rrjeti i organizatave që marrin sub-grante nga Projekti "Parandalimi i diskriminimit ndaj fëmijëve romë" të financuar nga Bashkimi Evropian. Gjatë fushatës, 800 bluza, 10,000 fletëpalosje dhe mbi 600 posterë u shpërndanë në territorin e komunave të Kumanovës, Kriva Pallankës, Koçanit, Shtipit, Prilepit dhe Kërçovës, duke përhapur mesazhin e fushatës përmes aktiviteteve të projektit. Në fletëpalosjet e shpërndara qëndronte informacioni për një linjë telefonike falas, e-mail dhe grupi "Facebook"- ku qytetarët mund të denoncojnë raste diskriminimi³⁵.

³⁵ <https://www.nationalromacentrum.org/mk/vesti-i-slucuvanja/kampanjata-shest-opshtini/>

Përveç këtyre fushatave, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit kanë një pjesëmarrje aktive në lidhje me dokumentacionin, administrimin e statistikave për parashikimet e paraqitura dhe rastet e konstatuara të diskriminimit ndaj romëve.

Në periudhën kohore nga viti 2021 deri në mesin e vitit 2024, Komisioni ka përcaktuar diskriminim ndaj romëve në 23 lëndë nga të cilat më i shpeshtë është segregacioni dhe profilizimin racor gjatë përdorimit të shërbimeve dhe objekteve publike³⁶.

16) Të sigurohet një hetim i plotë dhe efektiv të veprave të dhunës ndaj romëve dhe sintive, veçanërisht në rastet kur ekziston dyshimi i bazuar se ato ishin të motivuar në baza racore, ndërsa autorët ndiqen penalisht në përputhje me ligjin vendas dhe standardet relevante të të drejtave të njeriut

Siç u tha më lart në pikën 9, Kodi penal në Republikën e Maqedonisë së Veriut parashikon katër vepra të veçanta penale me motive diskriminuese, racore, kombëtare, dhe fetare³⁷. Ndryshimet në Kodin penal në vitin 2014 futën veprën penale të gjuhës së urrejtjes, përkatësisht neni 319 Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës mbi baza kombëtare, racore, fetare dhe mbi baza të tjera diskriminuese³⁸.

Në të vërtetë, hetimet që zhvillohen për këto vepra penale nuk kanë status të veçantë, por ato zhvillohen si hetimet për krimin e zakonshëm. Në periudhën kohore deri në vitin 2020, nuk janë administruar statistika për ndjekjen e veprave

³⁶ <https://kszd.mk/odluki-i-mislenja/>

³⁷ Kodi penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/96, 80/99, 4/02, 43/03, 19/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 41/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15, 97/17 dhe 248/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 36/23 dhe 188/23).

³⁸ Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014).

penale të urrejtjes dhe diskriminimit në kuadër të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo vihet re edhe nga Këshilli i Evropës në Analizën e grumbullimit të të dhënave për gjuhën e urrejtjes dhe veprave penale të urrejtjes si pjesë e “Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë II 2019 - 2022” “Promovimi i Diversiteteve dhe Barazisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, ku specifikohet se “Megjithatë, Raporti vjetor i Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 nuk përmban një seksion të veçantë ose ndonjë të dhënë në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe veprat penale të urrejtjes, përkatësisht të dhënat e grumbulluara nuk janë klasifikuar në vepra penale të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes, diskriminimit dhe nuk përfshijnë një kategori tjetër të veçantë vulnerable të personave ose nuk i listojnë karakteristikat relevante të viktimës.” Por në vitin 2021, ka një ndryshim në mënyrë që në Raportin vjetor është përfshirë një grafë e veçantë për veprën penale të nenit 319 - Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës mbi bazë kombëtare, racore, fetare dhe mbi baza të tjera diskriminuese. Në periudhën 2021 - 2023, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut regjistroi 19 persona të denoncuar kundër të cilëve u ngritën 4 akuza dhe u nxorën 6 aktgjykime^{39, 4041}

Në pjesën e informacioneve dhe trajnimit të policisë për inicimin dhe zhvillimin e hetimit efektiv, trajnimi i vazhdueshëm për identifikimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes zhvillohet në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme⁴². Sipas Raportit Vjetor të vitit 2020 për Krimin nga Urejtja të hartuar nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Projektit “Mbështetja e Republikës së Maqedonisë së

Veriut në Promovimin e Sundimit të Ligjit dhe të Drejtave të Njeriut”, i cili mbështetet financiarisht nga Misioni i OSBE-së në Shkup, theksohet se më shumë se 2,000 policë morën pjesë në trajnimin për identifikimin e krimeve nga urrejtja midis viteve 2015 dhe 2016.”

17) Të sigurohet se nuk do të ekzistojë pandëshkueshmëri për kryerësit e veprave të diskriminimit ose dhunës, mes tjerash, policia duke ndërmarrë në kohë të duhur dhe në mënyrë efektive masa hetimore dhe ndëshkuese

Numri i parashtresave të paraqitura nga romët në periudhën 2020 - 2023 mbetet shumë i ulët në krahasim me numrin e përgjithshëm të parashtresave të paraqitura. Përkatësisht,, në vitin 2021⁴³ nga 101 parashtresa të paraqitura 7 janë paraqitur nga romët, në vitin 2022⁴⁴ nga 89 parashtresa vetëm dy janë paraqitur nga romët, ndërsa në vitin 2023⁴⁵ nga 302 parashtresa 12 janë paraqitur nga romët.

Kur bëhet fjalë për hetime dhe veprime policore në rastet e diskriminimit të romëve, në periudhën e kaluar ka pasur raste të shumta të segregacionit dhe profilizimit racor pikërisht nga ana e policisë për të parandaluar “azilkërkuesit e rremë” të dalin nga kufijtë e Republikës së Maqedonisë (në atë kohë). Nga vendosja e liberalizimit të vizave deri në vitin 2016, ekzistonte politikë e profilizimit racor të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (në atë

⁴³ <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2022/03/Godisen-izvestaj-2021.pdf>

⁴⁴ <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2023/05/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD-%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98-2022.pdf>

⁴⁵ <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2024/05/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98-%D0%BD%D0%B0-%D0%9A%D0%A1%D0%97%D0%94-%D0%B7%D0%B0-2023-%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D0%B0.pdf>

³⁹ Ibid.

⁴⁰ <https://rm.coe.int/data-collection-analysis-on-hate-speech-nm-mkd/168485b>

⁴¹ <https://jorm.gov.mk/godishen-za-rabotata-na-javnite-obvinitelstva-vo-2021-godina/>

⁴² <https://mvr.gov.mk/vest/24918>

kohë). Sipas analizës së raporteve të përgatitura nga FRONTEX, Byroja Amerikane e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Punës, dhe Këshilli i Evropës, deri në vitin 2014 rreth 20,000 romë ishin kthyer nga pikat e kalimit kufitar të shtetit. Për shkak të tendencës së rritjes së vazhdueshme të kësaj shifre ndër vite, mund të supozohet se deri në fund të vitit 2016 rreth 25,000 romë do të ktheheshin nga kufijtë shtetërorë⁴⁶. Organizatat e shoqërisë civile e trajtuan seriozisht këtë problem për faktin se bëhej fjalë për diskriminim ekskluzivisht ndaj romëve, prandaj iniciuan një kontest gjyqësor për përcaktimin e diskriminimit. Aktgjykimi i parë u nxor në Gjykatën Themelore Civile në Shkup, në të cilin ishte konstatuar diskriminim në bazë të përkatësisë etnike. Gjatë kësaj periudhe u ngritën dhjetëra lëndë gjyqësore, të cilat në pjesën më të madhe rezultuan në diskriminim të konstatuar. Pavarësisht praktikës gjyqësore, disa nga aktgjykimet në të cilat nuk u gjet diskriminim përfunduan në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, siç janë “Vendimi Xheladini kundër Republikës së Maqedonisë nr. 43440/15” dhe aktgjykimi i fundit Mededova dhe të tjerët nr. 42429/16⁴⁷, në të cilat u konstatua diskriminim nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Kësaj i parapriu Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 189/2012, datë 25 qershorit 2014, i cili shfuqizoi nenin 37 paragrafin 1 pikën 6 dhe nenin 38 paragrafin 4 të Ligjit për dokumentet e udhëtimit të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (në atë kohë). Gjykata Kushtetuese i shfuqizoi këto dispozita që u inkorporuan me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (në atë kohë), “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 135/2011 për shkak se parashikonin që shtetasve të dëbuar ose të kthyer nga një shtet tjetër duhet t’u hiqet dokumenti i

udhëtimit për një periudhë prej një viti⁴⁸. Gjykata Kushtetuese konstatoi se këto dispozita janë antikushtetuese sepse, sipas opinionit të Gjykatës, që një shtet shtetasit të vet që posedon një dokument të vlefshëm udhëtimi t’ia kufizojë të drejtën, përkatësisht lirinë për t’u larguar nga vendi i vet, duhet të ketë rrethana vërtet serioze dhe të jashtëzakonshme, siç janë ato të specifikuar në nenin 27 të Kushtetutës. Kufizimi i kontestuar, edhe pse i parashikuar me ligj, është i tepruar dhe disproporcional dhe nuk mund të përfshihet në kufizimet e lejueshme të kësaj të drejte sipas nenit 27 paragrafit 3 të Kushtetutës. Për këto arsye, Gjykata konstatoi se dispozitat e kontestuara të nenit 37 paragrafi 1 pika 6 dhe nenit 38 paragrafi 4 të Ligjit për dokumentet e udhëtimit të qytetarëve janë në kundërshtim me nenin 27 të Kushtetutës⁴⁹. Këto dispozita kufizuese në të vërtetë u inkorporuan për arsyen se shteti donte të kufizonte të drejtën e lëvizjes së personave të ashtuquajtur “azilkërkues të rremë”, shumica e të cilëve ishin romë, shtetas të Republikës së Maqedonisë (në atë kohë)⁵⁰.

⁴⁸ “Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit të shtetasve të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “nr.174/2011).

⁴⁹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut U. nr. 189/2012 datë 25 qershor 2014.

⁵⁰ Bisedë me Oliver Mitov, aktivist i OJQ dhe ekspert për çështjet e romëve, zhvilluar më datë 29.08.2024.

⁴⁶ <https://epi.org.mk/post/12618>

⁴⁷ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22tabview%22:%5B%22document%22%5D%2C%22itemid%22:%5B%22001-228661%22%5D%7D>

18) Të lehtësohet qasja në drejtësi për romët dhe sintit përmes masave të tilla si ndihma juridike dhe sigurimi i informacioneve në gjuhën rome

Ligji për ndihmën juridike falas i vitit 2019 lehtësoi në mënyrë drastike qasjen në drejtësi për grupet e marginalizuara të personave që i përfshin ky ligj. Me qëllim që ndihma juridike falas të jetë më e qasshme për të gjithë qytetarët, në kuadër të Projektit “Mbështetje për qasje më të mirë në shërbime më cilësore për ndihmë juridike falas në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, u zhvillua një fushatë publike për sigurimin e materialeve informuese për ndihmën juridike falas në gjuhën rome. Ky projekt është pjesë e programit “Instrumenti horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë II 2019 - 2022”, si një projekt i përbashkët i Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës i zbatuar nga Këshilli i Evropës⁵¹.

19) Të merret parasysh në të gjitha masat dhe programet gjendja e grave rome dhe sinti, të cilat shpesh janë viktimat të diskriminimit etnik dhe diskriminimit seksual

Gratë rome në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë një nga grupet më shpesh të marginalizuara dhe vulnerabël që janë objekt i diskriminimit të vazhdueshëm. Ky diskriminim mbështetet në dy baza, baza e parë është pozita e gruas, përkatësisht baza gjinore dhe përkatësia etnike si pjesëtare e komunitetit rom.

Për të kapërcyer stereotipat dhe paragjykimet e grave rome dhe për të përmirësuar pozitën e tyre, në vitin 2021 u miratua Plani kombëtar i veprimit për mbrojtjen, promovimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave rome 2022-

2024⁵². Plani i veprimit parashikon 38 aktivitete në gjashtë segmente të ndryshme: 1. Rritja e pavarësisë ekonomike të grave rome; 2. Sigurimi i kushteve për fitimin dhe përfundimin e arsimit formal të grave dhe vajzave rome; 3. Përmirësimi i mbrojtjes efektive të grave rome nga çdo formë e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje; 4. Qasje e përforcuar në drejtësi për gratë rome; 5. Qasje e përforcuar në mbrojtjen shëndetësor për gratë rome; 6. Rritja e pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike dhe kultivimi i liderizmit midis grave rome⁵³. Për zbatimin e këtij Plan veprimi, nuk është parashikuar kornizë financiare për zbatimin e aktiviteteve, gjë që përbën rrezik për zbatimin e Planit të veprimit. Deri më tani, intensiteti i zbatimit të aktiviteteve të Planit të veprimit është shumë i ulët sepse nuk janë parashikuar mjete të veçanta financiare për zbatimin e aktiviteteve që rezultojnë nga Plani i veprimit 2022 – 2024⁵⁴.

Lidhur me masat e marra deri më tani për përmirësimin e statusit të grave dhe vajzave rome, efektin më të madh e patën masat që kanë të bëjnë me arsimin dhe trajnime shtesë, të cilat përmirësojnë statusin social dhe ekonomik të grave dhe vajzave rome. Këto masa janë dhënia e bursave si në arsimin e mesëm ashtu edhe në arsimin universitar, ndërsa në një periudhë të caktuar edhe në arsimin fillor⁵⁵.

Për më tepër, masat për punësimin e grave dhe vajzave rome të zbatuara nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë efekt në statusin e tyre social dhe ekonomik, gjë që përmirëson pozitën e grave rome si në komunitetin

⁵¹ <https://www.coe.int/mk/web/skopje/-/helping-roma-community-in-north-macedonia-to-access-free-legal-aid-services>

⁵² https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/N%D0%90P_za%20zastita%20promocija%20i%20ispolnuvanje%20na%20cov.%20prava%20na%20zenite%20i%20devoj%20%20Romki%2015.03.2022.pdf

⁵³ Ibid.


⁵⁴ Bisedë me Nesime Salioska, aktiviste e OJQ dhe eksperte për çështjet e romëve, zhvilluar më datë 29.08.2024.

⁵⁵ Bisedë me Arabela Iljaz, bashkëpunëtore e lartë për arsimin fillor, Merita Mustafi dhe Suzana Shabanovska, koordinatorë e programit të ndërmjetësve arsimorë romë, zhvilluar më datë 26.08.2024.

rom ashtu edhe në shoqëri. Megjithatë, ende ekzistojnë paragjykime dhe stereotipa të forta në lidhje me gratë dhe vajzat rome si pjesë e stereotipave dhe paragjykimeve për romët në të gjitha segmentet shoqërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut⁵⁶.

Megjithatë, diskriminimi i drejtpërdrejtë është ende i pranishëm në fushën e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për gratë dhe vajzat rome, përkrah faktit se ka përpjekje nga shteti për të kapërcyer këtë situatë duke ofruar shërbime themelore shëndetësore. Gjegjësisht, siç elaborohet më poshtë, Ministria e Shëndetësisë ka bërë përpjekje të njëpasnjëshme për të siguruar një gjinekolog në komunitetin më të madh rom, në Shuto Orizarë, dhe pas një kohe të gjatë, përfundimisht u sigurua një gjinekolog që ordinon në këtë komunë. Ky është vetëm një hap i vogël për të kapërcyer problemet e qasjes së pabarabartë në shërbimet shëndetësore që shteti është i detyruar t'ua ofrojë të gjithë qytetarëve në kushte të barabarta.

⁵⁶ Bisedë me Nesime Salioska, aktiviste e OJQ dhe eksperte për çështjet e romëve, zhvilluar më datë 29.08.2024.





Policia

27) Zhvillimi i programeve të trajnimit për parandalimin e përdorimit të tepruar të forcës dhe për të promovuar ndërgjegjësimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut

Republika e Maqedonisë së Veriut është përballur me kritika të ashpra nga bashkësia ndërkombëtare për forcë të tepruar nga nëpunësit e policisë, gjë që është nënvizuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Gjykata Evropiane në rastet “Jashar kundër *Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*”⁵⁷, “Xheladinov kundër *Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*”⁵⁸, “Hajrullahu kundër *Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*”⁵⁹, vuri në dukje përdorimin e forcës së tepruar nga nëpunësit e policisë në raste konkrete dhe konstatoi shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nga ana tjetër, në lëndët konkrete u nënvizua se shteti nuk ka ndërmarrë një hetim efektiv për zbulimin e këtyre shkeljeve dhe sanksionimin e autorëve të tyre.

⁵⁷ JASAR v. _THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA.pdf; <https://biroescp.gov.mk/aktgjykimet> dhe vendimet e rm/jashar-kundër-republikës së maqedonisë/

⁵⁸ DZELADINOV AND OTHERS v. “THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA”; https://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/XHELADINOVI_DHE_TË_TJERË_KUNDËR_REPUBLIKËS_SË_MAQEDONISË.pdf

⁵⁹ HAJRULLAHU v. “THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA”; https://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/HAJRULLAHU_KUNDËR_REPUBLIKËS_SË_MAQEDONISË-Aktgjykim.pdf

Në vitin 2019, Qendra e Gjenevës për Menaxhimin e Sektorit të Sigurisë (DCAF) hartoi **Manualin e Trajnimit të Integritetit Policor** në kuadër të Programit të Ndërtimit të Integritetit Policor (PNIP). DCAF bashkëpunon me vendet, me kërkesë të tyre, për hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e projekteve që synojnë krijimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve policore që i përmbahen standardeve më të larta të integritetit dhe profesionalizmit⁶⁰, i cili i jep referencë të veçantë krijimit të moduleve të trajnimit duke përfshirë module të veçanta: Veprimi joadekuat i policisë; Kontrolli i kolegëve dhe raportimi i veprimit joadekuat; dhe barazia gjinore, mosdiskriminimi dhe integriteti i policisë. Ky manual synon nëpërmjet trajnimeve rritjen e profesionalizmit të punonjësve të policisë dhe promovimin e një shkalle më të lartë të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe integritetit personal të personave në procedurat policore.

Në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve Penale dhe Standardeve Profesionale është kompetent të veprojë në rastet e veprimit joadekuat të policisë nga anëtarët e policisë. Në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë miratuar disa dokumente që rregullojnë parimet dhe mënyrën e veprimit të punonjësve

⁶⁰ https://www.dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/DCAF_PIBP_Training%20Manual_MKD_2019_web.pdf

të policisë, siç është, për shembull, Programi për Forcimin e Integritetit të Punonjësve të Policisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme⁶¹. Në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm, nuk ka trajnim ose udhëzim të veçantë për veprimin e ankesave të paraqitura nga anëtarët e komunitetit rom, as statistika të veçanta për to, por qasja është e përgjithshme për të gjithë parashtruesit e kallëzimeve për veprimin joadekuat të policisë⁶². Kjo qasje përdoret për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për raportimin e veprimit joadekuat të policisë, për të cilin Departamenti i Kontrollit të Brendshëm përdori fletëpalosje dhe posterë për të informuar për mundësinë e raportimit të korrupsionit, sjelljes joadequate të policisë dhe parregullsive të tjera si në stacionet e policisë ashtu edhe në vendkalimet kufitare⁶³. Për këtë qëllim, nga MPB është hapur edhe linja telefonike 199, në të cilën mund të raportohen të gjitha parregullsitë që lidhen me veprimin dhe punën e policisë. Në përputhje me veprimin e deritanishëm, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm është i detyruar të veprojë për çdo kallëzim të veprimit joadekuat të policisë. Për punën e vet, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm përgatit raporte që paraqesin veprimtarinë e këtij Departamenti në përputhje me kompetencat dhe statistikat e çështjeve⁶⁴.

⁶¹ https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload//Programi%20for%20police%20integrity.pdf

⁶² Bisedë me Igor Arsovski, ish-ndihmësministër i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve Penale dhe Standardeve Profesionale në Ministrinë e Brendshme, dhe Danica Dimitrovska, Kryeinspektore për Rendin Publik dhe Paqen dhe Parandalimin në Njësinë për Rendin Publik dhe Paqen dhe Parandalimin në Divizionin e Çështjeve të Policisë me Kompetencë të Përgjithshme në Departamentin e Policisë me Uniformë në Byronë e Sigurisë Publike, të mbajtur më 12.8.2024.

⁶³ Ibid.

⁶⁴ <https://mvr.gov.mk/page/sektor-za-vnatreshna-kontrola>

Me qëllim që të parandalohet por edhe të luftohet veprimi joligjor në kuadër të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit u formua Seksioni i Specializuar për Ndjekjen e Veprave Penale të Kryera nga Persona me Autorizime Policore dhe nga Pjesëtarët e Policisë së Burgjeve.⁶⁵

MPB ka miratuar Planin e integritetit dhe Planin e veprimit për zbatimin e Planit të integritetit 2023 - 2025, i cili parashikohet të jetë një mjet parandalues kundër korrupsionit, sepse synon të promovojë dhe forcojë integritetin, profesionalizmin, etikën, si dhe zbatimin e vlerave morale dhe standardeve profesionale⁶⁶. Ndërkohë, në ndryshimet në Ligjin për Policinë dhe Ligjin për Punët e Brendshme u inkorporua një test i detyrueshëm për integritet që është në fazën e fundit të përgatitjes për aplikim, për shkak të implikimeve materiale dhe financiare të sistemit për kontrollin e integritetit të punonjësve të policisë⁶⁷.

Përkrah të gjitha këtyre aktiviteteve, Komisioni Evropian vuri në dukje në Raport Progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2023 se janë evidentuara raste të diskriminimit dhe brutalitetit policor në bazë të përkatësisë etnike

⁶⁵ <https://jorm.gov.mk/osnovno-javno-obvinitelstvo-za-gonen/>

⁶⁶ https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Plan%20za%20integritet%202023-2025/Plan%20za%20integritet%20MVR%202023-25_04_06_2023_MKD_web.pdf

⁶⁷ Bisedë me Igor Arsovski, ish-ndihmësministër i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve Penale dhe Standardeve Profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe Danica Dimitrovska, Kryeinspektore për Rendin Publik dhe Paqen dhe Parandalimin në Njësinë për Rendin Publik dhe Paqen dhe Parandalimin në Sektorin e Punëve të Policisë me Kompetencë të Përgjithshme në Departamentin e Policisë me Uniformë në Byronë e Sigurisë Publike, të zhvilluara më datë 12.8.2024.

rome, veçanërisht ndaj romëve të rinj, vajzave dhe romëve në paraburgim”⁶⁸.

28) Zhvillimi i politikave: (1) për përmirësimin e marrëdhënieve midis komunitetit rom dhe sinti dhe policisë, me qëllim parandalimin e abuzimit dhe dhunës së policisë ndaj romëve dhe sintive; dhe (2) për përmirësimin e besimit të romëve dhe sintive ndaj policisë

Me qëllim sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe qasje më të thjeshtë dhe më të lehtë në polici për banorët e komunës Shuto Orizarë, në vitin 2019, u hap për herë të parë Seksioni i Policisë (SP) Shuto Orizarë në kuadër të Stacionit të Policisë Çair si pjesë e konceptit “Policia - në Shërbim të Qytetarëve”⁶⁹. Që nga fillimi i tij, Seksioni i Policisë Shuto Orizarë është drejtuar nga një komandant i përkatësisë etnike rome⁷⁰, i cili është një hap pozitiv drejt afrimit të policisë me romët në komunitetin më të madh rom në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Veçanërisht duhet theksuar se inspektorja e rendit dhe qetësisë publike në Shuto Orizarë ka një rol aktiv në fushën e parandalimit. Ajo është me përkatësi etnike rome dhe ka shumë vite përvojë pune me komunitetin rom në Shuto Orizarë.

Në SP Shuto Orizarë ka përfaqësim të barabartë etnik midis punonjësve policorë, përkatësisht 1/3 romë, 1/3 maqedonas dhe 1/3 shqiptarë. Ekziston rreziku që numri i punonjësve romë të ulet në mënyrë drastike për shkak të rrjedhjes natyrore duke u pensionuar punonjësit romë të policisë në vitet e ardhshme⁷¹.

Punonjësit e policisë nga SP Shuto Orizarë theksuan se është e nevojshme të rriten aktivitetet për të rritur ndërgjegjësimin për përfshirjen e romëve në mënyrë që të kapërcehen stereotipat ndaj komunitetit rom.

Është interesante se SP Shuto Orizarë është një nga vendet e përcaktuara për daktiloskopinë e personave pa dokumente me qëllim vendosjen e kontaktit dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me personat pa dokumente.

29) Zhvillimi i politikave dhe procedurave për të siguruar një reagim efektiv të policisë ndaj dhunës së motivuar racore ndaj romëve dhe sintive

Republika e Maqedonisë së Veriut ka ndërmarrë hapa në periudhën e kaluar së bashku me partnerët e saj ndërkombëtarë për të rritur ndërgjegjësimin e punonjësve të policisë për identifikimin e gjuhës së urrejtjes, si dhe sjelljen diskriminuese, të cilat janë theksuar në pikën 16 dhe pikën 27 në Manualin për zbatimin e trajnimit për integritetin e policisë. Megjithatë, këto aktivitete janë në nivelin e trajnimit për punonjësit e policisë.

Ka mungesë të mekanizmave, siç janë procedurat standarde të operimit për parandalimin dhe luftimin e dhunës së motivuar racore.

30) Në konsultim me policinë kombëtare, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e komunitetit rom dhe sinti, të vlerësohen dallimet midis standardeve ndërkombëtare të policisë dhe praktikave aktuale kombëtare

Me qëllim përmirësimin e marrëdhënieve midis policisë dhe komunitetit rom, përfaqësues nga SP Shuto Orizarë kanë komunikim me shkollat fillore dhe të mesme në territorin e komunës së Shuto Orizarës. Informimi i nxënësve në shkollat

⁶⁸ <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657>

⁶⁹ <https://mvr.gov.mk/vest/9391>

⁷⁰ Bisedë me Kiro Gračanski, Komandant i SP Shuto Orizarë, dhe Imirzat Selim, Inspektore e Rendit dhe Qetësisë Publike dhe Parandalimit në SP Shuto Orizarë, mbajtur më datë 15.8.2024.

⁷¹ Ibid.

fillore dhe të mesme bëhet përmes një grupi të përzgjedhur prej 30 nxënësish të cilët më tej ia kalojnë informacionin shokëve të tyre të klasës. Informimi i nxënësve kryhet në gjuhën rome dhe maqedonase nëse në grupin ka edhe nxënës nga komuniteti shqiptar, atëherë edhe në gjuhën shqipe⁷². Shoqatat qytetare rome kanë një qasje serioze që është një ndihmë e veçantë në punën e policisë në Shuto Orizarë.

Aktiviteti i policisë në shkollat fillore dhe të mesme në Shuto Orizarë është pjesë e aktiviteteve parandaluese të planifikuara në nivel të Ministrisë së Punëve të Brendshme për parandalimin e gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

MPB është pjesë e Protokollit Ndërsektorial për Veprim ndaj Fëmijëve të Rugës nga viti 2022, ku ka një rol aktiv së bashku me Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe sektorin qytetar dhe vetëqeverisjen lokale. Nëpërmjet këtij Protokollit, institucionet kompetente synojnë të krijojnë një qasje të unifikuar ndërsektoriale për të ndihmuar, mbështetur dhe mbrojtur fëmijët e rrugës dhe që nuk kanë përkujdesje⁷³.

31) Të elaborohen, ku është e përshtatshme, dhe në bashkëpunim të ngushtë me organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile rome, politikat e përcaktuara, kodet e sjelljes, manualët udhëzues dhe programet e trajnimit

Në vitin 2023, MPB në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Shkup zbatoi Projektin "Policia dhe

Romët - puna efektive e policisë për ankesat për të drejtat e njeriut", i cili u zbatua në tre pjesë në periudhën e vitit 2023. Pjesa e parë ishte një trajnim për trajnuesit në të cilin u trajnuan 22 trajnues nga radhët e punonjësve të policisë. Aktiviteti i dytë ishte trajnimi i 312 punonjësve të policisë, nga të cilët 243 ose 78% ishin burra dhe 69 ose 22% ishin gra, nga trajnuesit e trajnuar në gjithsej 13 trajnime. Aktiviteti i fundit ishte tryeza e rumbullakët përfundimtare ku u përmbledhën konkluzionet e trajnimeve të zhvilluara. Është interesante të theksohet se, megjithëse përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale u ftuan në trajnime dhe tryeza të rumbullakëta, këto institucione nuk morën pjesë në këto ngjarje⁷⁴. Qëllimi i këtij projekti është të rrisë besimin e komunitetit rom ndaj policisë dhe të prezantojë komunitetin rom për të kapërcyer stereotipat ndaj tij nga punonjësit e policisë.

32) Të inkurajohen romët dhe sintit të punojnë në institucionet ligjzbatuese për të promovuar tolerancën dhe diversitetin në planin afatgjatë

Në kuadër të institucioneve ligj-zbatuese, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme, Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjykatave, nuk ka masa të veçanta për të inkurajuar romët të punësohen në ato institucione.

Të rinjtë romë kanë dëshirë të punësohen në polici, por nuk arrijnë të pranohen në trajnimin bazë për punonjës të policisë⁷⁵. Në të njëjtën kohë, nuk ka mënyrë për të parandaluar abuzimin e mundshëm

⁷² Ibid.

⁷³ [https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/publikacii_2022/femijeh%20on%20street/Protokoll%20\[%20Book%20\]%20MKD%20-%20WEB.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/publikacii_2022/femijeh%20on%20street/Protokoll%20[%20Book%20]%20MKD%20-%20WEB.pdf)

⁷⁴ Bisedë me Metju Xhons dhe Afrim Bajrami, Misioni i OSBE-së në Shkup, e mbajtur më datë 15.8.2024.

⁷⁵ Bisedë me Kiro Graçanski, Komandir i SP Shuto Orizarë, dhe Imirzat Selim, Inspektore e Rendit dhe Qetësisë Publike dhe Parandalimit në SP Shuto Orizarë, mbajtur më datë 15.8.2024.


për aplikimin e kandidatëve për punonjës policie nga persona të një komuniteti tjetër etnik siç janë romët vetëm për të pasur hyrje më të lehtë në trajnimin bazë⁷⁶.

Përfaqësimi i ulët i romëve është i dukshëm edhe përmes faktit se është listuar në pikën 26 të këtij raporti, në përputhje me të cilin numri i romëve në polici, prokurorinë publike dhe gjykata nuk është rritur aspak, por është në stagnim të vazhdueshëm, me një trend të caktuar të lehtë në rënie. Gjegjësisht, në pesë vitet e fundit në MPB përqindja e të punësuarve romë është 0.6% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve, që është më shumë se katër herë më e ulët se përqindja e romëve në numrin e përgjithshëm të banorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Situata është shumë më e keqe në prokurorinë publike, ku janë të punësuar vetëm katër romë, ndërsa në gjykata situata është më e mirë sepse ka të punësuar 22 romë. Problemi kryesor është se nuk ka masa aktive as për pozicionet jo-drejtuese, as për pozicionet drejtuese. Përveç kësaj, nuk ka masa përmes të cilave do të fillojë procesi i përzgjedhjes së romëve si gjyqtarë ose prokurorë publikë, megjithëse ka juristë romë me kualifikime të përshtatshme për kryerjen e këtyre funksioneve. Në periudhën 2015 - 2018, një grua rome juriste ka aplikuar për gjyqtare, por Këshilli Gjyqësor nuk e ka zgjedhur atë.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka vetëm një gjyqtar rom në Gjykatën Themelore Gostivar, ndërsa nuk ka asnjë prokuror publik. Duke qenë se e vetmja hyrje në gjykatat dhe prokuroritë publike është Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, janë bërë kuota të veçanta për komunitetet jo-shumicë. Në shtatë gjeneratat e para kishte vetëm dy kandidatë romë, por ata nuk u bënë kandidatë sepse nuk kishin pikë të mjaftueshme në provimin pranues⁷⁷.

⁷⁶ Bisedë me Igor Arsovski, ish-ndihmësministër i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve Penale dhe Standardeve Profesionale në Ministrinë e Brendshme, dhe Danica Dimitrovska, Kryeinspektore për Rendin Publik dhe Paqen dhe Parandalimin në Njësinë për Rendin Publik dhe Paqen dhe Parandalimin në Divizionin e Çështjeve të Policisë me Kompetencë të Përgjithshme në Departamentin e Policisë me Uniformë në Byronë e Sigurisë Publike, të mbajtur më 12.8.2024.

⁷⁷ Bisedë me Natasha Gaber Damjanovska, Drejtoreshë e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, e mbajtur më datë 25.6.2024.





Mediat masive

36) Lançimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjëse për të zvogëluar paragjykimet dhe stereotipat negativë për romët dhe sintit

Fushatat informuese për të zvogëluar paragjykimet dhe stereotipat negative për romët nuk janë shumë të zakonshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në kuadër të organeve shtetërore, ky lloj fushatash organizohet shumë rrallë. Rritja e fundit e aktiviteteve të ndërgjegjësimit është kryesisht rezultat i projekteve të ndryshme të financuara nga donatorët, përmes të cilave organizatat e shoqërisë civile që punojnë për të drejtat e romëve kanë organizuar fushata që synojnë nxitjen e mirëkuptimit midis komuniteteve etnike dhe tejkalimin e paragjyimeve dhe stereotipave kundër romëve.

Fushata me fushëveprimin më të gjerë ishte fushata MJAFT e Këshillit të Evropës⁷⁸ si një projekt i përbashkët me Komisionin Evropian, i cili u zhvillua në periudhën 2006 - 2019, fillimisht në vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe më pas ishte i hapur për të gjitha vendet e Këshillit të Evropës. 29 shtete anëtare të Këshillit të Evropës morën pjesë në fushatë. Objektivat kryesore të kësaj fushate ishin: lufta kundër stereotipave dhe paragjyimeve

negative ndaj romëve; lufta kundër anticiganizmit në kuadër të politikave/ masave kundër racizmit dhe diskriminimit; rritja e ndërgjegjësimit për kulturën, gjuhën dhe historinë rome.

Në kuadër të fushatës MJAFT, në Republikën e Maqedonisë së Veriut u përpiluan materiale promovuese për të paraqitur kulturën, gjuhën dhe historinë për njohje më të mirë me romët, në mënyrë që të tejkalohen paragjykimet dhe stereotipat.

Në fushën e zhvillimit të kulturës rome, Ministria e Kulturës nuk i kushton vëmendje të mjaftueshme projekteve të kulturës rome. Gjegjësisht, shumë pak projekte për zhvillimin e kulturës rome financohen në kuadër të programit vjetor të Ministrisë së Kulturës. Kjo situatë është edhe për shkak të procedurës së aplikimit, e cila kryhet vetëm në mënyrë elektronike, e që paraqet problem për personat fizikë të cilët në rastin e projekteve për zhvillimin e kulturës rome më së shumti paraqiten si aplikantë. Nga ana tjetër, Ministria e Kulturës ndan fonde shumë të vogla për të mbështetur këto projekte, përkatësisht shumat që ndan plotësisht nuk i përmbushin kërkesat për zbatimin e aktiviteteve të projektit. Megjithatë, ka nisma brenda Ministrisë së Kulturës që mbështeten edhe nga organizata ndërkombëtare për të rritur mbështetjen për projektet e zhvillimit të kulturës rome⁷⁹.

37) Në mënyrë që të inkurajohet liria e

⁷⁸ <https://www.coe.int/en/web/roma-and-travellers/dosta-campaign#:~:text=Dosta%20means%20%22enough%22%20in%20a,deep%2Drooted%20prejudices%20and%20stereotypes.>

⁷⁹ Bisedë me Makedonka Koceva, Ministria e Kulturës dhe Turizmit, e mbajtur më 11.7.2024.

shprehjes, të stimulohet trajnimi i gazetarëve që janë romë dhe sinti dhe punësimi i tyre në media, me synimin që të mundësohet qasje më e madhe në media për romët dhe sintit

Në vitin 2011, Instituti Maqedonas për Media së bashku me Transitions⁸⁰, Qendrën Informative Rome, Qendrën e Medias - Sarajevë dhe Shkollën e Gazetarisë - Novi Sad zbatuan projektin “Romët në Publik” që synonte promovimin e mbulimit mediatik të komuniteteve rome në këto vende. Në kuadër të këtij projekti, u trajnuan gjashtë gazetarë nga Republika e Maqedonisë (në atë kohë), gjysma e të cilëve ishin romë të cilët pas trajnimit morën pjesë në aktivitete nga të cilat rezultoi një portal rajonal në internet www.tocak.org kushtuar çështjeve rome, si dhe një radio program për romët në Bosnje.

Ndërkohë, nuk kishte ndonjë veprim ose politikë konsistente për angazhimin e romëve në gazetari. Përkundër kësaj, pjesëmarrja e tyre ishte e dukshme veçanërisht në fushën e raportimit të çështjeve që lidhen me gjendjen e romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në vitin 2020, organizata e shoqërisë civile Romaversitas filloi botimin e gazetës elektronike “Roma Indeks”. Qëllimi i këtij mediumi është të informojë, edukojë dhe argëtojë lexuesit për çështje të jetës së përditshme, që lidhen me arsimin, rininë, identitetin rom, dhe temat dhe problemet aktuale me të cilat përballen shoqëria. Qëllimi i “Roma Indeks” është të informojë për personalitetet e suksesshme, por edhe të ndërtojë individë të cilët do të përfaqësohen në mënyrë aktive në proceset e krijimit dhe miratimit të politikave publike në nivel lokal dhe kombëtar⁸¹.

Në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka vetëm dy televizione lokale/rajonale dhe një radio stacion që transmeton program në gjuhën rome. Që nga viti 1994, programi i dytë i “Televizionit Maqedonas” transmeton një program në gjuhën rome me kohë të kufizuar, si dhe kanali i tretë i “Radios Maqedonase - Shërbimi i Tretë Programor”⁸². I vetmi transmetim televiziv privat në gjuhën rome është “B1 TV”, i cili u transformua nga ish “Shutel Televizioni” në vitin 2021. Deri në vitin 2014, “BTR Televizioni”⁸³, i cili gjithashtu transmetonte program në gjuhën rome dhe maqedonase, humbi licencën e transmetimit në vitin 2014.

38) Të Inkurajohen mediat në portretizimin e aspekteve pozitive dhe pasqyrimin e panoramës së ekuilibruar të jetës së romëve, të përmbahen nga ndërtimi i stereotipave rreth romëve dhe sintive dhe të shmangin shkaktimin e tensioneve midis grupeve të ndryshme etnike. Të organizohen diskutime midis përfaqësuesve të mediave dhe romëve dhe sintive për promovimin e këtij synimi.

Romaversitas boton gazetën elektronike “Roma Indeks”⁸⁴, e cila, përveç edukimit, informimit dhe argëtimit, në fakt, në përmbajtjen e saj paraqet autorë, kolumnistë, analistë dhe persona të tjerë të shquar të përkatësisë rome, e cila është një mënyrë afirmative për të kapërcyer stereotipat për romët, dhe ndihmon në angazhimin e përbashkët në krijimin e politikave publike për përmirësimin e gjendjes së romëve përmes përfshirjes në të gjitha proceset shoqërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në të kundërt, anti-ciganizmi dhe gjuha e urrejtjes janë përgjithësisht ende të pranishme, veçanërisht

⁸⁰ Updates from Sarajevo: Conference and New Project Kickoff – Transitions

⁸¹ https://issuu.com/romaversitas/docs/roma_index_8

⁸² <https://marketing365.mk/makedonski-radio-stanici/>

⁸³ [https://avmu.mk/wp-content/uploads/2018/11/Studim për përcaktimkin e gjendjes nëTV-tregun rajonal dhe lokal....pdf](https://avmu.mk/wp-content/uploads/2018/11/Studim_për_përcaktimkin_e_gjendjes_nëTV-tregun_rajonal_dhe_lokal....pdf)

⁸⁴ Ibid.

në pjesën rome, e cila është e pranishme kryesisht në rrjetet sociale, përkatësisht në hapësirën e internetit. Këtë e vë në dukje Analiza “Kontekstet për romët në mediat maqedonase - diskriminimi, gjuha e urrejtjes dhe anticiganizmi” si pjesë e projektit Analiza - Edukimi mediatik dhe gjuha e urrejtjes të rinjtë⁸⁵ zbatuar nga Qendra Edukative e Medias 24 Vakti. Analiza tregon se “76% e të anketuarve besojnë se portalet në internet, duke përdorur postime dhe komente në rrjetet sociale, debatet publike i vendosën në nivelin e nënçmimeve dhe fyerjeve”⁸⁶.

Kapitulli IV i Planit të veprimit - Çështjet socio-ekonomike

I. Banimi dhe kushtet e strehimit

43) Të krijohen mekanizma dhe procedura institucionale për sqarimin e të drejtave të pronësisë, zgjidhjen e kontesteve të pronësisë dhe rregullimin e statusit juridik të romëve dhe sintive që jetojnë në kushte të legalitetit të pazgjidhur (p.sh. vendbanimet rome me ndërtime informale ose që nuk janë përfshirë në planin e detajuar urbanistik të vendbanimit kryesor; familje dhe shtëpitë pa status legal të qëndrimit në lagje ku ata de facto kanë jetuar me dekada).

Me miratimin e Ligjit për Veprimin me Objektet e Ndërtuara në Mënyrë të Paligjshme⁸⁷ në vitin 2011, filloi zgjidhja e problemeve me objektet jolegale në territorin e Republikës së Maqedonisë (në atë kohë). Në procesin e “legalizimit” të objekteve informale, një numër i madh romësh që zotëronin objekte të ndërtuara në mënyrë të paligjshme,

iu dha mundësia t’i legalizojnë. Ky ligj nga miratimi në mars të vitit 2011 deri në vitin 2023 dha rezultatin e dëshiruar që mund të shihet nga numri i objekteve të legalizuara në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Konkretisht, ligji legalizoi 296.810 objekte të ndërtuara në mënyrë të paligjshme⁸⁸. Në përputhje me hartën sociale të vitit 2019, u legalizuan 49% e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme për të cilat u paraqit kërkesë për legalizim, 17% ishin ende në procedurë, ndërsa 29% nuk u legalizuan, nga të cilat përqindja më e lartë e objekteve të palegalizuara u regjistrua në Manastir (67%), Vinicë (59%), Kumanovë (53%), Kavadar (44%), Strumicë (40%), Kërçovë (38%) dhe Shuto Orizarë (22%)⁸⁹.

Në një bisedë me kryetarin e komunës së Shuto Orizarës, u theksua se “legalizimi” në territorin e komunës mund të konsiderohet i përfunduar, dhe se vetëm objektet e kontestuar janë në procedurë⁹⁰. Një konkluzion i ngjashëm në lidhje me gjendjen e legalizimit të objekteve informale u theksua edhe nga z. Ibrahim Ibrahim, Koordinator për Zhvillimin Ekonomik Lokal në Komunën Shuto Orizarë⁹¹.

Procesi i legalizimit të vendbanimeve rome u mbështet me mikrokreditimin nga Habitat - Maqedonia⁹², e cila është një organizatë jofitimprurëse, pjesë e rrjetit global, e përkushtuar për të ofruar zgjidhje të thjeshta, të denja dhe të përbalueshme për familjet me të ardhura të ulëta që jetojnë në kushte varfërie, pavarësisht nga

⁸⁵ <https://issuu.com/salimemed/docs/>

⁸⁶ Ibid.

⁸⁷ Ligji për veprimin me objekte të ndërtuara në mënyrë të paligjshme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 23/11).

⁸⁸ <https://360stepeni.mk/vo-makedonija-dosega-se-legalizirani-rechisi-300-000-divogradbi/>

⁸⁹ https://mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/2019/Final%20Social%20mapping%20report_English.pdf

⁹⁰ Bisedë me z. Kurto Dudush, Kryetar i Komunës Shuto Orizarë, mbajtur më datë 27.6.2024.

⁹¹ Bisedë me z. Ibrahim Ibrahim, Koordinator për Zhvillimin Ekonomik Lokal, Komuna Shuto Orizarë, mbajtur më datë 27.6.2024.

⁹² <https://faktor.mk/130-romski-semejstva-dobija-zaem-za-legalizacija-na-domovite-vo-prilep>

përkatësia e tyre etnike, gjinore dhe fetare⁹³. Linja kreditore u zbatua përmes Fondacionit Horizonte për Zhvillim Ekonomik.

44) Përfshirja e romëve dhe sintive në krijimin e politikave të banimit, si dhe në ndërtimin, restaurimin dhe/ose mirëmbajtjen e projekteve të banimit publik të destinuara për ta. Të sigurohet që projektet e banimit të mos nxisin ndarje etnike dhe/ose racore.

Banimi është një nga problemet kryesore me të cilat përballen romët në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Strategjia për Përfshirjen e Romëve 2023 - 2030 i përkushton një pjesë të veçantë banimit, i cili është me rëndësi thelbësore për përmirësimin e gjendjes së romëve, kryesisht nga pikëpamja humane.

Në pjesën e sigurimit të kushteve të banimit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuadër të dokumenteve strategjike siguron mjete financiare për ndërtimin e infrastrukturës në lagjet rome me qëllim të sigurimit të kushteve themelore të jetesës. Ministria e Transportit dhe Lidhjeve (e atëhershme) ofroi një program të veçantë të mbështetjes financiare për ndërtimin e infrastrukturës bazë për komunat në të cilat ka lagje në të cilat jetojnë romët. Përkatësisht, në vitin 2021, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, sipas shpalljes publike, ndau 3 000 000 denarë për mbështetje financiare për përfshirjen sociale të romëve në 15 komuna, duke ndarë nga 103 887 denarë deri në 648 567 denarë⁹⁴.

Në vitin 2023, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve përmes mjeteve të ndara për zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Romëve 2022 - 2030 ndau 20 000 000 denarë për projekte infrastrukturore⁹⁵.

Romët gjithnjë e më shumë marrin pjesë në krijimin e politikave të banimit, të tilla si përmes ministrit pa portofol përgjegjës për çështjet që lidhen me romët, Këshilltarit për Çështjet e Romëve të Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Trupit Kombëtar Koordinues për Zbatimin e Strategjisë së Romëve dhe të tjerë. Megjithatë, niveli i pjesëmarrjes është akoma i ulët për sa i përket pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo situatë është vënë re nga organizatat e shoqërisë civile si dhe organizatat ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, në vitin 2020, Qendra Kombëtare e Romëve hartoi Dokument të Politikave Publike - Situata e grave rome në Republikën e Maqedonisë së Veriut në drejtim të zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), nga e cila një nga rekomandimet kryesore është se "Nevojitet të forcohen kapacitetet e vetëqeverisjeve lokale në mënyrë që të krijohen politika lokale për integrimin e romëve, bazuar në prova, të cilat në fushën e banimit ofrojnë masa specifike të destinuara ekskluzivisht për gratë dhe vajzat rome. Dokumentet vendore duhet të hartohen dhe zbatohen në bashkëpunim me autoritetet kombëtare, autoritetet lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe me mbështetjen e sektorit privat. Pjesëmarrja e grave rome në proceset e zhvillimit dhe zbatimit të politikave relevante lokale duhet të rritet"⁹⁶.

Në tetë vitet e fundit, Bashkimi Evropian ka zbatuar projekte përmes instrumentit IPA për të siguruar banim për personat e rrezikuar social, duke i përfshirë edhe romët, për të cilët janë siguruar 4,500,000 EUR. Gjegjësisht, këto projekte janë zbatuar në gjashtë komuna, fillimisht në Veles dhe Shuto Orizarë në kuadër të IPA 2 në vitin 2017, ndërsa në kuadër të IPA 19 në komunat e Manastirit, Prilepit, Kërçovës dhe Shtipit.

⁹³ <http://habitat.org.mk/mkd/rhprogram.html>

⁹⁴ [https://mls.gov.mk/images/files/Dogovori%20za%2015%20op\[tini\].doc](https://mls.gov.mk/images/files/Dogovori%20za%2015%20op[tini].doc)

⁹⁵ <https://mtc.gov.mk/media/files/2024/Budzet%20na%20MTV%202024.pdf>

⁹⁶ <https://www.nationalromacentrum.org/mk/wp-content/uploads/dok-pol-domuvanje-3.pdf>

Komunat dhe shoqatat e qytetarëve paraqiten si aplikantë për këto projekte me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së efektit dhe rezultateve, si dhe për të dhënë mbështetje dhe angazhim për zgjidhjen e çështjes së personave të pastrehë. Në kuadër të këtyre projekteve, personat janë mbështetur në proceset e “legalizimit” të objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, rinovimit të objekteve, si dhe ndërtimit të shtëpive, por edhe ndërtimit të infrastrukturës në këto komuna me qëllim sigurimin e kushteve për jetesë normale. Si vazhdim i këtyre projekteve që përfundojnë në tetor 2024, Delegacioni i Bashkimit Evropian do të sigurojë IPA për periudhën 2025 - 2030, mbështetje financiare në shumën prej 5 000 000,00 EUR, me të cilat do të parashikohen zgjidhje afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të banimit për njerëzit e pastrehë në Republikën e Maqedonisë së Veriut⁹⁷.

45) Të merret parasysh mundësia e garantimit të kredive për vendet pjesëmarrëse që do të ishin në dispozicion nga organizatat ndërkombëtare dhe institucionet financiare për projekte banimi me të ardhura të ulëta.

Banimi social i romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut financohet përmes programeve të ndryshme. Programi themelor për banimin social të romëve është përmes Projektit për banimin e grupeve sociale vulnerabël - F/P 1674 (2009), i cili parashikon ndërtimin dhe shpërndarjen e gjithsej 1,754 apartamenteve në 32 ndërtesa banimi në 26 qytete në territorin e Republikës së Maqedonisë (në atë kohë). Në periudhën 2009 - 2013 janë ndërtuar dhe shpërndarë 559 apartamente në 11 ndërtesa banim, në 10 qytete⁹⁸. Programi vjetor për ndërtim, shitje dhe mirëmbajtjen e hapësirës

së banimit në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 thekson se në Programin Ndërtimi i banesave për njerëzit në rrezik social dhe grupet e tjera vulnerabile për periudhën 2009 - 2025, janë ndërtuar 26 ndërtesa banimi me 1,160 apartamente⁹⁹. Megjithatë, Komisioni Evropian vuri në dukje në Raport Progresin për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 se mjetet nga buxheti të parashikuara për banimin e romëve nuk janë shfrytëzuar plotësisht¹⁰⁰.

Si ndihmë e drejtpërdrejtë nga Bashkimi Evropian, në kuadër të Programit të Veprimit IPA 2017 “Mbështetja e BE-së për arsimin, punësimin dhe politikën sociale”, u realizuan dy projekte grantesh për banimin dhe përfshirjen sociale të romëve.

Megjithatë, numri i banesave sociale të ndara për romët është shumë i vogël. Lidhur me përdorimin e masave për mbështetjen e banimit social nga popullsia rome, të dhënat e marra nga Ministria e Transportit për periudhën 2014 - 2016 tregojnë se nga 111 banesa sociale të shpërndara, pesë apartamente janë ndarë për personat me përkatësi etnike rome¹⁰¹. Në lidhje me aksesin në apartamentet sociale, deri në fund të vitit 2016, familjeve rome u janë ndarë gjithsej 118 apartamente. Nga fillimi i vitit 2017 deri në vitin 2021 nuk ka shpërndarje të banesave sociale¹⁰².

⁹⁹ Programi vjetor për ndërtimin, shitjen dhe mirëmbajtjen e hapësirës së banimit në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 29/2024 datë 8.2.2024).

¹⁰⁰ <https://www.sep.gov.mk/data/file/Pregovori/North-Macedonia-Report-2021-%D0%9C%D0%9A2.pdf>

¹⁰¹ https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/Analiza_e_politikës_publike_për_të_drejtat_e_romëve_në_Republikën_e_Maqedonisë.pdf

¹⁰² <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/Strategija%20za%20inkluzija%20na%20Romite%202022-2030%2003-02-2022%20finalna%20verzija.pdf>

⁹⁷ Bisedë me z. Nafi Saraçini, Delegacioni i Bashkimit Evropian, embajtur më datë 18.9.2024.

⁹⁸ https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/08/Romi_Analiza_Helsinki.pdf

46) Të promovohet mundësia e mënyrave bashkëpunuese të banimit për komunitetin rom dhe të ofrohen trajnime adekuate për mirëmbajtjen e objekteve të tilla.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka mënyrë bashkëpunuese të banimit. Pikat e pritjes për të pastrehët janë në veprim në Shkup, Manastir, Strumicë dhe Strugë¹⁰³. Në vitin 2018, u hap qendra e fundit e të pastrehëve në Vizbeg, në Shkup, ku u strehuan 96 persona të pastrehë, shumë prej tyre romë. Këto pika janë në përgjegjësinë e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë. Përveç kësaj, Kryqi i Kuq i Maqedonisë ka hapur një pikë për të pastrehët në Momin Potok, Shkup¹⁰⁴.

Në përputhje me informacionin nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë (në atë kohë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale), përfundimisht me muajin dhjetor 2023, 15 familje mbetën të dislokuara - 88 persona, 29 të rritur dhe 59 fëmijë në kompetencë të MPPS, janë akomoduar në vendbanime të përkohshme në Vizbeg. Puna me këta persona përfshin ekspertë nga QPS, MPPS dhe dy organizata të shoqërisë civile rome. Nga personat përkohësisht të përkujdesur, katër persona janë të punësuar përkohësisht (një person është angazhuar si punëtor ndërtimi, dy persona si sanitarë dhe një person merret me shitblerje të sendeve të vjetra)¹⁰⁵.

¹⁰³ https://www.mtsp.gov.mk/mart-2020-ns_article-mtsp-punktovite-za-bezdomni-lica-funkcioniraat-vo-sorabotka-so-crven-krst-se-delat-zashtitni-maski-i-nspk

¹⁰⁴ <https://www.slobodnaevropa.mk/a/i-cili-kujdeset-per-personat-e-pastrehë-/31589246.html>

¹⁰⁵ [mtsp.gov.mk/content/word/Fword%2F%25D0%25B1%25D0%25B0%25D1%2580%25D0%25B0%25D1%259A%25D0%25D0%25D0%25D0%25DF%25D1%25D1%25D1%25D1%25D1%25D0%25D0%25D0%25D0%25BF%2F2024%2F14-571.docx](https://www.mtsp.gov.mk/content/word/Fword%2F%25D0%25B1%25D0%25B0%25D1%2580%25D0%25B0%25D1%259A%25D0%25D0%25D0%25D0%25DF%25D1%25D1%25D1%25D1%25D1%25D0%25D0%25D0%25D0%25BF%2F2024%2F14-571.docx)

I. Papunësia dhe problemet ekonomike

48) Të promovohet rritja e përfaqësimit të romëve dhe sintive të kualifikuar në institucionet publike

Në regjistrimin e vitit 2021, Republika e Maqedonisë së Veriut kishte 49,104 persona romë, nga të cilët rezident 46,433 ose 2.53% nga numri i përgjithshëm i popullsisë. Në përputhje me regjistrimin e vitit 2021 dhe detyrimet që dalin për Qeverinë nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut për përfaqësimin e drejtë të të gjitha bashkësive etnike në institucionet publike, rezulton se romët në Maqedoninë e Veriut nuk janë të përfaqësuar sa duhet. Gjegjësisht, në përputhje me të dhënat e Avokatit të Popullit dhe Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës, nga viti 2012 deri në vitin 2023 përqindja e romëve të punësuar në administratën publike varionte nga 1.1% në 1.5%¹⁰⁶, që është mesatarisht dy herë më e ulët se përqindja e romëve në popullsinë e përgjithshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me regjistrimin e vitit 2021.

Në përputhje me statistikën e përfaqësimit të drejtë të Avokatit të Popullit, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, numri i romëve të punësuar në administratën publike ishte nga 1,363 persona në vitin 2012 në 1,672 persona në vitin 2015 dhe 1,640 persona në vitin 2016. Gjatë kësaj periudhe janë zgjedhur dhe emëruar mesatarisht tetë persona të përkatësisë rome, ndërsa numri i drejtuesve në institucione varionte nga 20 në vitin 2012, 15 në vitin 2014 deri në 19 në vitin 2016¹⁰⁷.

Me një përfaqësim prej 1.5% të romëve të punësuar në administratën publike, është arritur

¹⁰⁶ https://ombudsman.mk/Faqja_kryesore/Vjetore_raportet.aspx

¹⁰⁷ Ibid.

objektivi i parashikuar me PVK 2016 - 2020 në pjesën e punësimit , pra në vitin 2020, punësimi i romëve në administratën shtetërore ishte 1.4%, ndërsa në njësitë e vetëqeverisjes lokale ishin të punësuar 0.96%¹⁰⁸.

Pavarësisht qëllimit të arritur me Strategjinë për romët 2014 - 2020, me Strategjinë për përfshirjen e romëve 2023 - 2030, si qëllimi kryesor strategjik është parashikuar Objektivi Strategjik 1 : Rritja e punësimit të romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmes së cilës parashikohet si tregues specifik (SP)1: Rritja e punësimit të romëve në administratën publike dhe shtetërore për të cilën parashikohet treguesi i suksesit deri në vitin 2030, të paktën 2.6% të punësuar në administratën shtetërore dhe publike¹⁰⁹.

Sidoqoftë, angazhimi politik për përfaqësim të drejtë të komuniteteve etnike joshumicë në administratën publike nuk është problemi më i madh me të cilin përballlet Republika e Maqedonisë së Veriut, por problemi kryesor është hendeuku i krijuar midis sektorit privat dhe publik në fushën e pagave. Sipas znj. Mabera Kamberi, udhëheqëse e Sektorit të Koordinimit dhe Asistencës Teknike pranë Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, punësimi në sektorin publik është gjithnjë e më pak tërheqës për të rinjtë romë për shkak të pagave të ulëta në pozicionet fillestare kur punësohen në administratën publike. Sipas zonjës Kamberi, kjo nuk ndodh vetëm me romët por i njëjti problem është me të gjithë të rinjtë¹¹⁰.

¹⁰⁸ <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/Strategija%20za%20inkluzija%20na%20Romite%202022-2030%2003-02-2022%20finalna%20verzija.pdf>

¹⁰⁹ <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/Strategija%20za%20inkluzija%20na%20Romite%202022-2030%2003-02-2022%20finalna%20verzija.pdf>

¹¹⁰ Bisedë me znj. Mabera Kamberi, udhëheqëse e Sektorit të Koordinimit dhe Asistencës Teknike pranë Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, mbajtur më datë 24.6.2024.

49) Të zhvillohen programe trajnimi për të përgatitur grupet e nënpërfaqësuarat si romët dhe sintit për punësimin në administratën publike lokale dhe në fusha të tjera, dhe të krijohen politika për të inkurajuar punësimin e personave që i përfundojnë këto programe si nëpunës shtetërorë.

Në periudhën e kaluar, nuk kishte thirrje për organizimin e trajnimeve të specializuara për romët e papunësuar që dëshirojnë të punojnë në administratën publike, përfshirë edhe administratën lokale. Personat e punësuar në administratën publike janë kryesisht persona që kanë marrë arsim formal, arsim të mesëm ose universitar.

50) Të rivlerësohet ndikimi i programeve të punësimit të subvencionuar duke i kushtuar vëmendje të veçantë komponentëve të tyre edukative, për të siguruar që ata synojnë të rrisin konkurrencën e romëve dhe sintive në tregun e punës.

Agjencia e Punësimit si institucioni i vetëm kompetent për monitorimin dhe rregullimin e tregut të punës në periudhën e kaluar krijoi një ofertë cilësore të programeve dhe masave për inkurajimin e punësimit me theks të veçantë mbi ofrimin e informacioneve, mentorimin, grantet për vetëpunësim e tj.

Agjencia krijoi një program për shërbimin e subvencionuar të punësimit Aktivizimi për romët e papunë dhe personat e tjerë në rrezik nga përjashtimi social përmes të cilit u krijua një rrjet mentorësh romë dhe përmes programeve të bazuara në përvojat ndërkombëtare (programi Acceder)¹¹¹. Shërbimi u realizua në kuadër të

¹¹¹ The Acceder travels abroad. New project in North Macedonia - Fundación Secretariado Gitano

projektit të UNDP-së, MPPS-së dhe APRMV-së - Krijimi i mundësive për punë për të gjithë, mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)¹¹².

Në shërbimin Aktivizimi i romëve të papunë dhe personave të tjerë në rrezik përjashtimi social ishin të përfshirë gjithsej 2 008 persona nga të cilët 972 gra (48%) dhe 657 (33%) të rinj deri në moshën 29 vjeç. 2,545 persona, kryesisht romë, u informuan për këtë shërbim, dhe për 2,008 (972 gra dhe 657 të rinj) persona që u përfshinë në shërbim, u plotësuan pyetësorët për të profilizuar dhe vlerësuar kapacitetet profesionale të një personi të papunë për përfshirje në masa aktive. Disa nga pjesëmarrësit - 107 persona u përfshinë në masën aktive për punësim, dhe disa prej tyre, përkatësisht 359 persona ishin të punësuar. Kjo masë është parashikuar për romët e papunë dhe njerëzit në rrezik social.

Në vitin 2023, Agjencia lidhi kontrata me 2 001 persona, nga të cilët 23 kontrata u lidhën me persona me aftësi të kufizuara dhe nëntë persona (dy prej të cilëve janë të rinj deri në moshën 29 vjeç) me mbështetje me grant si punësime shtesë në kompanitë e regjistruara nga personat me aftësi të kufizuara. Nga gjithsej 2003 persona, 46 janë romë¹¹³.

Agjencia e Punësimit zbaton edhe projektin "Aktivizimi i grupeve vulnerable në tregun e punës" në kuadër të Projektit IPA. Nga 124 persona të punësuar me këtë masë, nëpërmjet Projektit IPA dhe në përputhje me Planin Operacional për vitin 2022, nëntë persona janë romë¹¹⁴.

Reduktimi i papunësisë së romëve është në një

trend rënës në pesë vitet e fundit. Gjegjësisht, në vitin 2020, janë paraqitur 14,396 romë të papunë, nga të cilët 7,116 burra dhe 7,280 gra, ndërsa më datë 30.6.2024 kishte gjithsej 10,527 romë të papunë, nga të cilët 5,090 burra dhe 5,437 gra.¹¹⁵

51) Të krijohen politika dhe programe, përfshirë trajnimin profesional, për të përmirësuar aftësitë dhe për të rritur mundësitë e punësimit të romëve dhe sintive, dhe veçanërisht të të rinjve dhe grave.

Në 10 vitet e fundit, Agjencia e Punësimit ka marrë një sërë masash aktive që synojnë rritjen e punësimit të romëve dhe personave në rrezik. Konkretisht, në vitin 2014, Agjencia zbatoi një Pilot Program për punësimin e pjesëtarëve të komunitetit rom që janë punëkërkues aktivë, i cili përfshinte katër pilot-komuna: Shuto Orizarën, Tetovën, Kumanovën dhe Prilepin. Në kuadër të këtij Programi Pilot, u siguruan trajnues dhe mentorë përmes të cilëve 777 persona u informuan për masat aktive të Agjencisë, nga të cilët 302 treguan interes të mëtejshëm, nga të cilat 124 hynë në një aktivitet të caktuar për të përmirësuar pozicionin e tyre shoqëror. Rezultatet e këtij Programi janë se 43 persona përdorën masa aktive, gjashtë u punësuan në sektorin privat, 75 persona ndryshuan statusin e tyre nga pasiv në punëkërkues aktivë në Agjencinë e Punësimit¹¹⁶. Në të njëjtin vit, u krijua edhe një video për motivimin e punësimit të romëve, e cila u transmetua në faqen e internetit të UNDP-së¹¹⁷.

Në vitin 2018, Agjencia siguroi një buxhet të veçantë për aktivizimin e romëve të papunë nga

¹¹² <https://av.gov.mk/godishni-izveshtai.nspix>

¹¹³ Ibid.

¹¹⁴ <https://av.gov.mk/godishni-izveshtai.nspix>

¹¹⁵ <https://av.gov.mk/pregled-na-evidentirani-nevraboteni-lica-spored-nacionalna-pripadnost.nspix>

¹¹⁶ <https://av.gov.mk/content/Raporti%20of%20AWRM%202014.pdf>

¹¹⁷ Ibid.

fondet buxhetore të perealizuara për vitin 2017, në shumë prej 1 575 000,00 denarë¹¹⁸.

Në pesë vitet e fundit, nga viti 2019 deri në vitin 2023, 2,241 romë kanë shfrytëzuar masa aktive për punësim nga programet e Agjencisë së Punësimit¹¹⁹. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, 2022 dhe 2023 vuri në dukje se numri i romëve që përdorin masa aktive të punësimit në vitin 2020 ishte 241 nga gjithsej 6,303, numri i romëve që përdorin masa aktive të punësimit në vitin 2021 ishte 589 ose 5.2% nga të gjithë përfituesit, ndërsa në vitin 2022 në skemën Garancia rinore, e cila është masa kryesore për të trajtuar papunësinë e të rinjve, morën pjesë 969 romë, nga të cilët 148 u punësuan.¹²⁰¹²¹

52) Të miratohen politika sociale që do ta rrisin motivimin për punësim, si një mënyrë e përhershme për të shmangur varësinë nga asistenca sociale.

Duke marrë parasysh statistikat zyrtare të tregut të punës të Agjencisë së Punësimit, është e lehtë të shihet se numri i romëve të papunë është në rënie. Por nga informacionet zyrtare në dispozicion, nuk mund të përfundohet qartë nëse kjo tendencë është rezultat i masave aktive që Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut i zbaton për të ulur papunësinë, përfshirë romët, ose zvogëlimin e njerëzve të papunë për shkak të punëkërkuësve aktivë që migrojnë jashtë vendit për punë. Gjithashtu, gjatë paraqitjes në Agjencinë e Punësimit, përkatësia etnike nuk është një fakt që mund të verifikohet dhe konfirmohet. Ka

¹¹⁸ <https://av.gov.mk/content/Dokumenti/Raporti%20of%20APRMV%202018.pdf>

¹¹⁹ <https://av.gov.mk/pregled-na-evidentirani-nevraboteni-lica-spored-nacionalna-pripadnost.nspk>

¹²⁰ <https://www.sep.gov.mk/data/file/Pregovori/North-Macedonia-Report-2021-%D0%9C%D0%9A2.pdf>

¹²¹ <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657>

shembuj të shumtë të paraqitjes së përkatësisë tjetër etnike për të fituar një vend pune, duke qenë se vendet e punës në administratën publike përcaktohen sipas Balancuesit për Përfaqësim të Drejtë¹²². Me qëllim që të mos abuzohet me përkatësinë etnike, u gjet një zgjidhje qendrat informative rome dhe shoqata të tjera qytetare rome të lëshojnë vërtetime nëse personi është i përkatësisë rome. Kjo zgjidhje përfshihet edhe në procedurën e ndarjes së apartamenteve sociale për kategorinë 5, përkatësisht personat që i përkasin komunitetit rom në rrezik social sipas Strategjisë për romët të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2022 - 2030¹²³. Por në një bisedë me znj. Mabera Kamberi, udhëheqëse e Sektorit të Koordinimit dhe Asistencës Teknike pranë Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, u theksua se ka informacione se ende ka përpjekje për manipulim nga persona që nuk i përkasin komunitetit rom të deklarohen si romë vetëm për të marrë subvencione si të papunë, për të marrë një vend pune ose për të aplikuar për një apartament social, i cili duhet ta merret nga një person me përkatësi etnike rome¹²⁴.

I. Mbrojtja shëndetësore

58) Të sigurohet që romët dhe sintit të kenë qasje në shërbimet shëndetësore pa diskriminim.

Republika e Maqedonisë së Veriut në përputhje

¹²² <https://www.fakulteti.mk/news/14022020/makedonci-stanuvale-albanci-i-turci-za-da-dobijat-rabota-vo-muzejot-vo-struga>

¹²³ <https://mtc.gov.mk/vesti/Oglas-za-raspredelba-na-sotsijalni-stanovi---Negotino>

¹²⁴ Bisedë me znj. Mabera Kamberi, udhëheqëse e Sektorit të Koordinimit dhe Asistencës Teknike pranë Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, mbajtur më datë 24.6.2024.

me Ligjin për mbrojtje shëndetësore ofron mbrojtje shëndetësor në përputhje me parimin e disponueshmërisë: “Parimi i disponueshmërisë së mbrojtjes shëndetësore arrihet duke siguruar mbrojtje adekuat shëndetësor për popullatën në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila është gjeografikisht, fizikisht dhe ekonomikisht e arritshme, dhe veçanërisht mbrojtja shëndetësore në nivelin primar.”

Megjithatë, ekziston një kufizim i caktuar për personat që nuk kanë dokumente personale, të cilët janë të regjistruar në librin amë të të lindurve. Procesi i lëshimit të dokumenteve personale po ecën shumë ngadalë për shkak të zbatimit joadekuat të ndryshimeve në Ligjin për Evidencën amë dhe Ligjin për paraqitjen e vendbanimit dhe vendqëndrimin të qytetarëve nga policia në pjesën e kontrollit të vendbanimit të personit që ka aplikuar për lëshimin e letërnjoftimit¹²⁵.

Problemi i mbrojtjes shëndetësore primare akoma është një sfidë e madhe e vënë re nga shoqatat e qytetarëve që punojnë në fushën e shëndetit publik. Në vitin 2022, Asociacioni ESE zbatoi një anketë për të vlerësuar nevojat e komuniteteve rurale dhe rome në qasjen në shërbimet e mbrojtjes shëndetësore primare, i cili përfshiu 941 të anketuar, 503 gra dhe 438 të anketuar burra në komunitetet rome në komunat si vijojnë: Shuto Orizarë, Kumanovë, Delçevë dhe Vinicë¹²⁶. Në përputhje me këtë anketë, shumica e romëve kanë sigurim shëndetësor dhe kanë zgjedhur një mjek të përgjithshëm/familjar, por kjo nuk do të thotë se ata marrin mbrojtjen shëndetësore primare. Gjegjësisht, 43% e romëve që kanë nevojë për

mbrojtje shëndetësore nuk shkojnë te mjeku i përgjithshëm/familjar, ndërsa kjo përqindje në Komunën e Vinicës zbulon se 96% e romëve kanë nevojë të përcaktuara të mbrojtjes shëndetësore tek mjeku i përgjithshëm/familjar. Situata me mbrojtjen shëndetësore stomatologjike është edhe më e keqe, ku vetëm 68% e romëve kanë zgjedhur një dentist të përgjithshëm, nga të cilët 55% e romëve nuk e kanë realizuar nevojën për shërbime stomatologjike. E njëjta shoqatë vuri në dukje se “Banorët e zonave rurale përballen me pengesa të konsiderueshme financiare gjatë qasjes në shërbimet shëndetësore, me një përqindje të konsiderueshme të romëve të cilët nuk mund të përballonin shërbimet dentare, ilaçet, testet laboratorike dhe incizimet e rëntgenit, duke i mbuluar edhe shpenzimet e udhëtimit dhe duke humbur ditë të punës. Për më tepër, grupet e fokusit në Rajonin e Pellagonisë kanë dëshmuar për trajtim diskriminues në institucionet shëndetësore dhe në institucione tjera”¹²⁷.

Mbrojtja shëndetësore e grave rome, përkatësisht zgjedhja e një gjinekologu, bëhet pjesërisht, ku vetëm 57.5% e grave rome kanë zgjedhur një gjinekolog. Kjo përqindje ndryshon nga komuna në komunë. ME fjalë të tjera, gratë rome nga Vinica dhe Dellçeva kryesisht kanë zgjedhur një gjinekolog (83% në të dy komunat), ndërsa më e ulëta është përqindja e grave që kanë zgjedhur një gjinekolog në Shuto Orizarë (47.1%)¹²⁸.

Ministria e Shëndetësisë po ndërmerr hapa për të siguruar gjinekologët në komunat me lagje rome duke bashkëfinancuar specializimin e mjekëve. Pas një kohe të gjatë, Komuna e Shuto Orizarës ka një gjinekolog që ofron shërbime gjinekologjike për gratë rome nga Shuto Orizara, si pjesë e programit për bashkëfinancimin e studimeve të

¹²⁵ Bisedë me z-nj Sonja Mirakovska, deputete në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, zhvilluar më datë 2.10.2024.

¹²⁶ https://esem.org.mk/wp-content/uploads/2024/05/Finalna-analiza_Romi_PZZ1.pdf

¹²⁷ Ibid.

¹²⁸ Ibid.

specializuara në gjinekologji¹²⁹. Aktualisht, ekziston një institucion shëndetësor privat - ordinancë gjinekologjike, e cila, përballet me një problem që lidhet me numrin e pacientëve nga të cilët varet kapitacioni i ordinancës dhe mbijetesat e saj në Shuto Orizarë¹³⁰.

Qendra Rinore “Dua të Di” e HERA, e vendosur në klinikën në Shuto Orizarë, ofron shërbime shëndetësore falas dhe konfidenciale. Qendra ofron kujdes dhe konsultime gjinekologjike, duke përfshirë diagnostikimin dhe trajtimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme. Qendra ofron edhe mundësi për kontracepcion. Përveç kësaj, ofrohet këshillim për planifikimin familjar, parandalimin e shtatzënisë së padëshiruar, testimin e shtatzënisë dhe ekzaminimet me ultratinguj¹³¹.

59) Të promovohet ndërgjegjësimi midis punonjësve shëndetësorë për nevojat specifike të romëve dhe sintive.

Në kuadër të veprimit të shoqatave të qytetarëve që punojnë në fushën e shëndetit publik, po kryhet vazhdimisht sensibilizimi i punonjësve shëndetësorë për nevojat specifike të romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në kuadër të projektit “Ndryshimi i narrativëve negative për romët në institucionet shëndetësore”, i financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni, Shoqata HERA në vitin 2018 hartoi një manual për trajnimin e profesionistëve shëndetësorë me titull “Zhvillimi i aftësive të komunikimit për ofrimin e shërbimeve shëndetësore me cilësi

më të mirë në komunitetet romë”. Ky manual përmban tre module: Moduli 1 - Karakteristikat kulturore të popullsisë romë në Maqedoni (në atë kohë); Moduli 2: Aftësia e komunikimit me romët, themeli i kujdesit shëndetësor; dhe Moduli 3: Kompetencat kulturore të profesionistëve dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë. Ky manual u hartua në kuadër të Qendrës për Mjekësi Familjare në Fakultetin e Mjekësisë - Shkup, duke përfshirë dr. Arif Pini, punonjës shëndetësor nga komuniteti rom i ngarkuar me kontrollimin e materialeve në lidhje me sensitivitetin e teksteve¹³².

Qëllimi i këtij manuali është pikërisht njohja e punonjësve shëndetësorë me karakteristikat kulturore të popullsisë romë në Republikën e Maqedonisë së Veriut me qëllim përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit midis punonjësve shëndetësorë dhe romëve si përfitues të shërbimeve shëndetësore.

Gjithashtu, Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni në vitin 2019 mbështeti disa projekte në partneritet me SHIKO KËSHITU¹³³ që synonin të ndihmojnë në ndryshimin e narrativëve ndaj romëve. Qëllimi i këtyre projekteve është në një mënyrë inovative të sigurohet dukshmëria e problemeve të komunitetit rom, por edhe përpjekjet e bëra prej tyre dhe organizatave të shoqërisë civile për t'i dhënë një zgjidhje problemeve, veçanërisht në institucionet shëndetësore¹³⁴.

Qendra Kombëtare e Romëve nga Kumanova, në periudhën nëntor 2018 deri në nëntor 2019, në partneritet me Symbiosis 12, e promovoi Almanakun me rekomandimet dhe rezultatet e projektit “Ndryshimi i narrativëve për romët në institucionet shëndetësore”, “Shëndeti im është

¹²⁹ Bisedë me Sanja Sazdovska, Ministria e Shëndetësisë - datë 27.7.2024.

¹³⁰ https://www.slobodnaevropa.mk/a/shuto-orizari-dobi-ginekolog-no-snemuva-pacientki-/32970453.html?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTAAR2QGgK7WE3iRcF4tRz2X4T-g1-GdqdeZ1T0-BahEnBTszyMRssF1avj3XQ_aem_YosiWRelKhRsS2HWoYKR1w

¹³¹ HERA - Asociacioni për edukim dhe hulumtim shëndetësor - shërbime - Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi (mzd.mk)

¹³² <https://hera.org.mk/wp-content/uploads/2018/04/Priracnik-za-zdravstveni-rabotnici-web.pdf>

¹³³ Shiko Kështu - Histori me vlerë.

¹³⁴ <https://fosm.mk/current-project/grafichka-vest-zdravstveni-rabotnitsi-koi-gi-menuvaat-predrasudite-kon-romite/>

e drejta ime”¹³⁵. Në kuadër të këtij projekti, u promovuan rekomandimet për punën me të rinjtë për të zvogëluar stereotipat, paragjykimet dhe diskriminimin ndaj komunitetit rom në institucionet shëndetësore. Këto korniza rekomandimesh i përkushtojnë vëmendje të veçantë trajnimit të të rinjve për aktivizmin qytetar, pjesëmarrjen në punëtori dhe punëtori krijuese mbi historinë, traditën dhe kulturën e romëve, por edhe përfshirjen e nxënësve në shkollat e mesme mjekësore dhe punonjësve shëndetësorë në këto aktivitete¹³⁶.

60) Adresimi i incidencës së lartë të sëmundjeve dhe kequshqyerjes në komunitetin rom

Në komunitetin rom, ende janë të pranishme sëmundjet e shpeshta për shkak të mungesës së mbrojtjes adekuate shëndetësore. Siç theksuam në pikën 58, përqindja e personave që kanë zgjedhur një mjek të përgjithshëm është shumë e ulët në komuna të caktuara ku jetojnë romët, ndërsa më e ulët është në komunën më të madhe rome, në Shuto Orizarë, (43%). Prandaj, ekziston rreziku i sëmundjeve të shpeshta për shkak të mos trajtimit ose trajtimit joadekuat mjekësor të gjendjes shëndetësore.

Në fushën e kequshqyerjes, Studimi i parë për varfërinë shumëdimensionale të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut¹³⁷, i përgatitur në vitin 2021 nga Finance Think - Instituti për Kërkime Ekonomike dhe Politika, Shkup me mbështetjen e UNICEF-it, thekson se “... skema

të ngjashme po zhvillohen në indikatorin e fundit, i cili thekson kequshqyerjen si një dështim antropometrik nën dy devijime standarde nga popullata referente. 10.64 për qind e fëmijëve nën moshën 5 vjeç janë nën peshë, me një rritje të pamjaftueshme ose të rraskapitur. Përqindja rritet në 16.83 te fëmijët romë.”

61) Të stimulohet qasja e romëve dhe sintive në shërbimet e shëndetit publik, në fazë të hershme, përmes:

(a) Informimit të romëve dhe sintive për ekzistencën dhe disponueshmërinë e këtyre shërbimeve dhe udhëzimi i tyre se si t’i përdorin ato;

Në sistemin shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes Dekadës së Romëve, Ministrisë së Shëndetësisë, në bashkëpunim me sektorin civil, filloi zbatim i Projektit “Ndërmjetësit shëndetësorë romë”. Ky aktivitet, përkatësisht, ndërmjetësuesit shëndetësorë janë ende në funksion dhe punojnë në shtëpitë e shëndetit në tetë komuna. Numri i tyre në vitin 2011 ishte 15, ndërsa në vitin 2024 është 17¹³⁸. Ndërmjetësit shëndetësorë romë ofronin një mënyrë të drejtpërdrejtë për të informuar popullsinë rome për mundësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve shëndetësore. Sipas raportit të përpiluar nga Instituti i Shëndetit Publik në vitin 2015, ndërmjetësit shëndetësorë romë ofruan mbi 20,000 shërbime vetëm brenda një viti. Megjithatë shumica, rreth 18,300, kanë të bëjnë me shëndetin, ndërmjetësit shëndetësorë romë kanë ndihmuar njerëzit të marrin dokumente personale si certifikata dhe letërnjoftime, dhe u

¹³⁵ Almanak me rekomandime dhe rezultate nga projekti “Ndryshimi i narrativave për romët në institucionet shëndetësore” “Shëndeti im është e drejta ime” - Qendra Kombëtare Rome (nationalromacentrum.org)

¹³⁶ Ibid.

¹³⁷ <https://www.financethink.mk/wp-content/uploads/2021/12/Multidimensional-child-poverty-MK.pdf>

¹³⁸ Të dhëna nga Ministria e Shëndetësisë të marra më datë 29.7.2024

kanë mundësuar familjeve qasje në asistencën monetare sociale ¹³⁹.

Sipas ndërmjetësve, ata janë të përfshirë në mënyrë aktive dhe bëjnë vizita shoqëruese në institucione të ndryshme dhe bashkëpunojnë mirë me komunat dhe tregojnë shumë shembuj ku komunat reagojnë me përgjegjësi dhe i ndihmuan kur kishte mundësi për ta bërë këtë. Veç tjerash, ndërmjetësit shëndetësorë konsiderojnë se ata mbulojnë në mënyrë adekuate institucionet shëndetësore dhe çështjet shëndetësore, ekonomike, sociale dhe arsimore të romëve. Ndërmjetësit thonë se punojnë me *“kartelat e tyre (shëndetësore) për fëmijë, gratë shtatzëna, pjellorinë femërore, etj.”*, kështu që ata mbajnë statistika për numrin e njerëzve që i mbështesin në komunë ¹⁴⁰.

Për momentin, ekziston një sistem tashmë i zhvilluar për informimin e romëve si përmes ndërmjetësve romë të shëndetësisë ashtu edhe përmes shoqatave të qytetarëve si HERA, Shoqatës Iniciativa për të Drejtat e Grave nga Shuto Orizara etj.

Në vitin 2019, Qendra Kombëtare e Romëve zbatoi Projektin “Ndryshimi i narrativëve për romët në institucionet shëndetësore” “Shëndeti im, e drejta ime”, mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni. Në kuadër të projektit, u krijuan tre video edukative për të

drejtën e shëndetësor dhe rëndësinë e shëndetit seksual dhe riprodhues tek adoleshentët ¹⁴¹.

(b) Forcimit të besimit të romëve dhe sintive të punonjësit të shëndetit publik, duke përfshirë: ndëshkimin e rasteve të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të pësuar nga romët dhe sintit; trajnimin e punonjësve shëndetësorë për aspektet përkatëse të kulturës rome; dhe mbështetjen e ndërmjetësve që do të luanin një rol të rëndësishëm në tejkalimin e hendekut midis komuniteteve rome dhe institucioneve shëndetësore publike.

Ndërmjetësit shëndetësorë romë janë baza për vendosjen e komunikimit dhe fitimin e besimit më të madh midis komunitetit rom dhe profesionistëve shëndetësorë. Por përveç ndërmjetësve, ekziston një numër shumë i vogël i fushatave për të rritur njohuritë për kulturën dhe zakonet rome në mënyrë që të kapërcehen të gjitha pengesat ekzistuese duke ndjekur shembullin e Manualit për trajnimin e punonjësve shëndetësorë – Zhvillimi i aftësive të komunikimit për ofrimin e shërbimeve shëndetësore me cilësi më të mirë në komunitetin rom nga pika 59 e këtij raporti.

Ekzistimi i diskriminimit të drejtpërdrejtë u vërejt në vitin 2020 nga Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), ku Komiteti Maqedonas i Helsinkit inicioi procedurë për shkeljen e të drejtës për qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore dhe diskriminimin e dy grave rome në Shuto Orizarë. Komiteti konstatoi shkelje të të drejtës për trajtim të barabartë dhe diskriminim sepse shteti nuk ka mundësuar këto gra të marrin shërbime gjinekologjike si të gjitha

¹³⁹ <https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%BA%D0%B0%D0%B7%D0%BD%D0%B8/%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%B1%D0%BB%D0%B8%D0%B6%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%BD%D0%B0-%D0%B7%D0%B4%D1%80%D0%B0%D0%B2%D1%81%D1%82%D0%B2%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D1%83%D1%81%D0%BB%D1%83%D0%B3%D0%B8-%D0%B4%D0%BE-%D1%80%D0%BE%D0%BC%D1%87%D0%B8%D1%9A%D0%B0%D1%82%D0%B0>

¹⁴⁰ https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3801/file/MK_RomaAccessToHealthPolicyBrief_Report_MK.pdf

¹⁴¹ Video e shkurtër edukative - “Cakto ekzaminimin tënd të parë” Qendra Kombëtare Rome (nationalromacentrum.org)

gratë e tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut¹⁴².

Ministria e Shëndetësisë si bartëse dhe koordinatore e aktiviteteve që lidhen me rritjen e ndërgjegjësimin të publikut në mesin e popullatës rome për shërbimet shëndetësore të ofruara në shtëpitë shëndetësore kanë zënë të veçantë buxhetor për këto aktivitete si mjete të parashikuara për zbatimin e Strategjisë për përfshirjen e romëve 2022 - 2030. Shuma e buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2021, 2022 dhe 2023 është 4 100 000 denarë për çdo vit buxhetor, ndërsa për vitin 2024 është 6 000 000 denarë, të cilat me rebalancin janë reduktuar në 5 000 000 denarë¹⁴³.

Në periudhën 2019 - 2023, sipas Entit Shtetëror të Statistikave¹⁴⁴, në Fakultetin e Mjekësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut diplomuan 16 mjekë romë dhe dy persona janë diplomuar në Shkollën e Lartë Mjekësore të Universitetit Shtetëror "Shën Klimenti i Ohrit. Duke rritur numrin e stafit të arsimuar mjekësor rom, besimi në sistemin shëndetësor do të rritet dhe, mbi të gjitha, barrierat midis punonjësve shëndetësorë dhe popullsisë rome do të tejkalohen.

Ndërmjetësit shëndetësorë kanë një rol të veçantë në rritjen e besimit të komunitetit rom ndaj sistemit shëndetësor duke filluar nga kompetenca e tyre thelbësore, përkatësisht për të ndihmuar në lehtësimin e qasjes në shërbimet shëndetësore, për të krijuar besim në marrëdhëniet ndërmjet mjekut dhe pacientit, si dhe për të krijuar shprehi

dhe praktika të mira në lidhje me shëndetin, higjienën dhe ushqimin në komunitetet rome¹⁴⁵.

62) Të përkushtohet vëmendje e veçantë ndaj shëndetit të grave dhe vajzave, ndër të tjera, përmes:

a) Promovimit dhe/ose zhvillimit të programeve që do të ofrojnë informacione mbi mbrojtjen shëndetësor (përfshirë ushqimin, kujdesin pas lindjes dhe dhunën në familje);

Në fushën e edukimit të fëmijëve romë që ndjekin shkollën fillore, në vitin 2018 u zbatua një projekt nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të përmirësuar ushqimin e fëmijëve në institucionet parashkollore dhe shkollat fillore, i cili u zbatua në bashkëpunim dhe me mbështetjen e UNICEF-it¹⁴⁶. Në vitin 2023, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, zbatoi Programin e nxitjes së konsumit të frutave të freskëta për vitin 2023, përmes të cilit çdo fëmijë nga institucionet parashkollore gjatë pesë muajve do të merrte një kilogram fruta në javë¹⁴⁷. Megjithatë, këto programe dhe projekte kanë një fushëveprim të kufizuar, domethënë ato janë të destinuara për prindërit dhe fëmijët e moshës parashkollore dhe shkollare që janë pjesë e sistemit arsimor. Kështu, fëmijët që janë jashtë institucioneve arsimore, shumica e të cilëve janë romë, mbeten jashtë këtyre aktiviteteve dhe nuk kanë përfitimet prej tyre.

¹⁴² <https://mhc.org.mk/media/oon-utvrdis-diskriminaciz%D1%98a-od-strana-na-ginekolog-za-zheni-romki-vo-rsm-i-pobara-drzhavata-da-gi-obesshteti/>

¹⁴³ Të dhëna nga Ministria e Shëndetësisë të marra më datë 29.7.2024

¹⁴⁴ https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__ObrazovanieNauka__VisokoObrazovanie__DipolmiraniStudenti/185_VsObr_RM_T1_ml.px/table/tableViewLayout2/

¹⁴⁵ https://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/priracnici/Report_Macedonia_MKD_FINAL.pdf

¹⁴⁶ <https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/njoftime/me-ushqyerjen-me-te-mire-te-femijëve-ne-kopshte-dhe-shkolla-deri-ne-rritjen-e-femijëve-te-vegjël-dhe>

¹⁴⁷ https://www.mtsp.gov.mk/maj-2023-ns_article-trencevska-preku-kampanjata-zdrav-obrok-za-sekoe-dete-do-zdravi-naviki-na-decata-za-konsumiranje-na-nsp

Në pjesën e masave parandaluese, nuk ka asnjë mënyrë të qëndrueshme për ndërgjegjësimin e publikut midis romëve për kujdesin pas lindjes, si dhe ushqimin, sepse “Ndërgjegjësimi dhe njohuritë me shërbimet e patronazhit janë në një nivel më të ulët te pjesëtarët e grupeve më vulnerabile (prindërit në moshë të re, pjesëtarët e komunitetit rom, njerëzit me statusin më të ulët socio-ekonomik dhe banorët e zonave rurale).” Kjo është një nga gjetjet kryesore të sondazhit “Të kuptuarit e barrierave për rritjen e kërkesës dhe cilësisë së shërbimit të patronazhit” nga vitit 2023¹⁴⁸. Së këtijmi, është e nevojshme të bëhet një angazhim më i madh për të rritur ndërgjegjësimin e publikut te popullata rome për domosdoshmërinë e ushqyerjes së shëndetshme dhe kujdesit pas lindjes. Si ndërmjetësit shëndetësorë romë ashtu edhe punonjësit shëndetësorë që punojnë në komunitetet rome duhet të përfshihen në mënyrë aktive në këtë proces.

Në pjesën e parandalimit të dhunës në familje, ekziston një numër i madh fushatash që nuk janë të fokusuara vetëm te gratë rome, por kanë një shtrirje mbi gjithë popullsinë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e angazhuar në mënyrë aktive në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje përmes angazhimit të saj strategjik të sanksionuar në dokumente, aktivitete dhe masa strategjike. Megjithatë, dhuna në familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut akoma është e pranishme. Konkretisht, në një hulumtim të realizuar në kuadër të projektit “Inkurajohu dhe mos hesht për dhunën në familje” të Shoqatës së Romëve “Çerenja” nga Shtipi (mbështetur financiarisht nga Civica Mobilitas, në të cilin morën pjesë 149 gra nga popullsia rome të moshës 14 vjeç

e lart), kur u pyetën a e dinë se çfarë është dhuna në familje, 61% u përgjigjën se e dinë, ndërsa 39% dhanë një përgjigje negative. Në pyetjen a janë ndjerë ndonjëherë si viktime të dhunës në familje, 76% u përgjigjën pozitivisht, ndërsa 24% u përgjigjën negativisht¹⁴⁹. Ky hulumtim tregon qartë për edukimin e pamjaftueshëm të grave rome për dhunën në familje, por edhe për përqindjen e lartë të grave që kanë qenë viktime të dhunës në familje në komunitetin rom. Së këtijmi, është e qartë se duhet një angazhim serioz për krijimin e mekanizmave për rritjen e ndërgjegjësimin publik në komunitetin rom për dhunën në familje.

(b) Përmirësimit të qasjes në shërbimet gjinekologjike, duke përfshirë shërbimet shëndetësore të paralindjes, lindjes dhe pas lindjes, ndër të tjera, duke siguruar informacione dhe trajnime.

Përveç hapjes së një institucioni shëndetësor privat për shërbimet shëndetësore gjinekologjike në Shuto Orizarë, ku për vite me radhë nuk kishte një institucion të tillë shëndetësor, HERA ofron këshilla dhe shërbime shëndetësore përmes një programi pilot në vitin 2022. 24 mjekë të familjes të përfshirë në këtë projekt ofruan shërbime në lidhje me parandalimin e kancerit të gjirit, kancerit të prostatës dhe këshillimin e menopauzës. Pothuajse të gjithë mjekët që deklaruan se vjet ofruan një shërbim në lidhje me ekzaminimin vaginal, përfshirë marrjen e kampionit vaginal dhe një Pap testi, janë nga qytetet ku, në kuadër të projektit, u pajisën ordianca gjinekologjike në kuadër të shtëpive shëndetësore të atjeshme - Makedonski Brod, Radovish dhe Dellçevë. Gjatë pilotimit, gjithsej 24 gra me aftësi të kufizuara, 157 gra rome, 293 gra rurale dhe 535 burra morën mbi 2,000 shërbime kontraceptive nga mjekët e familjes - përkatësisht, këshillim për metodat

Ekzistimi i paragjytimeve dhe stereotipave ndaj romëve është akoma i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e dukshme nga aktiviteti dhe opinionet e miratuara nga Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe nga vendimet gjyqësore të gjykatave kombëtare dhe ndërkombëtare (specifikuar në pikën 67 të këtij raporti).

77) Të krijohen politika që i adresojnë të gjithë faktorët që kontribuojnë në shkallën e ulët të shkollimit të rregullt të fëmijëve romë dhe sinti. Kjo, ndër të tjera, përfshin masa për të siguruar që familjet romë dhe sinti të posedojnë dokumentet e nevojshme për regjistrim si të gjithë qytetarët e tjerë.

Në dekadën e kaluar, Republika e Maqedonisë së Veriut ka marrë një sërë masash përmes të cilave bëhet një përpjekje për të rritur numrin e fëmijëve romë në sistemin arsimor. Këto masa janë kryesisht pjesë e qasjes sistematike të institucioneve përmes së cilave zhvillohet politika e gjithëpërfshirjes dhe integritetit të fëmijëve romë në arsimin fillor dhe të mesëm. Numri i fëmijëve romë të regjistruar në arsimin fillor dhe të mesëm është rritur në mënyrë drastike për shkak të rezultatit të shtojcës për arsimin, sigurimit të bursave dhe kujdestarisë për nxënësit romë në shkollat e mesme, si dhe numrit në rritje të ndërmjetësve arsimorë që kanë një rol aktiv në komunitetin rom.

Megjithatë, në vitin 2019/2020, në arsimin fillor janë regjistruar 9,554 nxënës romë, nga të cilët 521e kanë braktisur arsimin, nga të cilët 30.9% janë kthyer përsëri në procesin arsimor, ndërsa vitin shkollor e përfunduan 9,194 ose 95.23%. Në vitin 2020/2021 janë regjistruar 10,048 nxënës, ndërsa vitin shkollor e përfunduan 9,680%, ndërsa në vitin 2021/2022 janë regjistruar 10,155 nxënës, ndërsa vitin shkollor e përfunduan 9,546 ose 94.99%. Shkalla më e lartë e nxënësve që e

kanë përfunduar vitin shkollor është 2022/2023 kur përfunduan 10,787 nxënës ose 97.57%. Në vitin shkollor 2022/2023, zvogëlimi i numrit të nxënësve në numra ishte 530 përkatësisht 4.8%, nga të cilët 262 ose 49.43% u kthyen në procesin arsimor¹⁹⁵.

Në pjesën e arsimit të mesëm, po ashtu ka tendencë për të rritur shkallën e nxënësve të regjistruar dhe nxënësve që përfundojnë vitin shkollor. Kjo shkallë varion nga 92.36% në vitin shkollor 2019/2020, 95.93% në vitin shkollor 2020/2021, një rënie të vogël të shkallës në vitin shkollor 2021/2022, ndërsa në vitin 2022/2023 shkalla ishte 94.91% kur edhe zvogëlimi i numrit të nxënësve është më i ulët, përkatësisht 5%¹⁹⁶.

Në pjesën e sigurimit të dokumenteve të nevojshme për personat që nuk janë të regjistruar në librin e amë, në shkurt 2020, u miratua Ligji për Personat e Paregjistruar në Librin Amë të të Lindurve¹⁹⁷. Përmes këtij Ligji, deri në vitin 2024, u regjistruan 786¹⁹⁸ nga gjithsej personat e paregjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjë që u mundësoi personave të regjistruar të marrin një certifikatë nga libri i veçantë i të lindurve dhe një dokument identifikimi me qëllim të realizimit të së drejtës për arsim, ndër të drejtat e tjera të parashikuara nga ky regjistrim në librin e veçantë amë të të lindurve.

Në vitin 2021, u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shtetësi të Republikës

¹⁹⁵ Bisedë me Arabela Iljaz, bashkëpunëtore e lartë për arsimin fillor, Merita Mustafi dhe Suzana Shabanovska, koordinatorë e programit të ndërmjetësve arsimorë romë, zhvilluar më datë 26.08.2024.

¹⁹⁶ Ibid.

¹⁹⁷ Ligji për Personat e Paregjistruar në Librin Amë të të Lindurve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/2020).

¹⁹⁸ Bisedë me Vildan Drpljanin, UNHCR, e mbajtur më datë 23.7.2024.

së Maqedonisë (në atë kohë), i cili mundësoi një procedurë më të lehtë për marrjen e shtetësisë për personat që ishin shtetas të një republike tjetër të ish-RSFJ-së, ndërkaq deri më 8 shtator 1991, përkatësisht deri në shpalljen e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë, jetonin në territorin e shtetit. Kjo mundësi është në dispozicion në afat prej tre viteve nga miratimi i ndryshimeve, përkatësisht deri në gusht të vitit 2024.

Deri më 10 korrik të vitit 2024, 103 persona e shfrytëzuan këtë të drejtë, nga të cilët 81 persona morën shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa 22 persona janë në procedurë e sipër.

Problemi më i madh gjatë zbatimit të procedurës është mosbashkëpunimi i aplikantëve për shtetësi, të cilët shpesh nuk paraqiten ose nuk komunikojnë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjë që e vështirëson përsheptimin e procedurës dhe sigurimin e provave të nevojshme¹⁹⁹.

78) Të merret në konsideratë hartimi i programeve për ndihmë sociale për familjet rome me të ardhura të ulëta me fëmijë të moshës shkollore.

Në pjesën e ndihmës sociale për familjet me të ardhura të ulëta me fëmijë të moshës shkollore, Republika e Maqedonisë së Veriut ofron ndihmë të veçantë e parashikuar me Ligin për fëmijët²⁰⁰. Në këtë Ligj, me ndryshimet e vitit 2019²⁰¹ parashikohet ndihmë e veçantë - shtesë arsimore

për familjen me një ose me më shumë fëmijë në arsimin e rregullt fillor ose të mesëm në shkollat në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kjo ndihmë është e kushtëzuar financiarisht, përkatësisht familja të ketë të ardhura mesatare mujore totale të realizuara në tre muajt e fundit para paraqitjes së kërkesës dhe gjatë përdorimit të së drejtës për të gjitha bazat e të gjithë anëtarëve të familjes deri në pragun për qasje në shtesën për arsim, i cili është përcaktuar në 6,800 denarë (110 EUR) maksimumi i rritur deri në 31,930 denarë (519 EUR) për një familje me tetë anëtarë. Shuma e shtesës arsimore është 700 denarë (11.5 euro) në muaj për një nxënës në arsimin fillor dhe 1,000 denarë (16.2 euro) në muaj për një nxënës në arsimin e mesëm gjatë vitit shkollor. Është interesante se ky kompensim u takon për 12 muaj në vit, përkatësisht shuma vjetore e shtesës arsimore për arsimin fillor në vitin shkollor për një fëmijë është 8,400 denarë, kurse për arsimin e mesëm në vitin shkollor për një fëmijë është 12,000 denarë. Pagesa e shtesës arsimore do të bëhet në katër shuma të barabarta prej 2.100 denarësh për përfituesin e të drejtës së shtesës arsimore për një fëmijë në arsimin fillor, ndërsa prej 3.000 denarësh për përfituesin e së drejtës së shtesës arsimore për një fëmijë në arsimin e mesëm, pas përfundimit të secilës prej periudhave të matjes të përcaktuara me këtë ligj.

Kushti themelor për këtë ndihmë është që nxënësi të ndjekë të paktën 85% nga numri i përgjithshëm i orëve të realizuara mësimore, për çka mbahet evidencë e veçantë.

Përveç shtesës arsimore, akoma ekziston ndihma e parashikuar përmes ofrimit të teksteve shkollore falas dhe transportit falas, si dhe përmes bursave për nxënësit romë të listuar në pikën 81 të këtij raporti.

¹⁹⁹ Bisedë me Vangja Zikova, Ministria e Punëve të Brendshme, e mbajtur më datë 11.7.2024.

²⁰⁰ Ligji për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 104/19, 146/19, 275/19, 311/20, 294/21, 150/22 dhe 236/22).

²⁰¹ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr 104/19).

79) Të inkurajohet ndjekja e rregullt e procesit mësimor nga fëmijët romë dhe sinti, ndër të tjera, duke përfshirë edhe familjet dhe punëtorët socialë, duke rritur ndërgjegjësimin e prindërve dhe të rriturve romë dhe sinti në lidhje me detyrimin e tyre t' u mundësojnë fëmijëve të shkojnë në shkollë dhe, veçanërisht, t' u sigurojnë vajzave qasje të barabartë në arsim.

Sipas të dhënave nga Enti Shtetëror i Statistikave, pjesëmarrja e romëve në arsimin parashkollor është 2.54%, ndërsa zvogëlimi i numrit të nxënësve në arsimin fillor është 6%, ndërsa në atë të mesëm 4%.²⁰²

Kjo normë është mjaft e reduktuar nga dekada e mëparshme në të cilën shkalla e zvogëlimit të numrit të nxënësve romë në arsimin fillor ishte mesatarisht 8%, që do të thotë se zvogëlimi i numrit të nxënësve romë në arsimin fillor është 25%.

Në arsimin e mesëm, shkalla mesatare e zvogëlimit të nxënësve romë në të kaluarën ishte 16%, por nga viti 2016, kur për herë të parë u inkorporuan bursat për nxënësit romë, shkalla e zvogëlimit ka mbetur një shifre, kështu që në vitin shkollor 2020/2021 arriti në 4.06%.²⁰³

Një tendencë negative është vërejtur në vitin shkollor 2021/2022 kur shkalla e zvogëlimit

të nxënësve romë në arsimin e mesëm ishte dyshifrore, përkatësisht 10.91%, e cila gjithsesi se është një tendencë më pozitive sesa në vitin 2016 kur shkalla mesatare e zvogëlimit të numrit të nxënësve ishte 16%.

Për ta çrrënjësuar zvogëlimin e numrit të nxënësve romë në sistemin arsimor, një nga masat kryesore në Strategjinë për përfshirjen e romëve 2022 - 2030 në segmentin e arsimit është ulja e shkallës së zvogëlimit të numrit të nxënësve deri në vitin 2030. Qëllimi është të rritet pjesëmarrja e romëve në arsimin parashkollor në 8%, ndërsa zvogëlimi i numrit të nxënësve në arsimin fillor të jetë në domenin e 2%, dhe 1% në arsimin e mesëm.²⁰⁴

Në pjesën e sigurimit të qasjes së barabartë në arsim për fëmijët femra romë, ekziston një tendencë e rritjes së vazhdueshme të fëmijëve femra romë në krahasim me fëmijët meshkuj romë.

80) Të përkushtohet vëmendje e veçantë vajzave romë dhe sinti për t' u siguruar mundësi të barabarta për përfshirjen në arsim dhe shoqëri dhe për të ndërtuar programe për të zvogëluar shkallën jashtëzakonisht të lartë të ndërprerjes së arsimit të vajzave.

Në kuadër të procesit arsimor, pjesëmarrja e nxënësve romë në arsimin fillor përfaqësohet në mënyrë të barabartë si edhe nxënësit romë, përkatësisht sa i përket numrit të përgjithshëm të nxënësve është 48% vajza dhe 52% djem, ndërsa pjesa e nxënësve që kanë përfunduar vitin shkollor është 49% vajza kundrejt 51% djem.²⁰⁵

²⁰² https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__ObrazovanieNauka__OsnovnoObrazovanie__KrajUcebna/325_osnucil_op_krajT10_ml.px/table/tableViewLayout2/?rxid=ef8122dc-af33-483a-9284-bbdbfee6960d

²⁰³ Bisedë me Arabela Iljaz, bashkëpunëtore e lartë për arsimin fillor, Merita Mustafi dhe Suzana Shabanovska, koordinatorë e programit të ndërmjetësve arsimorë romë, zhvilluar më datë 26.08.2024.

²⁰⁴ <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/Strategija%20za%20inkluzija%20na%20Romite%202022-2030%2003-02-2022%20finalna%20verzija.pdf>

²⁰⁵ https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__ObrazovanieNauka__OsnovnoObrazovanie__KrajUcebna/325_osnucil_op_krajT10_ml.px/table/tableViewLayout2/?rxid=ef8122dc-af33-483a-9284-bbdbfee6960d

Në pjesën e arsimit të mesëm, shkalla e nxënësve djem është më e lartë për 10% dhe është 53% kundrejt 47% i shkallës së nxënësve femra.

Megjithatë, sa u përket martesave të të miturve, ekziston një disproporcion midis djemve dhe vajzave që hyjnë në martesë adoleshente. Përkatësisht, në Regjistrimin e vitit 2021 janë regjistruar 260 djem të moshës 15 deri 19 vjeç, të cilët kanë deklaruar se janë të martuar, kundrejt 1,355 vajza me të njëjtin status martesor. Në kuadër të regjistrimit, nuk ka të dhëna për përkatësinë etnike në martesat e adoleshentëve, por nëse marrim parasysh se në cilat komuna janë më të shpeshta këto martesë, për shembull, Strumicë (104), Suto Orizarë (78), Prilep (73), Radovish (54), Gostivar (53), Tetovë (48)²⁰⁶, mund të përfundohet se këto janë komuna në të cilat ka komunitete të mëdha rome.

81) Të merret në konsideratë hartimi i programeve adekuate për personat që nuk e kanë përfunduar arsimin fillor ose janë analfabetë.

Në përputhje me Regjistrimin e vitit 2021, shkalla e analfabetizmit të popullsisë mbi moshën 15 vjeç në Republikën e Maqedonisë së Veriut është 1.24%²⁰⁷.

Shkalla e popullsisë analfabete është reduktuar për 60% nga Regjistrimi i vitit 2002 kur ishte 3%. Megjithatë, një shkallë konkrete e analfabetizmit të romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në kuadër të regjistrimit nuk është përcaktuar në mënyrë specifike.

Ekzistojnë programe të ndryshme të arsimit joformal brenda Qendrës së Arsimit të të Rriturve,

²⁰⁶ https://www.unicef.org/northmacedonia/media/14391/file/MK_CensusForChildren_Report_2024_MKD.pdf

²⁰⁷ <https://www.stat.gov.mk/publikacii/2022/Statistichki-atlas-mk-en-web.pdf>

por asnjë nga ato programe nuk e përfshin në mënyrë konkrete grupin e popullsisë analfabete. Programet sipas të cilave krijohen trajnimet kryesisht kanë të bëjnë me përvetësimin e aftësive, por jo edhe me shkrim leximin konkret.

Megjithatë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zbatohen aktivitete të shkrim-leximit për romët e rritur përmes projekteve të zbatuara nga organizatat e shoqërisë civile. Për më tepër, në kuadër të projektit rajonal “Forcimi i shkrim-leximit dhe aftësive matematikore të romët e rritur - Roma plus”, u përpiluan analiza për gamën e trajnimeve për shkrim-leximin e të rriturve romë²⁰⁸. Ky projekt u zbatua në periudhën 2020 - 2022, dhe në kuadër të projektit 60 të rritur romë u arsimuan, u trajnuan 10 trajnues dhe gjashtë organizata të shoqërisë civile u pajisën me aftësi të reja për mbështetjen e komunitetin rom. Përveç kësaj, projekti kontribuoi që të paktën 100 nxënës romë të përvetësojnë njohuri për përdorimin e platformës Massive Open Online Courses (MooC).

Në vitin 2020, nga organizata e shoqërisë civile SUMNAL u implementua “Roma ABC shko përpara” në kuadër të projektit rajonal, në të cilin u hartua një Manual i veçantë për trajnuesit dhe ndërmjetësit në masat e arsimit të romëve. Ky Manual ka të bëjë me aktorët e arsimit për të rritur që planifikojnë dhe zbatojnë kurse shkrim-leximi për romët²⁰⁹.

Nuk ka programe për arsimimin e romëve të rritur²¹⁰ në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

²⁰⁸ U hartuan analizat për nevojën e trajnimit për arsimimin e të rriturve romë brenda Projektit Roma Plus - Qendra Resurse e Romëve (rrc.org.mk)

²⁰⁹ “RomaABC shko përpara-Manual për zbatimin e trajnimit-për-arsimin e romëve dhe grupeve të tjera vulnerable në Evropë.pdf (sumnal.mk)

²¹⁰ Bisedë me Arabela Iljaz, bashkëpunëtore e lartë për arsimin fillor, Merita Mustafi dhe Suzana Shabanovska, koordinatore e programit të ndërmjetësve arsimorë romë, zhvilluar më datë 26.08.2024.

82) Të hartohen, ku është e nevojshme, programe për bursa për studentët romë dhe të inkurajohet rritja e pjesëmarrjes së tyre në programet ekzistuese për bursa.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke filluar nga viti shkollor 2016/2017, filloi një program për sigurimin e bursave për nxënësit, të siguruara plotësisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë²¹¹ (në atë kohë). Ky program është vazhdimi i programit të bursave për nxënësit romë të financuar dhe zbatuar nga Forumi Arsimor i Romëve dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni së bashku me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Në vitin shkollor 2016/2017, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me ndryshimet në Ligjin për standardin e nxënësve²¹², për herë të parë ligjërisht parashikoi një mundësi të veçantë që nxënësve romë t'u jepet një bursë, ku parashikohet të plotësojnë vetëm tre nga shtatë kërkesat e parashikuara që duhet t'i plotësojnë nxënësit e tjerë që aplikojnë për bursë, përkatësisht nxënësit romë duhet të jenë vetëm shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të jenë nxënës të rregullt në arsimin e mesëm dhe të kenë arritur sukses në arsim.

Në periudhën kohore nga viti 2019 deri në vitin 2023, më shumë se 4,500 bursa u siguruan nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për nxënësit romë në arsimin e mesëm. Konkretisht, në vitin shkollor 2016/2017 u siguruan 582 bursa, në vitin shkollor 2017/2018 u siguruan 736 bursa, në vitin shkollor 2018/2019 u siguruan 849 bursa, në vitin

shkollor 2019/2020 u siguruan 846 bursa, në vitin shkollor 2020/2021 u siguruan 886 bursa, në vitin shkollor 2021/2022 u siguruan 870 bursa, në vitin shkollor 2022/2023 u siguruan 889 bursa dhe në vitin shkollor 2023/2024 u siguruan 900 bursa²¹³.

Programi i bursave për studentët romë u bë i mundur përmes ndryshimeve në Ligjin për standardin e studentëve të vitit 2016²¹⁴. Ky ndryshim u iniciua me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (në atë kohë) në vitin 2015 me të cilin Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përmes Drejtorisë për Zhvillimin dhe Avancimin e Gjuhëve të Pjesëtarëve të Komuniteteve, filloi dhënien e bursave për studentët romë me qëllim të inkurajimit të romëve për t' u regjistruar në fakultetet që prodhojnë staf mësimdhënës²¹⁵. Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vitin studentor 2020/2021 ka dhënë 108 bursa nga të cilat 68 për studentet rome dhe 40 për studentët romë, në vitin studentor 2021/2022 ka dhënë 112 bursa nga të cilat 72 për studentet rome dhe 40 për studentët romë dhe në vitin studentor 2022/2023 ka dhënë 125 bursa nga të cilat 71 për studentet rome dhe 54 për studentët romë²¹⁶.

Ekzistojnë programe aktive që synojnë nxënësit e shkollave fillore nga klasa e parë deri në të katërtën në kuadër të Projektit TË RREGULLT NË ORË - Aksioni për përfshirjen e romëve në arsimin fillor të financuar nga Bashkimi Evropian. Ky projekt u zbatua në periudhën kohore tetor 2019 - tetor 2022 nga Fondacioni Shoqëria e Hapur -

²¹¹ Bisedë me Arabela Iljaz, bashkëpunëtore e lartë për arsimin fillor, Merita Mustafi dhe Suzana Shabanovska, koordinatore e programit të ndërmjetësve arsimorë romë, zhvilluar më datë 26.08.2024.

²¹² Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2016).

²¹³ Bisedë me Arabela Iljaz, bashkëpunëtore e lartë për arsimin fillor, Merita Mustafi dhe Suzana Shabanovska, koordinatore e programit të ndërmjetësve arsimorë romë, zhvilluar më datë 26.08.2024.

²¹⁴ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e studentëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2016).

²¹⁵ <https://www.mts.gov.mk/content/pdf/2022/Strategija%20za%20inkluzija%20na%20Romite%202022-2030%2003-02-2022%20finalna%20verzija.pdf>

²¹⁶ Bisedë me Arabela Iljaz, bashkëpunëtore e lartë për arsimin fillor, Merita Mustafi dhe Suzana Shabanovska, koordinatore e programit të ndërmjetësve arsimorë romë, zhvilluar më datë 26.08.2024.

Maqedoni dhe Qendra për Mbështetje në Arsim “Dendo Vas”, Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore “Hap pas Hapi” në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës²¹⁷.

Në kuadër të këtij projekti, për një periudhë trevjeçare, janë ndarë 1,515 bursa në vlerë prej 400 EUR gjatë vitit shkollor për të siguruar mbështetje financiare për familjet e nxënësve për shpenzimet e shkollimit, ushqimit, veshmbathjes, pajisjes dhe materialeve shkollore, pajisjes sportive dhe pajisjes tjetër për aktivitete jashtëmësimore. Nga numri i përgjithshëm i 1,515 bursave, 602 janë dhënë për nxënësit e klasës së parë, 634 për nxënësit e klasës së dytë dhe 279 për nxënësit e klasës së tretë, nga të cilat 777 për nxënëset rome dhe 738 për nxënësit romë, në 74 shkolla fillore në 33 komuna. Përveç sigurimit të mbështetjes financiare për familjet e rrezikuara sociale që kanë nxënës nga klasa e parë deri në të tretën në arsimin fillor, ky projekt siguroi edhe 47 grante të vogla për 47 shkolla fillore në shumën prej 2.500 euro me qëllim që t’i përdorin për materiale mësimore dhe pajisje për shkollat për të zhvilluar aktivitete që promovojnë mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit me theks mbi paralelet më të ulëta, krijimin e klimës pozitive në shkollë dhe transformimin e klasës ose hapësirës shkollore në një mjedis mësimor gjithëpërfshirës dhe stimulues, ku çdo fëmijë do të ndihet i pranuar, i motivuar dhe do të ketë mundësi t’i zhvillojë potencialet e tij për mësimnxënie dhe avancim²¹⁸.

Në dekadën e fundit, janë zbatuar edhe programe dhe aktivitete të tjera për të rritur gjithëpërfshirjen e sistemit arsimor sa u përket fëmijëve romë dhe për të gjetur mënyra dhe metoda për përfshirjen e tyre më të madhe në mënyrë që të zvogëlohet numri i lartë i fëmijëve romë që në atë kohë ishin jashtë sistemit arsimor.

83) Të inkurajohet edukimi kompjuterik midis romëve dhe sintive duke krijuar faqe interneti informative.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nuk është krijuar një sistem i qëndrueshëm për arsimimin digjital të romëve përmes institucioneve arsimore. Megjithatë, duke e pasur parasysh nevojën për edukimit digjital të njerëzve në shekullin 21, ekzistojnë aktivitete që synojnë sigurimin e edukimit bazë kompjuterik përkatësisht edukim digjital për romët në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Këto aktivitete janë kryesisht pjesë e projekteve të zbatuara nga shoqatat qytetare rome që kanë komunikim të drejtpërdrejtë me komunitetin rom dhe që kanë informacione në lidhje me nevojat e tij.

Brenda Qendrës së Arsimit për të Rritur, ekzistojnë programe të ndryshme të arsimit joformal, disa prej të cilave kanë të bëjnë me trajnime dhe përsosje profesionale në punën me kompjuterë, por me fokus të specializuar në një segment të veçantë, për shembull, marketingu digjital.

Për dallim prej këtyre programe, Projekti “Romaversitas – me zhvillim dhe aktivizim drejt integritetit dhe mundësive të barabarta”, mbështetur nga Fondi Arsimor i Romëve nga Budapesti në periudhën 2019 - 2020, ofroi trajnim kompjuterik për dhjetë persona nga radhët e studentëve dhe ish-studentëve romë.

Duhet të theksohet gjithashtu se ekzistojnë aktivitete të edukimit digjital, veçanërisht për gratë rome, të cilat ishin pjesë e “Programit për forcimin e aftësive të punësimit midis grave dhe të rinjve romë”, i cili u zbatua nga Qendra Resurse e Romëve brenda vitit 2022. Ky program siguroi edukim digjital për 57 gra dhe vajza rome²¹⁹.

²¹⁷ <https://fosl.mk/current-project/broshura-i-idea-za-promocija-na-rezultatite-od-proektot-redovno-na-chasovi-akcija-za-vkluchuvane-na-romite-vo-osnovnoto-obrazovanie/>

²¹⁸ Ibid.

²¹⁹ <https://rrc.org.mk/digital-literacy-for-roma-women/>

84) Të vlerësohet periodikisht efekti i politikave arsimore.

Vlerësimi i efektit të politikave arsimore të romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut bëhet shumë rrallë dhe mënyra në të cilën kryhet është parciale. Në praktikë, ekziston një analizë e politikave arsimore nga projektet e zbatuara në mbështetje të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pjesën e përfshirjes së romëve.

Këto analiza, të zbatuara kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ofrojnë një pasqyrë shumë të qartë të procesit të zbatimit të politikave arsimore të romët, si dhe krijimin e politikave të ardhshme në mënyrë që të sigurohet e drejta për arsim e garantuar me kushtetutë²²⁰.

Kapitulli VI i Planit të veprimit - Rritja e pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike

88) Vendet pjesëmarrëse inkurajohen të marrin në konsideratë kushtet themelore në vijim për të siguruar pjesëmarrjen efektive të romëve dhe sintive në jetën publike dhe politike:

- Përfshirja e hershme: Çdo iniciativë në lidhje me romët ose sintit duhet të përfshijë përfaqësues të tyre që nga fazat më të hershme të përgatitjes, zbatimit dhe vlerësimit;

- Përfshirja: Romët dhe Sintit duhet të përfshihen në proceset formale të konsultimit ndërsa efektiviteti i mekanizmave të krijuar

për pjesëmarrjen e tyre në formësimin e iniciativave kryesore duhet të sigurohet duke i përfshirë ata në një proces me përfaqësim të gjerë;

- Transparenca: Programet dhe propozimet duhet të dërgohen në kohën e duhur dhe mjaftueshëm përpara kalimit të afateve për miratimin e vendimeve, në mënyrë që të shqyrtohen seriozisht dhe të inkorporohen informacionet dhe të dhënat e nevojshme nga përfaqësuesit e komuniteteve rome dhe sinti;

- Pjesëmarrja e konsiderueshme e romëve dhe sintive në të gjitha nivelet e pushtetit: Pjesëmarrja e romëve dhe sintive në pushtetin vendor është thelbësore për zbatimin efektiv të politikave që i prekin konkretisht ata ;

- Përgjegjësia: Romët dhe Sintit kanë një rol thelbësor dhe të pazëvendësueshëm në ndërmarrjen e masave që në praktikë të respektohet dhe përdoret e drejta e pjesëmarrjes në procesin politik.

Jeta politike e romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut mbetet kryesisht në pjesëmarrjen në proceset zgjedhore, parlamentare, presidenciale dhe lokale në nivelin e zgjedhësve, pavarësisht nga fakti se në dekadën e fundit është rritur në mënyrë drastike numri i subjekteve politike rome. Aktualisht janë 10 parti politike: Partia për Prosperitetin Demokratik të Romëve - PPDR, Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve - PCER, Forcat Demokratike të Romëve - FDR, Partia Demokratike e Romëve - PDR, Romët e Bashkuar nga Maqedonia (RBM), Partia e Bashkuar për Barazinë e Romëve - PBBR, Bashkimi i Romëve të Maqedonisë - MRM, Unioni Demokratik Qendror - UDQ, Unioni i Romëve - UR dhe AVAJA.

²²⁰ <https://www.rcc.int/romaintegration2020/files/admin/docs/7d34b283f41adbd0c4e974b47cc4468f.pdf>

Shfaqja e disa partive politike është për shkak të pakënaqësisë së komunitetit rom nga disa parti politike që u shfaqën në fillim të demokratizimit të vendit. Kryetarja e partisë politike Unioni i Romëve, Fatima Osmanovska, e vetmja grua rome në krye të një partie politike, ia atribuon formimin e subjekteve të reja politike në komunitetin rom “sjelljes egoiste të politikanëve më të vjetër romë dhe dështimit të tyre për të vënë interesat e komunitetit para ambicieve dhe egos personale”.²²¹

Megjithatë, fragmentimi i forcës politike përmes veprimit të një duzine partish politike rome rezulton edhe me ndarjen e elektoratit rom, i cili jo zyrtarisht numëron rreth 45,000 vota. Kjo, e pasqyruar në mandate deputetësh, do të thoshte 3-4 deputetë²²². Por ekziston rreziku që në zgjedhjet e vitit 2024, për herë të parë në historinë e proceseve zgjedhore, romët të mbeten pa asnjë deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut²²³.

Ky rezultat do të thotë që përfaqësuesit e romëve nuk do të përfshihen sa duhet në krijimin e politikave në dhomën ligjvënëse. Nga ana tjetër, qeveria e re e zgjedhur në qershor 2024 riktheu pozicionin e ministrit pa portofol përgjegjës për çështjet rome që u shfuqizua në vitin 2020. Ky pozicion i ministrit pa portofol që nga vetë rikthimi filloi të forcohet administrativisht me burime njerëzore. Plani i Ministrit pa portofol është rritja e konsiderueshme e kapaciteteve administrative të kabinetit të tij. Që nga rivendosja e këtij pozicioni,

janë bërë përpjekje për ta forcuar atë me burime njerëzore, ndërsa zgjerimi i mëtejshëm është planifikuar për vitin e ardhshëm. Përkundër këtyre përpjekjeve kadrovike, përgjegjësitë e resorit të ministrit kërkojnë mbështetje akoma më të madhe administrative nga institucionet relevante për zbatimin efektiv të agjendës politike që synon përfshirjen e romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut²²⁴.

Përveç ministrit pa portofol përgjegjës për çështjet rome, nga radhët e partive politike rome në qeverinë e re u emëruan zëvendësministri i vetëqeverisjes lokale Erxhan Selimi²²⁵ dhe zëvendësministri për marrëdhënie midis bashkësive Nezhdet Mustafa²²⁶.

Në pjesën e vetëqeverisjes lokale, situata është e pandryshuar për arsyen se këshilltarët romë në Komunën Shuto Orizarë janë shumicë, që korrespondon me popullsinë në këtë komunë. Por përfaqësimi i romëve përmes këshilltarëve të tyre në komunat e tjera nuk korrespondon me nurin e popullatës rome.

Përfshirja e romëve në iniciativë, para së gjitha, kryhet përmes sektorit civil, i cili ka kapacitete të angazhohet në mënyrë aktive në iniciativat e propozuara si në nivelin lokal ashtu edhe në atë kombëtar. Aktualisht, ka një duzinë shoqatash të qytetarëve romë që veprojnë në nivel lokal dhe kombëtar duke siguruar një platformë për qytetarët romë për të marrë pjesë në proceset që i zbaton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes ministrive kompetente. Veçanërisht duhet theksuar se këto shoqata kanë mundësi të marrin pjesë në mënyrë aktive në Autoritetin Kombëtar Koordinues - AKK fillimisht për zbatimin

²²¹ <https://lokalno.mk/osmanovska-od-unija-na-romi-postoi-sebichnost-kaj-postarite-romski-politichari-i-nemozhnost-da-gi-trgnat-na-strana-lichnite-interesi-i-egoto-pred-interesite-na-celokupnata-romska-zaednica/>

²²² <https://plusinfo.mk/na-malku-glasovi-za-pratenik-se-potrebnivo-vo-ie6-a-na-mnogu-vo-ie1-eve-kolku-chini-mesto-vo-sobranieto-sporod-dontoviot-model/>

²²³ <https://www.sobranie.mk/pratenici-vo-parlament.nspx%20%20%20%20%20%20%20%20%20%20%20%20%20.nspx>

²²⁴ Bisedë me Shaban Saliun, ministër pa portofol, e zhvilluar më datë 29.8.2024.

²²⁵ <https://mls.gov.mk/mk/Ministria/Zevendesministri>

²²⁶ Ministria për Marrëdhënie midis Bashkësive

e Dekadës së Romëve, dhe tani Strategjinë për përfshirjen e romëve 2022 – 2030.

Në fushën e transparencës, nuk ka sistem për paraqitjen në kohë të iniciativave dhe propozimeve në mënyrë që komuniteti rom të ketë kohë të mjaftueshme për t'i shqyrtuar ato. Zakonisht, thirrja është për një afat të shkurtër “prej sot deri nesër”, dhe varet nga komuna në komunë. Komunikimi bëhet përmes përfaqësuesve komunalë ose përmes përfaqësuesve të zyrave lokale të ministrive kompetente ose qendrave për punë sociale ku drejtohet një numër i madh qytetarësh të komuniteti rom ²²⁷.

89) Përfaqësuesit e zgjedhur duhet të krijojnë lidhje të ngushta pune me komunitetin rom dhe sinti.

Në të vërtetë, komunikimi midis komunitetit rom dhe përfaqësuesve të zgjedhur zhvillohet në disa mënyra. Mënyra e parë është komunikimi i drejtpërdrejtë, për shembull, kryetari i Komunës së Shuto Orizarës ka takime me qytetarë dhe përfaqësues të grupeve të caktuara që jetojnë në territorin e Komunës Shuto Orizarës²²⁸.

Mënyra e dytë është kur personat e zgjedhur përmes zyrave lokale të institucioneve prej aty ku vijnë krijojnë komunikim me përfaqësuesit e komunitetit rom.

Mënyra më efektive është komunikimi përmes organizatave të shoqërisë civile që kanë përvojë dhe njohuri se si t'i kanalizojnë mesazhet dhe iniciativat në diskutimet politike. Këtu theksohet

²²⁷ Bisedë me Aksel Ahmedovski, politikan dhe ish-ministër pa portofol përgjegjës për çështjet e romëve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Republika e Maqedonisë së Veriut), e mbajtur më datë 31.7.2024.

²²⁸ Bisedë me z. Kurto Dudush, Kryetar i Komunës Shuto Orizarë, mbajtur më datë 27.6.2024.

veçanërisht rëndësia e organizatave lokale të shoqërisë civile që janë të njoftuara mirë me nevojat dhe problemet e popullsisë lokale²²⁹.

90) Të krijohen mekanizma për të siguruar komunikim të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të hapur midis përfaqësuesve të romëve dhe sintive, dhe autoriteteve të pushtetit, duke i përfshirë organet këshilluese dhe konsultative.

Kur bëhet fjalë për komunikim të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe transparent të përfaqësuesve të romëve dhe institucioneve shtetërore, ekzistojnë dy mekanizma formalë. Mekanizmi i parë është mekanizmi politik, dhe ky është ministri pa portofol për çështjet rome. Ky pozicion mbetet mekanizmi i vetëm për parashtrimin e pyetjeve rreth situatës së romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në nivelin më të lartë politik, përkatësisht në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mekanizmi që bazohet në profesionalizëm dhe institucionalitet është Autoriteti Kombëtar Koordinues - AKK për zbatimin e Strategjisë për përfshirjen e romëve 2022 - 2030, bëhet fjalë për një autoritet ndërministror që duhet të monitorojë progresin e zbatimit të Strategjisë, i cili përfshin 15 anëtarë nga të gjitha institucionet relevante fillimisht për zbatimin e Strategjisë, duke filluar me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (tani Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë), Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Transportit, Ministrinë e Kulturës, dhe organe të tjera, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. AKK e monitoron zbatimin e Strategjisë, me ç'rast harton raporte. Këto raporte u përmbledhën deri në qershor 2024 nga Këshilltari për çështje rome i Kryetarit të Qeverisë

²²⁹ Bisedë me Aksel Ahmedovski, politikan dhe ish-ministër pa portofol përgjegjës për çështjet e romëve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Republika e Maqedonisë së Veriut), e mbajtur më datë 31.7.2024.

së Republikës së Maqedonisë së Veriut në formën e konkluzionit dhe më pas paraqitej në Qeveri për miratim²³⁰.

Në periudhën 2018 - 2024, u krijua edhe një mekanizëm tjetër në funksion të mbështetjes së procesit të përfshirjes së romëve, por në kuadër të pushtetit ligjvënës. Së këtejmi, në vitin 2018, në kuadër të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (në atë kohë), u krijua “Grupi Parlamentar Ndërpartiak për të Drejtat e Romëve në Republikën e Maqedonisë”, i cili përfshinte deputetë nga legjislatura ekzistuese e kuvendit nga parti të ndryshme politike, ku komuniteti rom mund të drejtohej drejtpërdrejt dhe të hapte diskutim në dhomën ligjvënëse për çështje në interes të komunitetit rom.

91) Të lehtësohet ndërveprimi midis liderëve politikë në nivel lokal dhe qendror dhe grupeve të ndryshme rome.

Pjesëmarrja e subjekteve politike rome është plotësisht e fragmentuar, duke çuar në vështirësi në ndërveprimin midis liderëve politikë si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal. Qytetarët romë kanë perceptim për më shumë liderë të partive politike dhe OJQ-ve në ç’do qytet, siç është Manastiri, ku gjashtë liderë pretendojnë se i përfaqësojnë ata. Një grua rome nga Manastiri theksoi se nevojitet menaxhim efektiv dhe fokus mbi problemet dhe prioritetet aktuale të popullsisë rome, siç theksohet në hulumtimin: “Romët - Hulumtimi kualitativ dhe kuantitativ”²³¹.

Mungesa e ndërveprimit ka çuar në formimin e tre partive të reja politike rome në katër vitet e fundit: Unioni i Romëve, Partia Popullore e Romëve dhe

AVAJA, e cila nga lëvizje kaloi në parti politike. AVAJA ishte e vetmja parti politike rome që u formua më pak se një muaj para shpalljes së zgjedhjeve dhe performoi në mënyrë të pavarur në zgjedhjet parlamentare. Nga ana tjetër, mungesa e ndërveprimit dhe konsolidimit²³² e ndërlikon procesin e zbatimit të politikave për përmirësimin e gjendjes së romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

92) Të organizohen fushata për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me rëndësinë e zgjedhjeve, për të rritur pjesëmarrjen e votuesve romë në zgjedhje.

Fushatat informuese mbi rëndësinë e votës rome në zgjedhje, janë kryesisht në domenin e veprimit të organizatave dhe lëvizjeve të shoqërisë civile. Para se të transformohej në parti politike, lëvizja qytetare AVAJA zhvilloi aktivitete nga fushata “Ne Votojmë, Ne Vendosim”. Në kuadër të kësaj fushate, u ngrit rëndësia e votës politik të romëve në zgjedhjet presidenciale të vitit 2019, si dhe inkurajimi i romëve për të ushtruar të drejtën e tyre të votës.

Gjatë kësaj fushate, e cila thekson nevojën për përpjekje më serioze të avancimit të pozitës së romëve, iniciativa e qytetarëve AVAJA mbledhi 10 322 nënshkrime nga 14 komuna²³³.

Para zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Fondacioni Romët për Demokraci organizoi ngjarje në mënyrë që të forcojë zërin e romëve në segmentin e pjesëmarrjes politike. Kjo ngjarje u quajt: “Mirë për romët, mirë për Republikën e Maqedonisë së Veriut”, e cila është një iniciativë për ballafaqimin me prioritetet politike dhe sfidat politike me të

²³⁰ Bisedë me Elvis Memetin, Këshilltar për çështjet rome i Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbajtur më datë 31.7.2024.

²³¹ <https://electoralsupportprogramme.mk/wp-content/uploads/2021/09/9.%D0%A0%D0%BE%D0%BC%D0%B8.pdf>

²³² Krahazo me deklaratën e Nezhdet Mustafës të marsit 2024 Nezhdet Mustafa: Nga një shoqëri për të gjithë ne bëmë shtet binacional - Republika (republika.mk)

²³³ https://novamakedonija.com.mk/makedonija/Bashkësia_romeme_tre_përparësi/

cilat përballen komuniteti rom²³⁴. Nga ana tjetër, Këshilli i Evropës në Ballkanin Perëndimor, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, zbaton Programin ROMACTED, “Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimi i romëve në nivel lokal”²³⁵. Ky program i Këshillit të Evropës synon të forcojë komunitetin rom duke përmirësuar qeverisjen lokale demokratike përmes ndërtimit të kapaciteteve individuale dhe kolektive në komunitetin rom.

Platforma “MIRO VOTO - MIRO BARIPE” e vitit 2016, e përbërë nga shoqata rome, e vëzhgoi procesin zgjedhor që t’i sigurojë të drejtat e votës së romëve. QKR theksoi rëndësinë e autonomisë së votuesve dhe bashkëpunimit me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve. QKR-ja synon zgjedhje të ndershme dhe inkurajon denoncimin e parregullsive. Ishin regjistruar 120 vëzhgues, duke u fokusuar në zonat me numër të konsiderueshëm të komunitetit rom²³⁶.

Këto fushata dhe aktivitete rrisin ndjeshëm ndërgjegjësimin dhe kapacitetet e komunitetit rom, duke e ndërgjegjësuar për rëndësinë e votës që secili individ e ka në proceset zgjedhore dhe si vota e njëjtë ndikon në politikat e përmirësimit të gjendjes së romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

93) Të sigurohet që votuesit romë mund të votojnë lirshëm dhe në bazë të informacioneve të mjaftueshme.

²³⁴ <https://trn.mk/dobro-za-romite-dobro-za-severna-makedoni%D1%98A/>

²³⁵ <https://www.coe.int/mk/web/skopje/promoting-good-governance-and-roma-empowerment-at-local-level-romacted-ii-1>

²³⁶ Krahassuar me Vëzhguesit e Qendrës Kombëtare të Romëve do të monitorojnë zgjedhjet (a1on.mk); Platforma Miro Voto Miro Baripe Mediski Nastap TV 21 QKR - Qendra Kombëtare Rome (nationalromacentrum.org); NJOFTIM PËR PUBLIKUN - Qendra Kombëtare Rome (nationalromacentrum.org)

E drejta e votës në procesin zgjedhor është e garantuar për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfshirë edhe komunitetin rom. Megjithatë, u fol në publik për funksionarët politikë që praktikojnë praktikën e votimit të detyruar që synonin romët. Për të përmirësuar integritetin dhe besimin zgjedhor, është thelbësore që këto akuza të adresohen në mënyrë transparente. Zbatimi i hetimeve të plota për këto pretendime do të demonstronte një përkushtim për ruajtjen e parimeve demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave të votimit të të gjithë qytetarëve.²³⁷ Asnjë hetim nuk është kryer ndonjëherë për të provuar nëse ka pasur votim të detyruar të romëve në zgjedhjet lokale në komunën e Strumicës.

Në deklaratën mbi gjetjet dhe konkluzionet preliminare të misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e fundit presidenciale në vitin 2024, u specifikua “Megjithatë, në një shkallë të caktuar, u vërejt votimi grupor dhe familjar. Edhe pse fshehtësia e votimit përgjithësisht është respektuar, vëzhguesit e Misionit Ndërkombëtar Vëzhgues të Zgjedhjeve raportuan votim grupor ose familjar në 2% të vëzhgimeve (17 raste).” Vëzhguesit më tej vunë në dukje se “Incidentet dhe parregullsitë, përfshirë fushatën dhe frikësimin e votuesve në afërsi të qendrave të votimit, transportin e organizuar të votuesve, ndihmën e votuesve dhe votimin familjar, u vërejtën shumë më shpesh në zonat ku jetojnë komunitetet e marginalizuara”.²³⁸

Nga përvoja e deritanishme, romët më së shpeshti përdorin votën e tyre për të votuar subjektet politike rome.²³⁹

²³⁷ <https://frontline.mk/2024/06/13/ankuloska-ne-odgovori-za-ciganite-za-ushi-chovechi-ata-nekoe-livche-neka-snema/>

²³⁸ <https://www.osce.org/files/f/documents/4/6/567274.pdf>

²³⁹ Bisedë me Shaban Saliun, ministër pa portofol, e zhvilluar më datë 29.8.2024.

E drejta e votës së gruas rome respektohet ndryshe në varësi të komunës në fjalë. Me fjalë të tjera, në disa komuna, si Shuto Orizara, është vërejtur pjesëmarrje e përbashkët deri te qendrat votimit, por jo edhe votim familjar. Ndryshe nga kjo komunë, në Komunën e Delçevës nuk është vërejtur pjesëmarrje e përbashkët në qendrat e votimit.²⁴⁰

94) Të ndërmerren masa për garantimin e të drejtave të barabarta të zgjedhjes së grave, duke përfshirë edhe zbatimin e ndalimeve për të ashtuquajturin “votim familjar”.

Misioni i OSBE-së në Shkup në vitin 2021 në kuadër të Projektit “Mbështetje qeverisjes demokratike dhe proceseve të përfshirjes”, në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, hartoi një broshurë informuese për votuesit e rinj - Informacione lehtësisht të kuptueshme. Qëllimi i kësaj broshure ishte informimi i votuesve të rinj për nocionin e pjesëmarrjes rinore, format e tij, pjesëmarrjen politike të të rinjve, llojet e zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mënyrën e organizimit dhe mbajtjes së zgjedhjeve, si dhe të drejtën e votës dhe mbrojtjen e saj, mënyrat e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së grave²⁴¹.

Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu organizojnë aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtën politike të votës. Përkatësisht, në mënyrë që të avancohet pjesëmarrja demokratike e romëve në shoqëri, që të promovohen zgjedhje të drejta dhe demokratike dhe për të forcuar votuesit romë, Fondacioni Romët për Demokraci

në vitin 2024 paraqiti një Iniciativë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me titull “Mirë për gratë rome, mirë për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”²⁴². Qëllimi i kësaj iniciative ishte forcimi dhe përfshirja e gruas rome në jetën publike dhe politike. Pjesëmarrje në këtë iniciativë morën një numër i madh i grave rome që kryejnë detyra profesionale në institucione dhe organizata dhe projekte ndërkombëtare.

95) Të inkurajohen romët dhe sintit të përfshihen në mënyrë më aktive në shërbimet publike, duke përfshirë, kur është e nevojshme, përmes inkorporimit të masave speciale për stimulimin e pjesëmarrjes së tyre në shërbimet publike.

Numri i romëve të punësuar në administratën publike po rritet gradualisht, duke marrë parasysh numrin e romëve të punësuar në administratën publike për vitin 2007, i cili arriti në 464 të punësuar ose 0.78%²⁴³ deri në numrin në vitin 2023 prej 1 651 të punësuar ose 1.49%²⁴⁴. Ky është rezultat i të gjitha masave të marra, fillimisht masat në arsim dhe masat e marra në pjesën e punësimit.

Megjithatë, mbetet problemi me faktin se, pavarësisht rritjes drastike të numrit apo përqindjes së romëve në shërbimet publike, kjo nuk reflektohet në numrin e romëve në pozicione drejtuese në administratë.

96) Të stimulohet përfaqësimi i romëve dhe sintive në shërbimin shtetëror, në pozita që kanë të bëjnë me zgjedhje dhe emëtime.

²⁴⁰ Bisedë me Aksel Ahmedovski, politikan dhe ish-ministër pa portofol përgjegjës për çështjet e romëve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Republika e Maqedonisë së Veriut), e mbajtur më datë 31.7.2024.

²⁴¹ <https://www.osce.org/files/f/documents/d/2/501181.pdf>

²⁴² <https://www.romatimes.news/index.php/en/ngo-sector/ngo-projektet/6904-romite-za-demokratija-so-inicijativa-dobro-za-zhenite-romki-dobro-za-sobranieto-na-rsm>

²⁴³ <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Godisni%20izvestai/GI-2014/GI%202014.pdf>

²⁴⁴ Ibid.

Përfaqësimi në pjesën e personave të zgjedhur dhe emëruar nga komuniteti rom është në një nivel shumë të ulët. Për sa kohë që Avokati i Popullit mbante statistika për personat e zgjedhur dhe të emëruar sipas përkatësisë etnike, numri i romëve ishte prej shtatë deri në nëntë funksionarë²⁴⁵.

Këtu duhet të theksohet se në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, partitë politike rome nuk u përfaqësuan për herë të parë me një deputet/deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut²⁴⁶.

Akoma ekziston vazhdimësia nga viti 1996 që kryetari i Komunës së Shuto Orizarës të jetë rom si dhe numri më i madh i këshilltarëve në Komunën e Shuto Orizarës. Ndryshe nga kjo komunë, në këshillat e komunave të tjera, votat e romëve nuk vlerësohen në zgjedhjen e këshilltarëve. Për shembull, në Komunën e Manastirit, ku ka një komunitet më të madh rom, nuk ka asnjë këshilltar rom²⁴⁷ në Këshillin Komunal.

Pas zgjedhjeve parlamentare në vitin 2024, në Qeveri u emëruan tre politikanë romë, përkatësisht Shaban Salii - Ministër pa portofol, Nezhdet Mustafa - Zëvendësministër i Marrëdhënieve midis Bashkësive, dhe Erxhan Selim - Zëvendësministër i Vetëqeverisjes Lokale.

97) Të fuqizohen dhe integrohen romët dhe sintit në proceset vendimmarrëse në nivel të autoriteteve shtetërore dhe lokale si përfaqësues të zgjedhur të komuniteteve të tyre dhe si qytetarë të vendit të tyre.

Rritja e subjekteve politike në komunitetet rome tregon qartë se ekziston një nevojë në

rritje për pjesëmarrjen e romëve në procesin e vendimmarrjes si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror. Nëse e marrim parasysh moshën e personave që janë në subjektet e reja politike, lehtë mund të shihet se këto subjekte janë themeluar nga një brez i ri i romëve, me ç'rast mund të supozohet se romët e rinj nuk janë të kënaqur me politikën e deritanishme të subjekteve politike që kanë ekzistuar më gjatë në skenën politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Hulumtimi i Romalitiko 2015²⁴⁸ thekson se “nga sondazhi i zbatuar vërehet se një përqindje e madhe e romëve votuan në zgjedhjet lokale, gjë që tregon faktin se romët kanë potencial për demokraci pjesëmarrëse dhe ende kanë një besim të fortë në proceset demokratike në Republikën e Maqedonisë.” Këtu vërehet se nëse vetëqeverisjet lokale të anketuara nuk bëjnë përpjekje për të përfshirë romët në procesin e vendimmarrjes, me kalimin e kohës pakënaqësia midis romëve do të rritet dhe kjo do të zvogëlojë numrin e romëve që do të kontribuonin në demokracinë pjesëmarrëse në Republikën e Maqedonisë. “

Veç tjerash, ky hulumtim thekson se, megjithëse format e ndryshme të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve janë në dispozicion, ato pamjaftueshëm përdoren, ndërsa shumë romë janë joaktivë. Mekanizmat efektivë për pjesëmarrje përfshijnë ditët e pritjes të kryetari i komunës, iniciativa qytetare, tubime të qytetarëve, referendume, parashtrës, tribuna publike dhe sondazhe. Përkundër këtyre mundësive, romët tregojnë interes dhe mirëkuptim të kufizuar për vetëqeverisjen lokale, kryesisht për shkak të mungesës së përpjekjeve nga ana e komunave për t'i integruar ato në procesin e vendimmarrjes. Analiza vëren se autoritetet lokale kontribuojnë

²⁴⁵ <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Godisni%20izvestai/GI-2017/GI-2017.pdf>

²⁴⁶ <https://www.sobranie.mk/pratenici-vo-parlament.nspx%20%20%20%20%20%20%20%20%20%20%20%20%20.nspx>

²⁴⁷ <https://www.bitola.gov.mk/keshilltar/>

²⁴⁸ <https://romalitiko.org/wp-content/uploads/2024/02/uchestvoto-na-romite-vo-proczesot-na-donesuvane-odluki-na-lokalno-nivo.pdf>

në nivelin e ulët të ndërgjegjësimit midis romëve duke mos marrë masa të vazhdueshme dhe sistematike për t'i përfshirë ato. Kjo rezultoi në mungesë të të kuptuarit të proceseve lokale, mos përfshirje dhe mungesë informacioni, duke çuar përfundimisht në një nivel të ulët besimi dhe pakënaqësi me punën e autoriteteve lokale. Zgjidhja e këtyre problemeve ka rëndësi të madhe për përmirësimin e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së romëve në proceset demokratike.

Nevoja për pjesëmarrje aktive është e dukshme nga fakti se të rinjtë romë të angazhuar në shoqëri filluan të përfshihen në mënyrë aktive në proceset politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke u përpjekur të përmirësojnë situatën e romëve. Për shembull, lëvizja qytetare AVAJA kaloi në parti politike pak para zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare në maj të vitit 2024.²⁴⁹

Qendrat e informacionit të romëve janë gjithashtu një mekanizëm i dobishëm për informimin e komunitetit rom për zhvillimet shoqërore të të gjitha segmenteve. QIR punojnë me qytetarët për të zgjidhur problemet e tyre, si dhe nevojat e komunitetit.

Gjatë vitit 2023, në komunat ku ka komunitete rome operojnë tetë qendra informative rome, Gostivar, Delçevë, Negotinë, Kërçovë, Manastir, Shuto Orizarë, Koçani dhe Vinicë. Deri në fund të vitit 2023, gjithsej 4,151 shërbime janë ofruar nga QIR-ët, me fokus në shërbimet sociale në fushën e mbrojtjes sociale - 3,466 persona, 188 persona në kujdesin shëndetësor, banim - 68, arsim - 247, punësim - 80 persona, për dokumentacion personal - 86 persona, anti-diskriminim - 0 dhe shërbime të tjera - 16. QIR-ët punojnë vazhdimisht në informimin e komuniteteve në lidhje me shpalljet e publikuara për masat dhe programet në përputhje me Planin Operacional të Punësimit

brenda AP Republikës së Maqedonisë së Veriut. Deri në fund të dhjetorit 2023, katër qendra informative rome (Gostivar, Negotinë, Manastir dhe Shuto Orizarë) mbeten funksionale. Gjatë vitit 2023, përfundoi transformimi i QIR-ve nga Kërçova dhe Delçeva në qendra për punë sociale, përkatësisht informatorët janë të punësuar rregullisht²⁵⁰.

98) Të promovohet pjesëmarrja e grave rome në jetën publike dhe politike; Gratë rome duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë të barabartë me burrat në mekanizmat konsultativë dhe të tjerë të dizajnuar për të rritur qasjen në të gjitha fushat e jetës publike dhe politike.

Në periudhën e fundit, ka tendencë për rritjen gjithnjë e më të madh të aktivizimit politik në kuadër të komunitetit rom. Përkatësisht, në vitin 2023, pati një numër të madh aktivitetsesh si në monitorimin e fushatave politike ashtu edhe në rritjen e ndërgjegjësimit publik të komunitetit rom për rëndësinë e votës politike të secilit rom. Gjatë zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare, Fondacioni Romët për Demokraci performoi me 162 vëzhgues²⁵¹ të pranishëm në qendrat e votimit. Ndërkohë, Fondacioni Romët për Demokraci parashtrroi një nismë "Mirë për gratë rome, mirë për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut" në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëllim të promovimit të avancimit të pjesëmarrjes së romëve në proceset shoqërore dhe promovimin e zgjedhjeve të ndershme dhe demokratike. Fondacioni Romët për Demokraci e

²⁴⁹ <https://novamakedonija.com.mk/makedonija/politika/avaja-nova-politichka-partija-na-romite/>

²⁵⁰ mtsp.gov.mk/content/word/25D0%25B1%25D0%25B0%25D1%2580%25D0%25B0%25D1%259A%25D0%25D0%25D0%25D0%25DF%25D1%25D1%25D1%25D1%25D1%25D0%25D0%25D0%25D0%25BF%2F2024%2F14-571.docx

²⁵¹ <https://www.facebook.com/romitezademokratija/>

vuri në dukje nevojën që gratë rome të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në proceset demokratike dhe zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Fondacioni theksoi se “megjithëse kanë kaluar më shumë se tri dekada nga inkorporimi i sistemit shumë partiak dhe përpjekjet e bëra për përfshirjen e komuniteteve joshumicë, kushtet e përfshirjes së grave rome akoma nuk janë krijuar. Ky shfrytëzim i pamjaftueshëm i potencialit të tyre kontribuon në marginalizimin më të madh dhe pengon zhvillimin e sundimit demokratik”²⁵².

Ky lloj i fushatave është i nevojshëm për të rritur pjesëmarrjen e grave rome në proceset politike, të cilat janë thelbësore për përmirësimin e statusit të grave rome në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vetë pozicioni i gruas rome është joaktiv, kryesisht për shkak të stereotipave të ndërtuara që janë specifikuar në analiza dhe hulumtime të shumta në periudhën e kaluar. Me fjalë të tjera, në hulumtimin Gratë në politikë: Rruga drejt funksioneve dhe ndikimit politik në nivel lokal në Maqedoni në REAKTOR - Hulumtimi në veprim, nga viti 2015, u konstatua “ ende është e pranishme edhe praktika pas zgjedhjes së tyre këshilltarët të japin dorëheqje, veçanërisht ato të përkatësisë etnike rome dhe shqiptare”²⁵³. Megjithatë, situata ndryshon me kalimin e kohës, duke pasur parasysh se në përbërjen parlamentare të vitit 2020 kishte një deputete rome, si dhe faktin se për herë të parë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si lider i një partie politike rome është grua, gjë që është një inkurajim i veçantë për gratë rome, si dhe për të gjithë komunitetin rom.

Kapitulli VII i Planit të veprimit - Romët dhe sintit në situata krize dhe pas-krizës

107) Gjatë përcaktimit të situatave të krizës, konsultohuni me popullsinë rome dhe sinti për të lehtësuar procedurat përkatëse dhe për të identifikuar zonat specifike gjeografike nga të cilat ikin refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit, si dhe për të siguruar që situata e tyre specifike të merret parasysh.

Numri i romëve nga Kosova, të cilët janë nën mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, aktualisht është më pak se 200 persona. Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj - SHMAR, si partner i Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët - UNHCR/ Zyra në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga viti 2011 ofron në mënyrë aktive ndihmë juridike për personat nga Kosova që ikën në territorin e Republikës së Maqedonisë (në atë kohë) duke përfaqësuar interesat e tyre para institucioneve dhe duke rregulluar statusin e tyre.

Duke marrë parasysh nevojën për të gjetur një zgjidhje të përhershme për statusin e personave nga Kosova që janë nën mbrojtje ndërkombëtare ose që kanë pasur mbrojtje ndërkombëtare, SHMAR, në bashkëpunim me Grupin Parlamentar Ndërpartiak për të Drejtat e Romëve dhe Komisionin Juridik Ligjvënës pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, propozoi ndryshime në Ligjin për të huajt në vitin 2023 të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Këto ndryshime, të cilat u inkorporuan me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të huajt nga fundi i vitit 2023²⁵⁴ (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 282/23),

²⁵² <https://www.romatimes.news/index.php/en/ngo-sector/ngo-projektet/6904-romite-za-demokratija-so-inicijativa-dobro-za-zhenite-romki-dobro-za-sobranieto-na-rsm>

²⁵³ https://reactor.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/Gratë-në-politikë_-MK.pdf

²⁵⁴ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të huajt (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr 282/23).

ofrojnë mundësi për të fituar një leje qëndrimi të përhershme për personat e mbetur nën mbrojtje ndërkombëtare që u larguan nga Kosova gjatë krizës së vitit 1999.

Nëpërmjet kësaj procedure të lehtësuar, Sektori për Azil pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme lëshon certifikatë për mbrojtje ndërkombëtare, me ç'rast pason kontrolli i sigurisë i personave që aplikojnë për leje qëndrimi të përhershëm. Përveç kësaj, personat që mund ta shfrytëzojnë mundësinë për të marrë leje qëndrimi të përhershme nuk duhet të largohen nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut për një periudhë prej gjashtë muajsh. Parashtrimin e kërkesave bën Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj në kuadër të projektit: "Avokimi për ndihmë juridike, gjetja e personave me interes për UNHCR-në dhe avokimi dhe ndihma për t'i dhënë fund pa shtetësisë" mbështetur nga UNHCR-ja.

108) Të sigurohet që në një situatë zhvendosjeje të detyruar (si refugjatë ose persona të zhvendosur brenda vendit) popullsia romë dhe sinti është regjistruar në mënyrë adekuate dhe u janë siguruar dokumentet e nevojshme.

Shumica e personave nga Kosova kanë paraqitur kërkesa për qëndrim të përkohshëm për arsye humanitare, në përputhje me Ligjin për të huajt. Disa prej tyre statusin e tyre e rregullojnë mbi bazë të martesës dhe me përjashtime mbi bazën e origjinës²⁵⁵.

Raporti i progresi i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2003 vuri në dukje se "Vendi ka 235 romë, ashkali dhe

egjiptianë nga Kosova^{*256*}, duke përfshirë edhe 11 persona me status refugjati, 64 nën mbrojtje subsidiare dhe 160 persona, statusi i mbrojtjes së të cilëve ka përfunduar. Këta persona janë në situatë vulnerable për shkak të mungesës së statusit ligjor dhe qasjes së mjaftueshme në të drejtat fundamentale. Në vitin 2022, gjithsej nëntë persona morën ndihmë për kthimin vullnetar në vendet e tyre të origjinës përmes Programit për kthimin dhe riintegrimin e asistuar vullnetar".²⁵⁷

Për shkak të një anomalie të sistemit në rast të ndërprerjes së mbrojtjes ndërkombëtare, statusi i këtyre personave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është zgjidhur as pas 25 vjetësh. Përveç se janë nën mbrojtje subsidiare ose mbrojtje të përkohshme, shteti u mundësoi këtyre personave të aplikojnë për qëndrim të përkohshëm, por përkundër kësaj zgjidhjeje të përkohshme, janë edhe 172 të tjerë që nuk kanë status në Republikën e Maqedonisë së Veriut sepse mbrojtja e tyre ndërkombëtare është ndërprerë. Nga këta 172 persona, 130 tani më kanë aplikuar për qëndrim të përhershëm, ndërsa 42 persona duhet të aplikojnë për qëndrim të përhershëm ose për shtetësi.²⁵⁸

Në praktikë, këta persona nuk janë në rrezik për shkak se tolerohen nga policia dhe Ministria e Punëve të Brendshme, Sektori i të Huajve dhe Sektori i Azilit, pra nuk ka praktikë dëbimi.

Në periudhën kohore nga viti 2012 deri në vitin 2018, personave që ua ndërprejnë mbrojtjen ndërkombëtare Sektori i Azilit u lëshonte karton

²⁵⁶ * Ky përcaktim nuk është në kundërshtim me qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

²⁵⁷ <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657>

²⁵⁸ Bisedë me Vildan Drpljanin, UNHCR, e mbajtur më datë 23.7.2024.

²⁵⁵ Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj, 1.8.2024.

të verdhë, gjë që u lejoi atyre të qëndronin në territorin e Republikës së Maqedonisë (në atë kohë). Kjo praktikë u ndërpre në vitin 2018 kur Sektori i Azilit pushoi t'ju lëshojë dhe tua vazhdojë vlefshmërinë të ashtuquajturve kartonë të verdhë.

109) Vendet pjesëmarrëse duhet të sigurojnë programe që u mundësojnë refugjatëve dhe romëve dhe sintive të zhvendosur brenda vendit të bëjnë zgjedhje të bazuar në informacione në lidhje me vendimin për zgjidhje të përhershme të situatës së tyre, duke përfshirë përdorimin e së drejtës së tyre për kthim të sigurt, dinjitoz dhe të qëndrueshëm. Programet e tilla duhet të ofrojnë informacione specifike për çdo çështje me interes për refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit dhe këto informacione duhet të ofrohen në gjuhët përkatëse.

Personave nga Kosova që kishin mbrojtje ndërkombëtare në periudhën e kaluar iu mundësua zgjidhja e përhershme e statusit të tyre përmes programeve të ndryshme, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi. Personat udhëzoheshin të nxirrnin dokumente nga vendet e tyre të origjinës, disa e bënë këtë në Kosovë dhe disa në Serbi.

Romët që u riintegruan në Kosovë ose Serbi patën mundësinë përmes programeve të ndryshme të përfitojnë mjete ose mundësinë për të ndërtuar një shtëpi, duke ua zgjidhur çështjen e tyre të banimit pas kthimit në vendin e tyre të origjinës.

Në pjesën e të porsalindurve të lindur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, çështja e statusit të tyre mbeti e pazgjidhur sepse Drejtoria e Administrimit të Librave Amë, nëse nuk kishte pranuar dokument mbi statusin martesor vullnetar

për nënat nga vendi i origjinës, Kosova ose Serbia, nuk e regjistronte të porsalindurin edhe pse babai është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Veç tjerash, nëse nënës i është ndërprerë mbrojtja ndërkombëtare dhe nuk ka dokumente, fëmija i porsalindur nuk është objekt i regjistrimit në librat amë.

110) Të sigurohet që trajtimi i refugjatëve romë dhe sinti të jetë në përputhje me normat dhe standardet relevante ndërkombëtare të mbrojtjes, pa asnjë diskriminim.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nuk ka raste të veçanta të diskriminimit ndaj personave që kanë statusin e refugjatit ose kanë mbrojtje ndërkombëtare. Në përputhje me praktikën e specifikuar në pikën 108, ekziston një shkallë më e lartë e tolerancës për personat që kanë pasur mbrojtje ndërkombëtare e cila ndërkohë është ndërprerë, veçanërisht në pjesën e lirisë së lëvizjes dhe qëndrimit, përkatësisht nëse legjitimohen nga punonjësit e policisë. Megjithatë, një tolerancë e tillë nuk ekziston kur bëhet fjalë për përfitimin e shërbimeve sociale, shëndetësore ose arsimore nga institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

111) Të përdoret roli i ODIHR-së në parandalimin e konflikteve dhe në identifikimin e zonave të ndërhyrjes së hershme dhe në këtë drejtim përdorni profesionalizmin e Komisionarit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka rreziqe të konflikteve në lidhje me romët që ikën nga Kosova në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 1999. Në periudhën prej 25 vjetësh, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka punuar me intensitet të ndryshëm për të gjetur zgjidhje të përhershme për statusin e këtyre personave. Aktualisht ka më pak se 200 persona

në Republikën e Maqedonisë së Veriut që kanë ikur nga konflikti në vitin 1999, që është pothuajse 10 herë më pak se fluksi fillestar i personave në vitin 1999. Reduktimi e numrit të këtyre personave është kryesisht për shkak të masave vullnetare të riintegrit në Kosovë dhe Serbi, por edhe për mundësinë e natyralizimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Qeveria, së bashku me UNHCR-në dhe shoqatat e qytetarëve, para së gjithash Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj si partner i saj, ka ndërmarrë masa aktive që nga viti 2011 për zgjidhjen e përhershme të statusit të këtyre personave. Gjegjësisht, siç është përcaktuar në pikën 107, me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të huajt u ofrua zgjidhje e përhershme të statusit të personave nga Kosova duke marrë një leje qëndrimi të përhershme, e cila është një nga hapat për fitimin e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

112) Ti përkushtohet vëmendje e veçantë nevojave të grave dhe fëmijëve romë dhe sinti në situata krize dhe pas krizës, veçanërisht në lidhje me sigurimin e qasjes në shërbimet mjekësore, banim dhe shkollim.


Personat që kanë mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut i gëzojnë të gjitha shërbimet shëndetësore, si dhe të drejtën e banimit dhe arsimit në të gjitha institucionet arsimore. Në pjesën e banimit, në një periudhë më të gjatë kohore kjo financohet nga UNHCR. Në pjesën e arsimit, ekziston mundësia që fëmijët e prindërve që kanë ikur nga kriza e Kosovës të jenë pjesë e procesit arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për refugjatët nga Kosova të cilët gjithashtu fituan edukim themelor në gjuhën maqedonase, ndërkaq shumica e fëmijëve kanë lindur në Republikën e Maqedonisë (në atë kohë), regjistrimi i rregullt në shkolla nuk ishte problematik. Masat nxitëse dhe mbështetëse për refugjatët nga Kosova u siguruan përmes

aktiviteteve të projektit të financuara nga donatorë në kombinim me bursat dhe mbështetje mentorimi.²⁵⁹

Megjithatë, kur bëhet fjalë për rastet në të cilat personave u është ndërprerë mbrojtja ndërkombëtare, automatikisht me këtë u ndërpritet mundësia e përfitimit të shërbimeve, dhe gëzimit të të drejtave themelore, banimit dhe arsimit. Por, varet nga komuna në komunë nëse edhe këtyre fëmijëve do t'u mundësohet e drejta arsimit, edhe pse ata nuk kanë status në Republikën e Maqedonisë së Veriut.²⁶⁰

²⁵⁹ <https://myla.org.mk/wp-content/uploads/pdf/UNICEF-Obrazovanie-na-deca-begalci-MKD-FINAL-digital.pdf>

²⁶⁰ Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj, 1.8.2024.



IV

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUSIONE

Republika e Maqedonisë së Veriut, siç mund të shihet nga aktivitetet e raportit, në mënyrë aktive i qaset përmirësimit të gjendjes së romëve në të gjitha aspektet shoqërore, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Nëse e marrim parasysh periudhën që e përfshin vetë raporti, do të jetë e lehtë të përfundohet se progres më i madh është arritur në pjesën e arsimit. Ky progres fillimisht ka të bëjë me bashkëpunimin e fortë dhe afatgjatë të Qeverisë përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me Fondin Arsimor të Romëve, përmes të cilit fillimisht u siguruan mjete financiare për nxënësit dhe studentët romë, që pastaj Qeveria plotësisht ta marrë përsipër këtë detyrim, të cilin e përmbush në mënyrë konsekuente me rritje të vazhdueshme. Megjithatë, progresi dhe suksesi në pjesën e arsimit nuk janë të plotë për shkak se romët në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk kanë mundësi të ndjekin mësimin në gjuhën amtare rome në të njëjtën mënyrë si komunitetet e tjera joshumicë. Mes tjerash një problem serioz është edhe segregacioni ekzistues i nxënësve romë në Manastir, Shtip, Prilep dhe Koçani, meqë shteti akoma nuk ka ndërmarrë as masa të përgjithshme dhe as masa konkrete në përputhje me detyrimet që burojnë nga aktgjykimi Elmazova dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Dokumentet strategjike të përfshirjes së romëve parashikojnë masa që kanë të bëjnë vetëm me romët, por jo edhe me popullsinë tjetër në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Evidente është mungesa e qasjes gjithëpërfshirëse nga pjesa tjetër e popullsisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, që duhet të çojë në një kohezion më të gjerë social në zonat fqinje të banuara me popullatë jo-rome. Si rezultat i mungesës së një qasjeje gjithëpërfshirëse, ekziston dukuria e segregacionit të nxënësve romë në arsimin fillor në Manastir, Shtip, Prilep dhe Koçani.

Mungon mobilizimi i mekanizmave relevant për mbrojtjen e fëmijëve të rrugës dhe përfshirjen e tyre në arsimin parashkollor dhe fillor, si dhe përfshirjen e detyrueshme të prindërve të tyre në aktivitetet formale të edukimit/shkrim-leximit dhe fitimin e aftësive të punësimit.

Pas një periudhe prej disa dekadash, Republika e Maqedonisë së Veriut vendosi një zgjidhje ligjore për zgjidhjen e përhershme të statusit civil të romëve që nuk janë të regjistruar në librat amë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me fjalë të tjera, ky proces, megjithëse pritej të implementohet shumë më herët, ai filloi madje në vitin 2020 me miratimin e Ligjit për personat e paevidentuar në Librin amë të të lindurve. Pastaj, si zgjidhje sistematike, u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për evidencën

e amë dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të huajt. Me këto ndryshime ligjore, shteti bëri të mundur që personat e paregjistruar ose pa dokumente të fitojnë shtetësi ose qëndrim ligjor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjë që përcakton edhe statusin juridik të personave që kanë ardhur nga Kosova në vitin 1999 për shkak të konfliktit atje. Pavarësisht angazhimit politik të Komisionit për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive dhe Grupit Parlamentar Ndërpartiak për të Drejtat e Romëve në legjislaturën parlamentare 2020 - 2024, i cili u përkthye në një zgjidhje sistematike funksionale, mungon finalizimi i tij për shkak të procesit të vështirë të marrjes së dokumenteve personale nga personat e regjistruar në librin amë të të lindurve në përputhje me këto ligje. Përveç procesit të ngadaltë të marrjes së dokumenteve personale, mbetet e hapur çështja e së ardhmes së personave të regjistruar në përputhje me ligjin dhe personave të paregjistruar në librin amë të të lindurve për shkak të faktit se regjistrimi i tyre nuk është bërë në Librin amë të të lindurve.

Megjithatë, edhe në këtë segment ekziston mungesë e qasjes strategjike për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje sepse Ligji për personat e paevidentuar në Librin amë të të lindurve e parashikon evidentimin jashtë evidencës së rregullt në librat amë, së këtijmi ekziston rreziku që ky trajtim dhe status i ndryshëm të legalizohen dhe të përbëjë një bazë për pabarazi.

Procesi i shmangies së stereotipave dhe paragjytimeve ndaj romëve në të gjitha pjesët e jetës socio-ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut është ngadalësuar dukshëm për shkak të të gjitha formave të segregacionit të romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Formimi i institucioneve të reja dhe forcimi i kapaciteteve të atyre ekzistuese që kanë kompetenca dhe veprojnë në pjesën e përfshirjes dhe integritetit të romëve, si dhe parandalimi

dhe mbrojtja nga diskriminimi dhe segregacioni, si dhe profilizimi racor, është një nga proceset në progres të vazhdueshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky progres mbështetet në tri baza. E para është angazhimi politik i faktorëve politikë për fillimin e procesit të luftës kundër diskriminimit dhe promovimit të barazisë dhe multikulturalizmit. Baza e dytë ka të bëjë me kuadrin ligjor të miratuar me qëllim krijimin e bazës ligjore për përfshirjen dhe integrimin më të madh të romëve dhe parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, segregacioni dhe profilizimi racor. Baza e tretë konsiston me krijimin e kushteve për themelimin e institucioneve të reja dhe për mbështetjen institucionale të institucioneve ekzistuese të përfshira drejtpërdrejt në proceset e përmirësimit të gjendjes së romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Niveli i progresit akoma është në nivel të ulët për arsyen se, pavarësisht angazhimit politik për përfshirjen dhe integrimin e romëve, shteti nuk i siguron kapacitetet e nevojshme institucionale, materiale dhe financiare, gjë që mund të shihet në buxhetet vjetore për implementimin e Dekadës së romëve, Strategjisë 2014 - 2020, si dhe Strategjisë aktuale 2022 - 2030.

Reduktimi i varfërisë midis romëve është një proces në zhvillim. Në kuadër të këtij procesi, institucionet kompetente marrin masa aktive për trajnimin profesional të romëve dhe rritjen e pjesëmarrjes së romëve në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërmerr masa aktive për të rritur punësimin e romëve, siç mund të shihet në aktivitetet e zbatuara përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, nëse marrim parasysh përfaqësimin e fuqisë së punës në tregun e punës, përkatësisht të punësuarit romë kundrejt përfaqësimit të komuniteteve të tjera, tre dallime

thelbësore janë lehtësisht të dukshme. Dallimi i parë ka të bëjë me procedurën jopërkatese të romëve në popullatën e përgjithshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut me shkallën e të punësuarve romë kundrejt shkallës së popullsisë së përgjithshme të punësuar. Dallimi i dytë është shkalla dhe kompleksiteti i vendeve të punës në të cilat romët janë të punësuar dhe shkalla dhe kompleksiteti i vendeve të punës në të cilat janë punësuar qytetarët e tjerë që janë pjesë e tregut të punës. Dallimi i tretë konsiston me përfaqësimin romëve të punësuar dhe pozicionet e tyre në shërbimet publike dhe administratën shtetërore dhe përfaqësimin dhe pozicionet në shërbimet publike dhe administratën shtetërore të komuniteteve të tjera.

Dallimi është evident sa i përket shkallës së pjesëmarrjes si në tregun e punës ashtu edhe në shërbimet publike të romëve dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera. Megjithatë, gjërat po ndryshojnë me një trend pozitiv, si për shkak të shkallës së lartë të migrimit të qytetarëve si fuqi punëtore në vendet e Bashkimit Evropian dhe në shtetet tejoqeanike, ashtu edhe për përmirësimin e situatës me arsimin në komunitetin rom, dhe interesin për arsim të mëtejshëm dhe trajnim profesional përmes masave aktive të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mbrojtja shëndetësore dhe sigurimi i romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut është segmenti më sensitiv në aspektin e përmirësimit të gjendjes së romëve, sepse vetë sistemi shëndetësor nuk është plotësisht gjithëpërfshirës në drejtim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe sigurimit shëndetësor për romët. Nga vetë raporti është evidente se ka mungesë serioze të institucioneve shëndetësore dhe punonjësve shëndetësorë, mjekëve dhe personelit mjekësor, në disa nga komunat ku jeton komuniteti rom.

Në fushën e trajtimit shëndetësor dhe trajtimit të fëmijëve të varur nga narkotikët, nuk është krijuar një sistem i qëndrueshëm, i cili do të përfshinte ekspertë në institucionet kompetente shtetërore (polici, qendrat e punës sociale, institucionet shëndetësore, etj.) për punën me fëmijët e varur, përveç shoqatave të qytetarëve aktive në këtë fushë.

Në komunitetin rom, ka mungesë të mjekëve të përgjithshëm, pediatërve dhe gjinekologëve, përkatësisht mungesë të mbrojtjes shëndetësore primare, e cila është një problem serioz për sa i përket shëndetit të përgjithshëm të romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Veç tjerash, brenda komunitetit rom ka mungesë edukimi për shërbimet shëndetësore të ofruara nga shëndeti publik dhe për këtë arsye organizohen fushata nga organizatat e shoqërisë civile dhe Ministria e Shëndetësisë për të rritur ndërgjegjësimin e publikut lidhur me kujdesin për shëndetin e individit si dhe të komunitetit. Përkundër aktiviteteve të vazhdueshme të Qeverisë përmes Ministrisë së Shëndetësisë, ende nuk ka zhvillim të vazhdueshëm në fushën e mbrojtjes shëndetësore për komunitetin rom.

Përfaqësimi i romëve në shërbimin publik dhe mbështetja për zhvillimin e kulturës rome në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë në një nivel të ulët për shkak të faktit se në periudhën e fundit ka pasur një rënie të mediave që kanë programe në gjuhën rome ose që synojnë komunitetin rom. Aktualisht, ka vetëm një stacion televiziv dhe një radio, ndryshe nga periudha e mëparshme kur kishte një përfaqësim më të madh të mediave rome që rrezatonin programe në hapësirën publike. Në fushën e zhvillimit të kulturës rome, nuk ka mbështetje adekuate siç është për komunitetet e tjera.

Ministria e Kulturës nuk ka parashikuar aktivitete dhe masa të veçanta për të mbështetur kulturën dhe traditën rome në kuadër të buxhetit të saj për mbështetjen e kulturës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Romët si komunitet nuk kanë asnjë institucion për ruajtjen, promovimin dhe zhvillimin e kulturës rome.

Pjesëmarrja e romëve në jetën socio-politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut është disproporcionale në krahasim me pjesëmarrjen e komuniteteve të tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Nga viti 1991, romët kanë marrë pjesë aktive në jetën politike përmes përfaqësuesve politikë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe më vonë kanë marrë pjesë në Qeveri përmes pozitës politike të ministrit pa portofol përgjegjës për Dekadën e romëve në vitin 2014, ndërsa më vonë përgjegjës për Strategjinë e përfshirje së romëve. Në vitin 2024, romët për herë të parë nuk kanë përfaqësues në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut si pushtet ligjvënës, por gjithashtu për herë të parë kanë tre zëvendësministra në Qeverinë e themeluar në qershor 2024. Në pjesën e pushtetit gjyqësor dhe autoriteteve të jurisprudencës, romët nuk janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate meqë në jurisprudencën e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka vetëm një gjyqtar rom, ndërsa nuk ka asnjë prokuror publik.

Pjesëmarrja në krijimin dhe zbatimin e politikave shtetërore është gjithashtu një hallkë e dobët në përmirësimin e situatës së komunitetit rom në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për shkak të numrit shumë të vogël të funksioneve drejtuese që i ushtrojnë romët në pushtetin ekzekutiv. Përveç kësaj, përfaqësimi politik i romëve është i fragmentuar meqë në vitin 2024 kishte 11 parti politike aktive në jetën politike, gjë që nuk shkon në favor të komunitetit rom në zgjedhjet parlamentare në të cilat përdoret sistemi i Dontit. Ky fragmentim rezultoi me atë se në zgjedhjet

parlamentare në qershor të vitit 2024, komuniteti rom përmes subjekteve politike për herë të parë nuk kishte përfaqësues në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

REKOMANDIME

Rekomandime në nivel sistemi:

1. Fuqizimi i grumbullimit të të dhënave dhe monitorimi:
 - ▶ Krijimi i një sistemi konsistent për raportimin e gjendjes së komunitetit rom në komunat e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo përfshin monitorimin e progresit, regresit ose stagnacionit, duke përdorur të dhënat e regjistrimit të vitit 2021 për zhvillimin e politikave të synuara.
 - ▶ Vendosja e sistemit informativ për shkallën e zbatimit të dokumenteve të strategjisë në nivel kombëtar dhe lokal për përfshirjen e romëve.
 - ▶ Krijimi i një baze të dhënash për monitorimin e incidenteve të diskriminimit dhe për zhvillimin e mekanizmave të rregullt të raportimit me qëllim të parandalimit dhe zgjidhjes së këtyre çështjeve.
2. Lufta kundër diskriminimit dhe racizmit:
 - ▶ Zbatimi konsistent i kuadrit ligjor për mbrojtje nga diskriminimi në të gjithë sektorët e shoqërisë. Sigurimi i funksionalitetit dhe efektivitetit të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi duke siguruar resurset e nevojshme teknike, financiare dhe njerëzore.
 - ▶ Zbatimi i fushatave publike për rritjen e ndërgjegjësisë lidhur me të drejtat e romëve

dhe luftën kundër diskriminimit, duke synuar popullsinë rome dhe shoqërinë e gjerë.

- ▶ Rishikimi i rajonizimit për shkollat fillore me qëllim parandalimin e çdo lloji segregacioni.

3. Përfshirja socio-ekonomike:

- ▶ Miratimi i Ligjit për banim social për përmirësimin e qasjes në banim për grupet sociale vulnerabël, veçanërisht romët, si përgjigje të rritjes së çmimeve të banesave.
- ▶ Qasje strategjike në identifikimin e vendbanimeve informale me romë dhe përcaktimin e numrit të personave të pastrehë me qëllim zgjidhjen e përhershme të çështjes së banimit të këtyre personave.
- ▶ Rritja e mundësive të punësimit për romët përmes masave aktive të tilla si aksioni afirmativ në shërbimet publike, trajnimi për punë dhe krijimi i programeve speciale për punësimin e grave/vajzave rome.

4. Shërbimet shëndetësore dhe sociale:

- ▶ Ofrimi i shërbimeve shëndetësore bazë dhe të specializuara për komunitetin rom bazuar në qasje të barabartë në mbrojtjen shëndetësore.
- ▶ Zgjidhja e çështjeve shëndetësore siç është mungesa e trajtimit për fëmijët romë që vuajnë nga varësia e substancave.
- ▶ Sigurimi i qasjes konsistente në mbrojtjen shëndetësore primare për fëmijët, gratë dhe të moshuarit romë duke rritur numrin e ndërmjetësve shëndetësorë në komunitetin rom. Bashkëpunimi me qendrat shëndetësore lokale dhe institucionet ndërkombëtare për monitorimin dhe regjistrimin e vaksinimeve.

5. Arsimi:

- ▶ Qëndrueshmëria e programeve të bursave për nxënësit romë në shkollat e mesme dhe

universitetet, duke i përshtatur ato me rritjen e kostos së jetesës.

- ▶ Zgjerimi i programeve të bursave për nxënësit romë në arsimin fillor nga klasa e 6 deri në të 9 si masë për parandalimin e reduktimit të numrit të nxënësve nga arsimi.
- ▶ Rritja e regjistrimit të fëmijëve romë në arsimin parashkollor dhe përfshirja e mësimi të gjuhës dhe kulturës rome në arsimin parashkollor për integrimin më të mirë kulturor.
- ▶ Hapja e katedrës në gjuhën rome në Fakultetin Pedagogjik "Shën Klimenti i Ohrit" në Shkup për edukimin e stafit profesional për arsimin parashkollor dhe fillor.

6. Situatat e krizës dhe pas krizës:

- ▶ Zhvillimi i zgjidhjeve të përhershme për statusin juridik të refugjatëve romë nga Kosova që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Rekomandime në nivel të politikës publike:

1. Strategjia e përfshirjes së romëve 2022-2030

- ▶ Autoriteti Kombëtar Koordinues duhet të drejtojë monitorimin dhe koordinimin e aktiviteteve dhe masave në Strategjinë për përfshirjen romëve. Kjo përfshin përgatitjen dhe publikimin e raporteve për zbatim në nivel tremujor, gjysmë vjetor dhe vjetor, si dhe buxhetimin adekuat dhe transparent të këtyre masave.

2. Kuadri kundër diskriminimit:

- ▶ Krijimi i politikave më të fuqishme kundër diskriminimit në nivel kombëtar në mënyrë që të sigurohet aplikimi dhe zbatimi konsistent. Institucionet duhet ta kenë për detyrë t'i monitorojnë rekomandimet e Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

- ▶ Fuqizimi i kuadrit ligjor për ndihmë juridike falas, duke e bërë atë më të aksesueshme për grupet vulnerabël, veçanërisht për romët.

3. Arsimi dhe multikulturalizmi:

- ▶ Sigurimi i zbatimit konsistent të politikës për arsimin multikulturor në shkollat në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përmirësimi i trajnimit të mësimeve për identifikimin dhe parandalimin e diskriminimit dhe segregacionit dhe promovimin e mirëkuptimit ndërkulturor.

4. Zgjedhjet:

- ▶ Promovimi i programeve arsimore të votimit për romët, me fokus mbi përfitimet afatgjata nga zgjedhjet e ndershme dhe pjesëmarrja politike për komunitetin e tyre.
- ▶ Parandalimi i praktikës së abuzimit të së drejtës së zgjedhjes (votimi grupor ose familjar) në komunitetet më të vogla etnike.
- ▶ Informimi i vazhdueshëm në lidhje me të drejtën e zgjedhjes nga partitë politike në komunat dhe vendet ku jeton komuniteti rom.

Rekomandime në nivel institucional:

1. Kuvendi i Republikës Së Maqedonisë së Veriut

- ▶ Formimi i grupit punues ndërpartiak parlamentar për monitorimin e situatës së përfshirjes së romëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

2. Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë

- ▶ Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë duhet ti drejtojë përpjekjet për hartimin e raporteve të standardizuara për nismat lidhur me romët dhe të sigurojë që

i gjithë dokumentacioni do të mbahet në formë elektronike. Ministria duhet të sigurojë paraqitjen në kohë të raporteve tremujore për çështjet rome në Kabinetin e Ministrit pa portofol.

- ▶ Ngritja dhe drejtimi i grupit punues për punën ndërdisiplinore me fëmijët e rrugës dhe prindërit e tyre me synimin për të siguruar mbrojtje të plotë për fëmijët në rrezik.

3. Autoriteti Kombëtar Koordinues AKK

- ▶ AKK duhet të vazhdojë të koordinojë aktivitetet lidhur me romët në nivel lokal dhe qendror, duke forcuar bashkëpunimin ndërmjetror për zgjidhjen e problemeve persistente që kërkojnë zgjidhje ndërinstitutionale. Komunikimi i rregullt me autoritetet lokale në komunat me popullsi rome është thelbësor.

4. Ministria e Shëndetësisë

- ▶ Ministria e Shëndetësisë, me ndihmën e ndërmjetësve, duhet ta përmirësojë qasjen në shërbimet shëndetësore për komunitetin rom, veçanërisht në identifikimin dhe vaksinimin e fëmijëve romë. Duhet të krijohet një zgjidhje sistematike për trajtimin e fëmijëve romë me varësi ndaj drogës dhe ngjitësve.

5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

- ▶ Ministria e Arsimit duhet të angazhohet që romët të përfundojnë arsimin fillor dhe të mesëm përmes programeve të bursave, iniciativave të integritit kulturor dhe punësimit të edukatorëve romë.
- ▶ Ajo duhet ta luftojë analfabetizmin tek të rriturit dhe të rinjtë.
- ▶ Duhet të themelohet një lektorat i posaçëm për gjuhën dhe kulturën rome në një nga fakultetet filologjikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

6. Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, Drejtoria e Administrimit të Librave Amë, Ministria e Drejtësisë:

- ▶ Sigurimi i implementimit efektiv të Ligjit për evidencën amë të personave të paregjistruar dhe ndryshimet e njëpasnjëshme të Ligjit për shtetësi, veçanërisht për të parandaluar në të ardhmen rastet e personave apatridë brenda komunitetit rom.

7. Organizatat e qytetarëve

- ▶ Inkurajimi i përfshirjes më të madhe të organizatave të qytetarëve romë në proceset e konsultimit të politikave dhe pjesëmarrjen e tyre në monitorimin e iniciativave në lidhje me romët.
- ▶ Promovimi i sinergjive me partitë politike për përfaqësimin më të mirë të nevojave të komunitetit dhe pjesëmarrje në vendimmarrje.

